

MIMOZA PRIKU

LEZE CACAJ

SHTËPIZA E DYTË E SHKRONJAVE

GJUHA SHQIPE 2

për klasën e dytë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT /ES

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2025

Dr. MIMOZA PRIKU

Mr. LEZE CACAJ

SHTËPIZA E DYTË E SHKRONJAVE

GJUHA SHQIPE 2

për klasën e dytë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT 2

DRUGA KUĆICA SLOVA

ALBANSKI JEZIK 2

Za drugi razred osnovne Škole

PRIRUČNIK 2

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensentë: Mr. Anton Gojčaj

Teuta Gjokaj

Mr. Maja Gojčaj

Dr. Fatmir Vadahi

Mr. Ardita Kovačević

Lektor: Mr. Marjan Luljuraj

Dizajni dhe faqosja: Momčillo Qorsović

Ilustrimet: Edin Kapllani

Redaktore teknike: Dajana Vukčević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2569-4
COBISS.CG-ID 36395012

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-4 datë 16.07.2025
e ka miratuar këtë Libër të Mësuesit për përdorim në shkollat fillore.
Copyright c Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

Hyrje

Mësimi i lexim-shkrimit fillestar është një proces mjaft i rëndësishëm, por edhe i ndërlikuar. Fëmijët nisin të marrin disa koncepte të tij që herët, pa u ndërgjegjësuar akoma se ata janë pjesë e elementeve të shkrimit. Nga përvojat fillestare dhe ndërveprimet me të rriturit, fëmijët fillojnë të lexojnë fjalë, fillimisht në mënyrë globale, me tej ata nisin t' i përpunojnë marrëdhëniet shkronjë-tingull dhe në këtë mënyrë marrin njohuritë e para për sistemin alfabetik të gjuhës së tyre. Nëse gjuha nis e përvetësohet natyrshëm tek fëmijët¹, aftësia për të lexuar dhe shkruar nuk zhvillohet natyrshëm, por ajo kërkon një planifikim të mirë dhe parime didaktike të kujdesshme. Mbarëvajtja e procesit të lexim-shkrimit fillestar ndihmon ose në të kundërtën, pengon, formimin e nxënësit edhe në disipinat e tjera. Pikërisht për t' i ardhur në ndihmë mësimi të lexim-shkrimit fillestar, kemi propozuar modelin tonë të tekstit që e kemi titulluar "Shtëpiza e dytë e shkronjave".

Teksti "Shtëpiza e dytë e shkronjave" është hartuar në bazë të programit të "Gjuhës shqipe dhe Letërsisë", të miratuar nga Enti i Shkollimit në Mal i Zi (Podgoricë, 2017). "Shtëpiza e dytë e shkronjave" vjen me tri pjesë: libri i nxënësit, fletore e punës dhe libri i mësuesit.

Për hartimin e tekstit "Shtëpiza e dytë e shkronjave" janë marrë në konsideratë të gjitha rezultatet edukativo-mësimore të programit mësimor, por duke qenë se lexim-shkrimi ngërthen në vetvete dy anë të ndryshme, por që ndërthuren fort me njëra-tjetrën, pra është gati e pamundur që në një kapitull nxënësi vetëm të lexojë ose vetëm të shkruajë, këto dy procese janë harmonizuar me njëri-tjetrin dhe janë shtrirë në tre kapituj duke përfshirë rezultatet 2 dhe 3 të programit.

Kapitulli i parë ka dy mësimë hyrëse që lidhen me komunikimin dhe me disa ushtrime për elementet e shkrimit dhe që e parapërgatisin nxënësin për kapitullin më të rëndësishëm, atë të "Lexim-shkrimit fillestar". Gjatë kapitullit vijues do të mësohen 36 shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe, shkronjat e shtypit dhe ato të dorës. Shkronjat nuk ndjekin rendin e alfabetit të gjuhës shqipe, por kemi ndjekur një renditje që mendojmë se e ndihmon nxënësin që t' i përvetësojë më mirë shkronjat. Kemi nisur me zanore **A**, jo vetëm si shkronja e parë e alfabetit, por edhe si një tingull i thjeshtë në shqiptim dhe pa shumë ndërlikime në anën grafike. Pastaj kemi vijuar me bashkëtingëlloren **M**, e cila ndihmon edhe krijimin e rrokjeve e fjalëve. Janë vendosur njëra pas tjetrës shkronja që kanë elemente të përbashkëta në anën grafike ose janë të afërta në shqiptim. Kemi renditur në fillim shkronjat e thjeshta e pastaj ato dyshe. Në renditjen e shkronjave jemi prirë si nga parimet fonologjike, ashtu edhe grafike. Kemi propozuar që çdo shkronjë të ndjekë rrugën didaktike që nis me mësimin e shkronjës së madhe e të vogël të shtypit e menjëherë vjen mësimi i shkronjës së dorës. Është zgjedhur kjo vijë metodike, duke qenë se tradita e mësimi të gjuhës shqipe ndjek prej shumë kohësh përgjithësisht këtë metodologji: nga shkronja e shtypit shkon natyrshëm tek ajo e dorës. Ky është vetëm një propozim, sepse mësuesi ka mundësi ta zgjedhë vetë metodologjinë që mendon se i përshtatet më mirë.

Tekstet janë pjesë integrale e secilës shkronjë. Ato janë zgjedhur e krijuar në përshtatje me

1 Chomsky, N. (1998). "Chapter 2 On the Nature, Use, and Acquisition of Language". In Handbook of Child Language Acquisition. Leiden, The Netherlands: Brill. https://doi.org/10.1163/9789004653023_005

moshën e nxënësve me tema që i lidhin ata me jetën e tyre, por edhe i drejtojnë që të mësojnë gjëra të reja. Tek shkronjat e dorës nxënësi fillimisht përballet me fjalë të shkëputura, grupe fjalësh e më pas me fjali e deri tek tekstet e shkurtra. Për një përvetësim sa më të mirë të shkronjave është propozuar gati për secilën shkronjë nga një diktim i shkurtër.

Pas çdo grupi prej gjashtë shkronjash, është propozuar një përsëritje e shkronjave të bëra, në mënyrë që nxënësi të krijojë siguri, familjaritet e dalëngadalë edhe shkathhtësi në përdorimin e shkronjave e lidhjen e tyre me shkronja të tjera.

Mësimi i shkronjave është bërë duke u nisur përgjithësisht nga metoda analitiko-sintetike, por jo vetëm, sepse në mënyrë harmonike janë shkrirë edhe elemente globale, fonetike etj. Duke qenë mbizotëruese metoda analitiko-sintetike është përdorur rrokja si element analize dhe sinteze, por jo vetëm, sepse ajo është ndërthurur edhe me tingullin a shkronjën. Meqënëse një rrokje ndërtohet me bazën e një zanoreje, atëherë koncepti i rrokjes nis që me zanoren e parë A dhe përvijohet edhe në shkronjat e tjera. Sipas gjuhëtarit R. Memushaj rrokja "është njësia më e vogël shqiptimore e të folurit [...]. Rrokja është pjesë e kompetencës së folësit amtar..."².

Çdo mësim bazohet në katër komponentë: *të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit*. Ushtrimet e ndryshme e të pasura si në tekstin e nxënësit, ashtu edhe në fletoren e punës do ta ndihmojnë mësuesin në punën e tij, por sidomos nxënësin në përvetësimin e shkronjave. Të mësuarit përmes lojës është një metodë që e afron më shumë nxënësin me tekstin dhe njësinë mësimore, prandaj labirintet e ndryshme, zgjidhjet e fjalëkryqeve, gjetja e fjalëve etj., janë sjellë për t'i shërbyer këtij qëllimi. Si teksti i nxënësit, ashtu edhe fletorja e punës është e pasur me ilustrime që zgjojnë kureshtjen e nxënësit, por edhe e ndihmojnë atë në përvetësimin e mësimin a zgjidhjen e ushtrimit.

Përmes teksteve apo fjalëve të ndryshme nxënësi tërhiqet edhe drejt disa problemeve drejtshkrimore, si përdorimi i pikës, pikëpyetjes, përdorimit në disa raste të shkronjës së madhe, zanores –ë etj.

Në hartimin e tekstit është marrë në konsideratë edhe korrelacioni i gjuhës me disiplina, si kultura muzikore, kultura e artit figurativ, matematika, njohuria për shoqërinë etj. Këngët e ndryshme, ushtrimet me ngjyrosje, vizatimet, krijimet me letra me ngjyra etj., e mishërojnë më së miri këtë ndërlidhje. Në fund të mësimin të shkronjave është vendosur alfabeti i plotë i gjuhës shqipe, me nga një figurë ilustruese për secilën.

Në kapitullin e tretë "Unë lexoj" janë përfshirë disa tekste joletrare që synojnë të realizojnë një ndërlidhje kulturore. Për këtë qëllim janë realizuar tekste që zgjojnë njohuritë e nxënësit për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe, plotësojnë kuriozitetin e tij për numrat, mbushin botën shpirtërore me informacione për traditën etj.

Në ndihmë të mësuesit është hartuar dhe "Libri i mësuesit" që do ta ndihmojë atë në organizimin e orës së mësimin. Çdo njësi mësimore vjen me propozime të pasura si për nga metodat e teknikat që propozon, por edhe sa i takon organizimit didaktik të tërë materialit. Për secilën shkronjë janë propozuar dy orë të ndryshme, një orë për shkronjën e shtypit dhe një orë për shkronjën e dorës. Në fund janë dhënë edhe disa modele testesh, detyrash kontrolli, diktimesh si një orientim për mësuesin.

Simbolet do ta ndihmojnë nxënësin që të orientohet në tekst.



Gjuhë dhe komunikim



Lexim - shkrim fillestar



Shqipto



Vështro



Shkruaj me shkronja të vogla shtypi



Shkruaj me shkronja të mëdha shtypi



Shkruaj me shkronja dore



Dëgjo

Vizato



Lexo



Lexo bashkë me mësuesin



Bashko pikat



Ndiq gjurmët



Qarko



Rrokje

A+B

Bashko shkronjat



Bashko rrokjet



Bashko fjalët A+B



Puno me letra me ngjyra



Krahasojmë shkronjat



Kuic



Muzikë



Labirint



Kujdes



flas

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje	3
Kap. I Gjuhë dhe komunikim	
Mësimi 1. Rregullat e mirësjelljes	9-10
Mësimi 2. Rregullat e klasës	11-12
Kap. II Lexim dhe shkrim fillestar	
Mësimi 3. Shkronja A	13-16
Mësimi 4. Shkronja I	17-20
Mësimi 5. Shkronja M	21-24
Mësimi 6. Shkronja N	25-29
Mësimi 7. Shkronja R	30-34
Mësimi 8. Shkronja E	35-38
Mësimi 9. Përsëritje e shkronjave: A, I, M, N, R, E	39-42
Mësimi 10. Shkronja Ë	43-46
Mësimi 11. Shkronja L	47-50
Mësimi 12. Shkronja U	51-54
Mësimi 13. Shkronja K	55-58
Mësimi 14. Shkronja O	59-63
Mësimi 15. Shkronja J	64-67
Mësimi 16. Përsëritje e shkronjave: Ë, L, U, K, O, J	68-71
Mësimi 17. Shkronja Y	72-75
Mësimi 18. Shkronja P	76-79
Mësimi 19. Shkronja B	80-83
Mësimi 20. Shkronja T	84-88
Mësimi 21. Shkronja D	89-93
Mësimi 22. Shkronja F	94-97
Mësimi 23. Përsëritje e shkronjave: Y, P, B, T, D, F	98-101
Mësimi 24. Shkronja V	102-105
Mësimi 25. Shkronja C	106-109
Mësimi 26. Shkronja Ç	110-114
Mësimi 27. Shkronja G	115-119
Mësimi 28. Shkronja Q	120-124
Mësimi 29. Shkronja Gj	125-128
Mësimi 30. Përsëritje e shkronjave: V, C, Ç, G, Q, Gj	129-132
Mësimi 31. Shkronja Li	133-137
Mësimi 32. Shkronja Rr	138-143
Mësimi 33. Shkronja Nj	143-147
Mësimi 34. Shkronja S	148-151
Mësimi 35. Shkronja H	152-155
Mësimi 36. Shkronja Sh	156-159
Mësimi 37. Përsëritje e shkronjave: Li, Rr, Nj, S, H, Sh	160-163

Mësimi 38. Shkronja Th	164-167
Mësimi 39. Shkronja Dh	168-171
Mësimi 40. Shkronja X	172-175
Mësimi 41. Shkronja Xh	176-180
Mësimi 42. Shkronja Z	181-184
Mësimi 43. Shkronja Zh	185-188
Mësimi 44. Përsëritje e shkronjave: Th, Dh, X, Xh, Z, Zh	189-192
Kap. III Unë lexoj	
Mësimi 45. Historia e alfabetit tonë	193-194
Mësimi 46. Akvariumi	195-196
Mësimi 47. Numrat	197-198
Mësimi 48. Veshjet popullore	199-200
Modele testesh	201-205
Modele detyrash kontrolli	205-207
Modele diktimesh	208
Burime dhe literatura	209

Rregullat e mirësjelljes**Mësimi 1.****Lënda:** Gjuhë shqipe dhe letërsi**Fusha:** Gjuhë**Njësia e mësimi:** Rregullat e mirësjelljes**Arritjet e të nxënësve:**

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të fillojë bisedën dhe të përgjigjet në mënyrë adekuate ndaj të folurit të tjetrit;
- të dëgjojë me vëmendje bashkëbiseduesin, duke mos e ndërprerë gjatë bisedës;
- të ketë durim gjatë komunikimit.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, bashkëbisedim, ditari dypjesësh, dramatizim etj.**Format e punës:** punë frontale, individuale, në çift, në grup.**Korelacioni:** natyrë dhe shoqëri, kultura e artit figurativ, Kulturë muzikore.**Aktivitetet e nxënësve:**

- komentojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike sjelljet e personave nga përvoja vetjake;
- zbatojnë rregullat e mirësjelljes dhe përdorin shprehjet përkatëse: më fal, urdhëro, faleminderit, Ju lutem, të lutem;
- improvizojnë situata duke marrë pjesë në lojërat për ushtrimin e komunikimit;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre.

Fjalë kyçe: rregullat e mirësjelljes, fjalët magjike**Mjetet e mësimi:** teksti mësimor, fletore pune, fotografi të ndryshme, tabelë, shkurtesë, kompjuter, CD, mjete vizatimi etj.**Evokim****Hapi I – Veprimtari paraprake**

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehje këngën për fëmijë “Fjalëzat magjike”.

Më pas plotësohet skema me përgjigjet e nxënësve dhe zhvillohet një bisedë me ta për rëndësinë e përdorimit të shprehjeve: më fal, urdhëro, faleminderit, Ju lutem, të lutem.

**Realizim kuptimi****Hapi II – Informacion i ri/ Punë në tekstin mësimor**Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Rregullat e mirësjelljes** ”.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 3 dhe për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet e diskutojnë me njëri – tjetrin. Më pas së bashku me mësues-in/en komentojnë situatat, kur dhe ku duhet të përdorim shprehjen:

MË FAL! FALEMINDERIT! MË VJEN KEQ! URDHËRO! TË LUTEM!

Nxënësit tregojnë situata të tjera nga përvoja e tyre (jeta e përditshme), kur ata kanë zbatuar ose jo rregullat e mirësjelljes. Situatat nxënësit mund t’i improvizojnë para klasës.

Hapi III

Nxënësit ndjekin gjurmët e vijave të bëra pranë figurave në tekstin mësimor.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës, pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat.

Në **ushtrimin e parë** nxënësit komentojnë figurat.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdimi i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e dytë** nxënësit ndjekin gjurmët e vijave.

Në **ushtrimin e tretë** nxënësit në çifte lidhin fjalën me figurën (fjalët - shprehjet lexohen nga mësuesja).

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it es për realizimin _____

Rregullat e klasës

Mësimi 2.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Rregullat e klasës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të fillojë bisedën dhe të përgjigjet në mënyrë adekuate ndaj të folurit të tjetrit;
- të dëgjojë me kujdes pyetjet dhe të përgjigjet me përgjigje të plotë.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, bisedë, rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh, dramatizim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dallojnë dhe respektojnë rregullat e klasës;
- dëgjojnë me kujdes pyetjet dhe përgjigjen me përgjigje të plota;
- komentojnë sjelljet e paraqitura në figura dhe i dramatizojnë ato.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ etj.

Fjalë kyçe: klasa, rregulla, zbatim i rregullave.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, foto, tabak letre, tabelë, shkurtesë, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: nxënësit vëzhgojnë me kujdes në projektor/tv ose në tabelë disa foto (pamje nga klasa). Më pas komentojnë fotot dhe shprehin mendimin e tyre duke treguar se cilat rregulla të klasës tregohen përmes fotove. Rregullat shkruhen në tabelë nga mësuesi.

RREGULLAT E **KLASËS**

Nxënësit tregojnë edhe rregulla të tjera, nëse dinë.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri / Punë në tekstin mësimor

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Rregullat e klasës”**.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 6. Shikojnë me vëmendje ilustrimet dhe dëgjojnë me kujdes shpjegimin që bën mësues-i/ja për rregullat e klasës.

Dëgjoj me vëmendje kur
flasin të tjerët.
Qëndro i heshtur kur flasin të tjerët.
Ngre dorën kur dua të flas.
Shprehem bukur në gjuhën
shqipe.

KUJDES
FLASIM ME RADHË.
DËGJOJMË TË TJERËT KUR
FLASIM.
MARRIM LEJE PËR TË FOLUR.
FLASIM ME MIRËSJELLJE.

Disa nga rregullat e klasës.

Hapi III

Nxënësit përgjigjen gojarisht në pyetjet tek rubrika **Pyetje**. Mësues-i/ja tregon kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen qartë (saktë) dhe me fjali të plota.

Diskutohet me nxënës rëndësia e zbatimit të rregullave të klasës.

PO A duhet të respektohen JO
rregullat e klasës? Pse?

Nxënësit emërtojnë mjetet e punës të paraqitura në ilustrim.

Reflektim

Hapi IV – Punë në fletore pune

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës. Nxënësit komentojnë sjelljet e paraqitura në figura. Dallojnë zbatimin apo jo të rregullave të mësuara.

Hapi V – Dramatizim

Nxënësit në grupe improvizojnë para klasës situata të ndryshme të përzgjedhura nga ata vetë ose të ndihmuar nga mësues-i/ja. Paraqitja e situatave mund të bëhet edhe përmes projektorit/tv.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it es për realizimin _____

Shkronja A**Mësimi 3.****Shkronja A a e shtypit****Lënda:** Gjuhë shqipe dhe letërsi**Njësia e mësimi:** Shkronja **A a** e shtypit**Tipi i orës:** Orë për përvetësim të njohurive**Arritjet e të nxënit:**

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatese);
- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: vëzhgo-analizo, metoda analitiko-sintetike, marrëdhëniet pyetje-përgjigje etj.**Format e punës:** frontale, individuale, në çifte, në grup.**Aktivitetet e nxënësve:**

- identifikojnë tingullin (shkronjën) **A** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën **A a** duke përdorur materiale të ndryshme;
- demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë**Fjalë kyçe:** tingull-shkronjë, rrokje, fjalë, arra, ariu, dallga, gjëgjëzë etj.**Mjetet e mësimi:** teksti mësimor, tablo me foton e arrës, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës **A a** të shtypit, projektor, TV, kompjuter, mjete vizatimi etj.**Evokim****Hapi I – Veprimtari paraprake**Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën e arrës (në projektor, TV ose tabelë) dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: - Çfarë shikoni në figurë? 


- Çfarë dini për arrat? Ku rriten ato? A ju pëlqejnë arrat?
- Me cilin tingull fillon fjala **arrë**? (Me tingullin A)
- Kujt i fillon emri me këtë tingull të ngrejë dorën?

Organizohet diskutim duke ndrequr në bashkëpunim me nxënësit gabimet që mund të vihen re.

Hapi IIMësuesi shkruan në tabelë fjalën **ARRA** dhe kryen procesin e analizës për ndarjen e shkronjës

(tingullit) **A**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **A – RRË**.
- Fjala **ARRË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **A**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që përmbajnë shkronjën **A** në trup të tyre. Nëse nxënësit kanë vështirësi mund t'i ndihmojë mësuesi ose shokët/shoqet.



Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **A** të shtypit, të madhe dhe të vogël.



Prezanton grafikun e shkronjës **A** të madhe.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Ndiqet e njëjta veprimtari për grafikun e shkronjës **a** të vogël. Disa nxënës në tabelë e shkruajnë shkronjën **A**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me videoprojektor grafikun e shkronjës **A a** me anë të një videoje ilustruese.*

Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **A a** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.).

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 8 dhe shqiptojnë shkronjën **A a** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **A** është zanore. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalisë nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **a** në fjali dhe komentojnë fjalinë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekstin mësimor (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato).

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Dallojnë vendin e shkronjës (tingullit) **A a** në fjalët:

ARIU

- Ku e dëgjoni tingullin **A** te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund?-(në fillim).

Nxënësit nënvizojnë shkronjën **A a** tek fjala **ARIU** - **a**riu

- Po te figura e dytë (**ARA**) ku e dëgjoni tingullin **A**? -(në fillim dhe në fund).

Nxënësit nënvizojnë shkronjën **A a** tek fjala **ARA** – **a**ra

Përsëritet veprimtaria për fjalët e tjera.

Ushtrimi i dytë: Qarkojnë shkronjën **A a** në fjalët e dhëna.

Ushtrimi i tretë: Ushtrojnë ndarjen e fjalëve në rrokje duke parë modelin në tekst (ndarjen e

fjalëve në rrokje bëhet së bashku me mësuesen).

Ushtrimi i katërt: Ndhimjnë shkronjën **A** për të gjetur motrën e saj të vogël **a**.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit.

Ushtrimi i pestë: Gjejnë ku është fshehur shkronja **A** dhe e ngjyrosin atë.

Lexohet dhe komentohet gjëgjëza (akullorja).

Ushtrimi i gjashtë: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat sipas modelit.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrat në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja *Aa* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja *Aa* e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: diskutim për njohuritë paraprake, bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë tingullin (shkronjën) **A** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës sipas modelit;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: akullorja, arra, dora, aparati, Ana.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, shkumësi, grafiku i shkronjës *Aa* të dorës, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi i parë – Diskutim për njohuritë paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: lojën e asociacionit.

E E NXEHTË	AKULL	E E ËMBËL
DETI	K KOHA	E E KAFTË
PUSHIMET	B BORA	E E SHKRIRË
VERË	I/ E FTOHTË	ÇOKOLLATA

AKULLORJA



Nxënësit bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet:

A ju pëlqejnë akulloret?

Cila ju pëlqen më shumë?

Kur nuk duhet të hamë akullore? Pse?

Me cilën shkronjë fillon fjala **akullore**?

Hapi II

Në tabelë dy nxënës ngjisin etiketat me këto fjalë: **ariu, ora, arra, kau, macja, Arta, Artoni**.

Nxënësit e tjerë aktivizohen ta dallojnë shkronjën **A a**, ta qarkojnë dhe të tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet ajo- (në fillim, në mes apo në fund).

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **A** të dorës, të madhe dhe të vogël.

Prezanton grafikun e shkronjës *A a*.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **A a** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Shqiptohet shkronja **A a** e dorës nga mësuesja, pastaj nga nxënësit në çifte ose në grupe.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

- Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 8 dhe shqiptojnë shkronjën **A a** të dorës. Mësues-i/ja lexon fjalinë dhe nxënësit përcaktojnë shkronjën **A a** të dorës.
- Nxënësit vëzhgojnë fjalët e dhëna poshtë fjalisë dhe përcaktojnë pozicionin e shkronjës a në fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekstin mësimor: (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato).

Ushtrimi i parë: Në mënyrë të pavarur, nxënësit ndjekin gjurmët dhe plotësojnë rreshtat me shkronjën *A a*.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga mësuesi ose shokët/shoqet.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës.

Nxënësit punojnë ushtrimet 3, 4 dhe 5 në fletoren e punës, pasi mësuesi shpjegon kërkesat. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrën në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja I

Mësimi 4.

Shkronja I i e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja I i e shtypit

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitiko - sintetike, marrëdhëniet pyetje-përgjigje, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë tingullin (shkronjën) I në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën I i duke përdorur materiale të ndryshme;
- demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, iriq, fjalët e fjalorit

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, projektor, tv, tablo me foton e iriqit, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës I i të shtypit, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën e iriqit (në projektor, TV ose tabelë) dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: - Çfarë shikoni në figurë?




- Keni parë ndonjëherë iriq?
- Çfarë ngjyre ka? Me çfarë e ka të mbuluar trupin? Ku jeton iriqi? etj.
- Me cilin tingull fillon fjala **iriq**? - (me tingullin I)
- Kujt i fillon emri me këtë tingull të ngrejë dorën?

Vijon diskutimin për të verifikuar pozicionin e tingulli I në mes apo në fund të emrave të tjerë në klasë.

Hapi II

Mësues-i/ja shkruan fjalën **IRIQ** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **I**. Më pas shpjegon se ndarja e fjalës në rrokje bëhet duke lëvizur duart majtas – djathtas. Demonstrim nga nxënësit dhe mësuesi së bashku.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **I - RIQ**
- Fjala **IRIQ** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **I**? - (në fillim, në mes dhe në fund)



- Nxënësit emërtojnë fotot e paraqitura në projektor dhe tregojnë pozicionin e tingullit **I** në to.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimin dhe prezanton shkronjën **I i** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet ajo nga mësuesi dhe nxënësit.



Prezanton grafikun e shkronjës

Shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **I i** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Punojnë në grupe shkronjën **I, i** me plastelinë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor grafikun e shkronjës **I i** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 13 dhe shqiptojnë në çifte shkronjën **I i** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **I** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit "**Iriq**" nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **I i** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekstin mësimor (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Dallojnë vendin e shkronjës (tingullit) **I i** në fjalët:

ISHULL

- Ku e dëgjoni tingullin **I** te kjo fjalë: në fillim, në mes apo në fund? (Në fillim)

Nxënësit nënvizojnë ose qarkojnë shkronjë **I** tek fjala **ISHULL**

- Po te figura e dytë (**INTERNET**) ku e dëgjoni tingullin **I**? -(në fillim)

Nxënësit nënvizojnë ose qarkojnë shkronjë **I** tek fjala **INTERNET**.

Përsëritet veprimtaria për fjalët e tjera.

Ushtrimi i dytë: Ushtrojnë ndarjen e fjalëve në rrokje duke parë modelin në tekst -(ndarja e

fjalëve në rrokje bëhet së bashku me mësuesen).

Ushtrimi i tretë: Ndhimojnë shkronjat **I, i** të mbërrijnë në ishull (ndjekin labirintin).

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Lexohet dhe komentohet gjëgjëza (interneti).

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i detyrave nga nxënësit.

Ushtrimi i katërt: Gjejnë dhe rrumbullakojnë shkronjat **I i**.

Ushtrimi i pestë: Nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrën në fletoren e punës.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **I i**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja **I i** e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **I i** e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë tingullin (shkronjën) **I i** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës sipas modelit;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë, rrokje, fjalë, fjalët e fjalorit

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, shkumësi, grafiku i shkronjës **I i** të dorës, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit zbulojnë një nga një fotot e vendosura përmbys në tabelë, të cilat janë të shoqëruara me fjalët:

QIRIRI

IBRIKU

GISHTI

FIKU

ILIRI

Më pas gjejnë çfarë kanë të përbashkët fjalët (Cilën shkronjë?)? Shqiptohet ajo nga nxënësit

në grupe dhe shkruhet në tabelë shkronjat **I i** nga disa nxënës.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **I i** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte.

Prezanton grafikun e shkronjës **I i**

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabela e tyre plastike ose fletë të bardha. Bëhet krahasimi i shkronjës **I i** të dorës me atë të shtypit.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor grafikun e shkronjës **I i** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 15 dhe shqiptojnë shkronjën **I i** të dorës, që ndodhet në krye të faqes. Mësues-i/ja lexon fjalinë dhe nxënësit vëzhgojnë **I i** shkronjat të dorës dhe përcaktojnë pozicionin e saj në fjalët: Ina, Iliri. Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e njerëzve.

Nxënësit të pavarur punojnë ushtrimin e parë.

Ushtrimi i parë: Ndjekin gjurmët dhe plotësojnë rreshtat me shkronjën **I i** të dorës.

Reflektim

Hapi IV – Punë në fletore pune

Komentojnë së bashku me mësuesin figurën e ISHULLIT.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i dytë: Shkruajnë dhe lexojnë fjalën **ai**. Shpjegohet përdorimi i fjalës **ai**.

Mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **i** me shkronjën **a** për të formuar rrokjet: ia, ai.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë të pavarur me shkronja dore shkronjën **I i** dhe rrokjet ai, ia.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **I i** të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja M

Mësimi 5.

Shkronja M m e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **M m** e shtypit **Tipi i orës:** Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, marrëdhëniet pyetje- përgjigje etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë tingullin (shkronjën) **M** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën **M m** duke përdorur materiale të ndryshme;
- demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, rrokje, fjalë, mami, fjalët e fjalorit

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tablo me foton e mamit, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **M m** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit prezantojnë familjen e tyre duke u përgjigjur me përgjigje të plota në pyetjet: Sa anëtarë ka familja juaj? Cilët janë anëtarët e familjes tuaj? Kush ju ndihmon për të bërë detyrat? Kush kujdeset për higjienën tuaj? etj.


Të gjithë nxënësit shqiptojnë fjalën **MAMI** dhe mësuesi verifikon sesi ata e shqiptojnë tingullin **M**.

Hapi II

Mësuesi shkruan fjalën **MAMI** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit)

M. Nxënësit së bashku me mësuesin demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **MA –MI**
- Fjala **MAMI** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **M**? (Në fillim dhe në mes)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që kanë në trup të tyre shkronjën (tingullin) **M**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimin dhe prezanton shkronjën **M m** të shtypit, të madhe dhe të vogël.

Prezanton grafikun e shkronjës.

M m

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në grupe ndërtojnë shkronjën **M m** me materiale të sjella në klasë ose e shkruajnë atë në tabela plastike/fletë të bardha.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t’u prezantojë nxënësve me projektor grafikun e shkronjës **M m** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 16 dhe shqiptojnë shkronjën **M m** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **M** është bashkëtingëllore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit “**Mami**” nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **M m** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Ndajnë fjalët në rrokje dhe shkruajnë numrin e rrokjeve. Qarkojnë shkronjën **M m** në fjalët e dhëna.

Shembull: MIU

DIMRI

molla etj.

2

2

2

Ushtrimi i dytë: Lidhin me shigjetë rrokjet dhe shkruajnë fjalët e krijuara mami, MAMI .

Ushtrimi i tretë: Zbulojnë shkronjën **M m** dhe e ngjyrosin me të kuqe.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë numrat dhe krijojnë personazhin Miki mouse .

Ushtrimi i pestë: Nxënësit shikojnë modelin e shkronjës **M m** dhe plotësojnë rreshtat.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrën e parë në fletoren e punës.

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **M m**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja Mm e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Mm e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë me anë të dëgjimit, fjalët që e përmbajnë tingullin **M** në pozicione të ndryshme;
- shqiptojnë dhe identifikojnë shkronjën Mm të dorës në pozicione të ndryshme;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje dhe fjalë me shkronja dore të mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst;

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë, rrokje, fjalë, fjalët e fjalorit

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletorja e punës, tabela, shkumësi, projektor/tv, grafiku i shkronjës Mm e dorës, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Loja stop – përjashto

Ora fillon me këtë aktivitet: Në tabelë nxënësit ngjisin disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

MURI MAKINA DORA MIA ROSA ARRA MAJMUNI TERMOMETRI MOLLA

Luhet loja **stop - përjashto**. Mësuesi lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjojnë **M** të thonë një apo dy herë **stop** (MURI – një herë, MAJMUNI – dy herë), kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **M** të thonë **përjashto**.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **M** të dorës, të madhe dhe të vogël.

Shqiptohet ajo nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikën e shkronjës Mm të dorës. Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë në tabela plastike shkronjën Mm të dorës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e

shkronjës Mm të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 18 dhe shqiptojnë shkronjën Mm të dorës. Mësues-i/ja lexon fjalinë dhe nxënësit vëzhgojnë shkronjat M të dorës. Shpjegohet rëndësia e mollës dhe frutave të tjera për shëndetin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Përcaktojnë pozicionin e shkronjës M të dorës në fjalë.

Ushtrimi i dytë: Ndjekin gjurmët dhe plotësojnë rreshtat me shkronjën Mm të dorës.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV- Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Ushtrimi i tretë: Vizatojnë një objekt që fillon me shkronjën M. Nxënësit punojnë ushtrimet 2 dhe 3 në çifte në fletoren e punës.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë në fletoren e punës.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën Mm të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja N

Mësimi 6.

Shkronja N n e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **N n** e shtypit **Tipi i orës:** Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, stuhi mendimesh, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë tingullin (shkronjën) **N** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën **N n** duke përdorur materiale të ndryshme;
- demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, natë, ditë, fjalët e fjalorit

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, projektor, tv, glob, elektrik dore, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **N n** të shtypit, mjete vizatimi etj.

Evokim


Hapi I – Veprimtari paraprake

Mësimi fillon me gjëgjëzën.

Njëra vjen e tjetra ikën,

E para më zgjon e dyta ninullë më këndon .

(Dita dhe nata)



Nxënësit shprehin lirshëm mendimin e tyre dhe mësuesja plotëson skemën në tabelë.

Mësuesja me videoprojektor paraqet krijimin e ditës dhe natës duke shpjeguar hap pas

hapi në përshtatje me moshën. Në pamundësi që të realizojë këtë veprimtari. Ai mund të marrë një glob e një elektik dore (fener) dhe të shpjegojë se ç'ndodh kur Toka rrotullohet, po qe se drejtoni për kah globi shkulmin e dritës së një elektriku dore.

Hapi II

Mësues-i/ja kërkon që nxënësit të shqiptojnë fjalën **NATË** dhe verifikon sesi ata e shqiptojnë tingullin **N**. Më pas shkruan fjalën **NATË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e shkronjës (tingullit) **N**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **NA -TË**

Fjala **NATË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **N**? (Në fillim)



Një nxënës emërton disa nga objektet, që ndodhen në klasë. Nxënësit e tjerë sa herë dëgjojnë tingullin **N** në fjalë, bërtasin URRRA. Nxiten të tregojnë edhe pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **N**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **N n** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Nxënësit në grupe e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **N n** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe mund modelohet shkronja **N n** me mjete te ndryshme (shkrepëse, oriz, makarona etj.).

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës N n me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 20 dhe shqiptojnë shkronjën **N n** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **N** është bashkëtingëllore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Dita dhe nata”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **N n** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Ndajnë fjalët në rrokje dhe ngjyrosin aq rathë sa rrokje ka fjala. Qarkojnë shkronjën **N n** në fjalët e dhëna.

Ushtrimi i dytë: Plotësojnë katrorët me shkronjën e duhur.

Ushtrimi i tretë: Presin dhe ngjisin shkronjën që duhet në fjalët e mëposhtme. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të detyrave

Ushtrimi i katërt: Nxënësit shikojnë modelin e shkronjës **N n** dhe plotësojnë rreshtat.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.


Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrën e parë dhe të dytë në fletoren e punës. Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **N n**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja  e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të njohë fjalën si bashkësi tingujsh (shkronjash) me një kuptim.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë dhe identifikojnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës në pozicione të ndryshme;
- shkruajnë shkronjën  të dorës sipas modelit;
- lexojnë e shkruajnë rrokje me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin;
- shkruajnë me të diktuar shkronjat e dorës, që kanë mësuar deri tani, rrokje dhe fjalë me to.
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, ninullë, rrokje, fjalët etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, projektor, tv, CD, kompjuter, tabelë, shkumës, grafiku

i shkronjës  të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, tabak letre etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe më pas e komentojnë ninullën duke u përgjigjur me përgjigje të plota për pyetjet: Si u ndjetë gjatë këndimit? A ju pëlqejnë ju ninullat? Kujt i këndohen ninullat? Kush i vë fëmijët në gjumë? Në cilat fjalë e dëgjuat tingullin N gjatë këndimit? etj.

Hapi II - Lojë

Nxënësit ndahen në 2 grupe. Të gjithë nxënësit e grupit të parë shkruajnë shkronjën **N** të madhe në fletë A4, kurse të grupit të dytë shkruajnë shkronjën **n** të vogël. Kur mësuesi **përplas duart**, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave **N n**.


Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë në tabelë: **N, n, NA, NI, AN, IN, ANA, NINA**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri


Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën  të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **N n** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës  të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 22 dhe shqiptojnë shkronjën **N n**. Mësues-i/ja lexon fjalinë dhe

nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjave  të dorës me shkronjat e tjera. Theksohet përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **n** me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet na, ni, an, in, Na, Ni.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimin i parë. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në fletore pune

Shënim: Nëse nxënësit kanë pasur vështirësi në plotësimin e detyrës në fletore pune. Mësuesi mund të zhvillojë këtë aktivitet në klasë.

Ngre para tabelës dy nxënës, të cilëve u jep të mbajnë në dorë etiketat me shkronjat **N** dhe **A**. U kërkon nxënësve të afrohen me njëri-tjetrin.

- Çfarë u formua? (rrokja **NA**).
- Ndërroni vendet. Po tani, çfarë formohet? (rrokja **AN**). Lexohen rrokjet e formuara nga nxënësit e tjerë.

Çifti nga dy nxënës të tjerë formon rrokjet: **NI, IN**.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë me shkronja dore rrokjet sipas modelit: **na, ni, an, in**. Gjatë punës mësuesja i ndihmon në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.

Ushtrimi i pestë: Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, rrokje dhe fjalë.

Shembull (sugjerim): N, n, ma, mi, mami, mami im, Ana, Ani. Diktimin mësuesja e bën në përshtatje me nivelin e nxënësve.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

U sugjerohen ushtrime në Fletoren e punës.

Shkruajnë dy rreshta me shkronjë **N n** të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja R

Mësimi 7.

Shkronja R r e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **R r** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të lidhë tingullin me shkronjën e duhur (përkatëse);
- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- t'i bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, stuhi mendimesh, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë shkronjën **R r** në fjalët e dhëna dhe përcaktojnë pozicionin e saj;
- shkruajnë shkronjën **R r** të shtypit sipas modelit;
- krijojnë dhe lexojnë rrokje me shkronjat e mësuara;
- bashkojnë rrokje dhe krijojnë fjalë;
- modelojnë shkronjën **R r** me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor;
- shprehin lirshëm mendimet e tyre.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, rrokje, reja, fjalët e fjalorit.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, cd, radio, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **R r** të shtypit, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Kur bie shi”.
Më pas bëjnë një koment të shkurtër në pyetjen: Çfarë ju shkon ndër mend kur dëgjoni fjalën reja? Nxënësit shprehin mendimet e tyre.



Nxënësit shqiptojnë fjalën **RE** dhe mësuesi verifikon sesi ata e shqiptojnë tingullin **R**.
Më pas shkruan fjalën **RE** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e tingullit

dhe shkronjës **R**.

Nxënësit së bashku me mësuesin demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **RE**

Fjala **RE** ka 1 rrokje. Ku ndodhet shkronja **R**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që fillojnë me tingullin **R** ose kanë në trup të tyre **R**.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **R r** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **R r** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe mund të modelohet shkronja **R r** me mjete të ndryshme (shkrepëse, oriz, makarona etj).

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **R r** me anë të një videoje ilustruese.*

Disa nxënës në tabelë shkruajnë shkronjën **R r**.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 23 dhe shqiptojnë shkronjën **R r** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **R** është bashkëtingëllore. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit “**Retë**” nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **R r** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Dallojnë vendin e shkronjës **R r** në fjalët e dhëna dhe lexojnë rrokjet me ngjyrë të kuqe.

Ushtrimi i dytë: Vendosin shkronjat në rendin e duhur dhe formojnë fjalën ROSA duke u mbështetur në figurë. Mësuesi ndihmon nxënësit që kanë vështirësi.

Ushtrimi i tretë: Qarkojnë zanoret në grupin e shkronjave të dhëna. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të detyrave

Ushtrimi i katërt: Nxënësit shikojnë modelin e shkronjës **R r** dhe plotësojnë rreshtat.

Ushtrimi i pestë: Bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokjet.

Shembull

m+i=mi m + a = ma i + n = in a + n = an

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Nxënësve u sugjerohet të punojnë detyrën e dytë në fletoren e punës.

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **R r**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vrejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja R r e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja R r e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë, diskutim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë dhe identifikojnë shkronjën R r të dorës;
- shkruajnë shkronjën R r të dorës sipas modelit;
- lexojnë e shkruajnë rrokje me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin;
- shkruajnë me të diktuar shkronjat e dorës, që kanë mësuar deri tani, rrokje dhe fjalë me to;
- punojnë ushtrimet;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, fotografi, kompjuter, projektor, tv tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës R r të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, tabak letre etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën e robotit (në projektor, TV ose tabelë) dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? A ju pëlqen ju roboti? Përse mund të përdoret roboti? Me cilin tingull fillon fjala robot?

Hapi II

Nxënësit ndahen në 2 grupe. Të gjithë nxënësit e grupit të parë shkruajnë shkronjën R të madhe në fletë A4, kurse të grupit të dytë shkruajnë shkronjën r të vogël. Kur mësuesi **përplas duart**, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave R r.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën R r të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave R r të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në

tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës R r të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 25 dhe shqiptojnë shkronjën R r të dorës. Mësues-i/ja lexon

shprehjen **Roboti im** dhe nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjave R r të dorës me shkronjat e tjera. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **R r** me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet Ra, Ro, ra, ri, ar.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimin i parë. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Punojnë **ushtrimin 2** së bashku me mësuesin. Ndajnë fjalinë në fjalët përkatëse. Reja ra në mal.

Reflektim

Hapi V – Punim i ushtrimeve në fletoren e punës

Ushtrimi i parë: Emërtojnë figurat dhe plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë. Mësuesi ndihmon nxënësit, që kanë vështirësi në lidhjen e shkronjave me njëra-tjetrën.

Ushtrimi i katërt: Rendisin fjalët dhe shkruajnë fjalinë me shkronja dore sipas modelit. Ana ra nina – nina .

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me të diktuar (sugjerim): ra, ri, ara, ari, Rina

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

U sugjerohen ushtrime në fletoren e punës.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën R r të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja E

Mësimi 8.

Shkronja E e e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **E e** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë - tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë shkronjën **E e** në fjalët e dhëna dhe përcaktojnë pozicionin e saj;
- shkruajnë shkronjën **E e** të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën **E e** me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor;
- shprehin lirshëm mendimet e tyre;
- ndajnë fjalët në rrokje.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: tingull-shkronjë, erë, fjalët e fjalorit.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, CD, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **E e** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Trokiti vjeshta".

Hapi II

Nxënësit shqiptojnë fjalën **ERË** dhe mësuesi verifikon sesi ata e shqiptojnë tingullin **E**. Më pas shkruan fjalën **ERË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **E**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **E-RË**.
- Fjala **ERË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **E**? (Në fillim)

Nxënësit emërtojnë figurat e paraqitura në tv dhe tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet


tingulli E .

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **E e** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **E e** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe mund të punohet(modelohet) shkronja E e me mjete të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepe, oriz, makarona etj).

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës E e me anë të një videoje ilustruese.

Disa nxënës në tabelë e shkruajnë atë.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 27 dhe shqiptojnë shkronjën **E e** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **E** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Fuqia e erës”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **E e** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Vështrojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e fjalëve nga mësuesi. Ndajnë fjalët në rrokje dhe qarkojnë shkronjën E e.

Shembull: EKRAN 2 RAKETA 3

Ushtrimi i dytë: Bashkojnë pikat dhe plotësojnë vizatimin.

Lexohet dhe komentohet gjëgjëza për errësirën.

Ushtrimi i tretë: Identifikojnë shkronjën **E e** në grupin e shkronjave të dhëna duke ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër gjurmët e elefantit, që mbajnë shkronjën **E e**.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit.

Ushtrimi i katërt: Në mënyrë të pavarur, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjën **E e** duke parë modelin e dhënë.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

U sugjerohen ushtrimet në fletoren e punës.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjë E e. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja *E e* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *E e* e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë dhe identifikojnë shkronjën *E e* të dorës;
- shkruajnë shkronjën *E e* të dorës sipas modelit;
- lexojnë shkronja, rrokje e fjalë me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë me të diktuar shkronjat e dorës që ka mësuar deri tani, rrokje dhe fjalë me to.
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, gjëegjëzë etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, fotografi, kompjuter, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës *E e* të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, tabak letre etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Dy nxënës ngjisin në tabelë etikata me këto fjalë: **Ema, elefanti, VEZA, dele, ena, QENI**

Nxënësit e tjerë dallojnë shkronjën **E e**. Më pas e qarkojnë dhe tregojnë pozicionin, në të cilin ndodhet (në fillim, në mes apo në fund të fjalës).

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë në tabelë: **E, e, ME, EM, RE, ERA, EMA, ena.**

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën *E e* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **E e** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës *E e* të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 30 dhe shqiptojnë shkronjën $\mathcal{E}$ e të dorës. Mësues-i/ja lexon **Ema dhe Ana** dhe nxënësit dëgjojnë, pastaj lexojnë në heshtje. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **E e** me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet: me, em, re, Em.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e parë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit. Vazhdojnë punimin e ushtrimeve në fletoren e punës, pasi mësuesi udhëzon hap pas hapi për plotësimin e tyre.

Ushtrimi i dytë: Emërtojnë figurat dhe plotësojnë fjalët me shkronjën **e**.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në fletoren e punës. Ushtrimi i katërt: Ndajnë fjalën në rrokje dhe shkronja.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore sipas modelit e, me, em, Eni, emri, era. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga mësuesja.

Ushtrimi i gjashtë (diktim): Mësuesja u dikton nxënësve shkronjën e re, rrokje dhe fjalë.

Shembull (sugjerim): E, e me, em, Ema, era.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

U sugjerohet të punojnë ushtrimet, që nuk kanë arritur t'i përfundojnë në klasë.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën $\mathcal{E}$ e të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Përsëritje për shkronjat A a, I i, M m, N n, R r, E e

Mësimi 9.

Përsëritje për shkronjat A a, I i, M m, N n, R r, E e të shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mëimit : Përsëritje për shkronjat **A a, I i, M m, N n, R r, E e** të shtypit

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali.

Metodat dhe teknikat: bisedë, metoda fonetike – alfabetike, analizë – sintezë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt **A, I, M, N, R, E**;
- dallojnë shkronjat e mësuara **A, I, M, N, R, E** dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- formojnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë me shkronja shtypi e dore fjalë;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: shkronjat **A, I, M, N, R, E**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj. etj.

Mjetet e mëimit: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **A, I, M, N, R, E**, tabela plastike, figura, fletë formati, cd, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Kënga e alfabetit”. Më pas e komentojnë atë duke u përgjigjur me përgjigje të plotë në pyetjet:

- Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe?
- Cilat shkronja kemi mësuar deri tani?

Mësues-i/ja paraqet para nxënësve etiketat me të katër modelet e secilës shkronjë të mësuar dhe nxënësi i emëron ato.

Përsëritje për shkronjat *A a I i M m N n R r E e* të dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat *A a I i M m N n R r E e* të dorës

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë – sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë shkronjat e mësuara në një grup shkronjash të dhëna;
- krijojnë fjalë e fjali të thjeshta;
- kthejnë fjalët e fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë me të diktuar rrokje e fjalë me shkronjat e mësuara.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjat **A, I, M, N, R, E**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **A, I, M, N, R, E**, tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – lojë në grupe

Nxënësit e ndarë në grupe punojnë me nga një shkronjë.

Çdo grup do të gjejë sa më shumë fjalë (figura), që kanë në trup të tyre shkronjën e caktuar dhe do t'i ngjisin në një tabak letre. Më pas një përfaqësues i grupit prezenton para klasës punën e grupit të vet. Shpallet grupi fitues.

Shembull – shkronja A

ARIU, ANANASI, ARRA, ANIJA, AKULLORJA, URA, ANA, ORA, BRESHKA

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë në fletore pune

Nxënësit hapin fletoren e punës dhe punojnë ushtrimet e dhëna, pasi mësuesi lexon e shpjegon kërkesat.

Ushtrimi i parë: Nxënësit të pavarur ngjyrosin shkronjat e mësuara.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit të pavarur qarkojnë vetëm zanoret.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit të pavarur bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalë. Fjalët i shkruajnë me shkronja shtypi dhe dore.

Ushtrimi i katërt: Nxënësit në çifte rendisin rrokjet dhe krijojnë fjalë.

Shembull: PIRAT, LIBËR, ARIANI

Ushtrimi i pestë: Rendisin fjalët dhe krijojnë fjali. Fjalinë e shkruajnë me shkronja dore.

Shembull: Era ra nina – nina.

Reflektim

Hapi III – Diktim

Mësuesja u dikton nxënësve fjalët.

Shembull (sugjerim): mami, ime, mami ime, Ani, Eri, Ani me Erin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune.

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në katër format e saj. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja Ë

Mësimi 10.

Shkronja Ë ë e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Ë ë e shtypit **Tipi i orës:** orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: tingull - shkronjë, shkronjë – tingull;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, bisedë, lexim i drejtuar

Format e punës: frontale, individuale, në çifte

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin Ë duke e lidhur me shkronjën Ë;
- shkruajnë shkronjën Ë ë të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën Ë ë me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet e dhëna.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: shkronja Ë ë, rrokje, fjalë, ëndërr, planet, vështro, vendos, lexo, shkruaj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, cd, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës Ë ë të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format, projektor/tv etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe këndojnë këngën “Ëndrra - Amela Agastra”. Më pas e komentojnë atë duke u ndihmuar nga pyetjet: Kur i shohim ëndrrat? A ju pëlqejnë ju ëndrrat? Kujt ia tregoni ëndrrat? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalën **ËNDËRR**. Mësues-i/ja bën kujdes që tingulli Ë të shqiptohet sa më saktë. Shkruan fjalën **ËNDËRR** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës Ë.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **ËN-DËRR**.
- Pra, fjala **ËNDËRR** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja Ë? (Në fillim dhe në mes)

Nxënësit thonë fjalë që fillojnë ose e kanë në trup shkronjën Ë dhe mësuesi i shkruan në tabelë duke bërë dallimin e shkronjës Ë me një ngjyrë tjetër.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Ë ë** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Ë ë** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe mund të punohet shkronja **Ë ë** me mjete të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepe, oriz, makarona, fije etj.).

Nxënësit krahasojnë grafikun e shkronjës **Ë ë** me **E e**.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Ë ë** me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 35 dhe shqiptojnë shkronjën **Ë ë** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Ë** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Ëndrra”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **Ë ë** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Nxënësit në çifte vështrojnë dhe dallojnë vendin e shkronjës **Ë ë**. Lexojnë rrokjet me ngjyrë të kuqe.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit të pavarur vendosin ku mungon shkronja **Ë ë**.

Reflektim

Hapi III – Nxënësit vazhdojnë punimin e ushtrimeve në tekst.

Ushtrimi i tretë: Ndjekin gjurmët dhe plotësojnë rreshtat me shkronjat **Ë ë**.

Gjatë punës mësuesi vëzhgon punën e nxënësve bankë më bankë, u jep sugjerimet përkatëse për çdo ushtrim dhe ndihmon nxënësit që kanë vështirësi.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Ë ë**.

Punojnë ushtrimet në Fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin: _____

Shkronja e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja  e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë shkronjën  të dorës;
- shkruajnë shkronjën  të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me të diktuar fjalë me shkronjat e dorës që kanë mësuar;
- punojnë ushtrimet e dhëna në tekstin mësimor dhe fletoren e punës.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, fotografi, kompjuter, projektor/tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës  të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, tabak letre etj.

Evokim Hapi I - lojë

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurat e paraqitura në tv/projektor, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

URË KËRPUDHË TOP LUGË GËRSHËRË ËMBËLSIRË QENGJ

Luhet loja **stop - përjashto**. Mësuesi lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjojnë **Ë** të thonë një, dy apo tri herë **stop** (URË – një herë, KËRPUDHË – dy herë, GËRSHËRË – tri herë), kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **Ë** të thonë **përjashto**.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë në tabelë: **Ë, ë, NË, ËN, rë, rërë, nënë etj.**

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën  të dorës. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Ë ë** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës *Ë ë* të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 37 dhe shqiptojnë shkronjën *Ë ë* të dorës, që ndodhet në krye të faqes. Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexojnë **Nëna me Anën.**

Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës *ë* me shkronjat e tjera. Gjithashtu, mësuesi demonstron lidhjen e shkronjës *ë* me shkronjat e tjera për të formuar rrokjet: **më, ëm, rë, në.**

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësuesi lexon e shpjegon kërkesat):

Ushtrimi i parë. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i dytë: Mësuesja lexon ditët e javës dhe nxënësit identifikojnë shkronjën *Ë*.

Nxënësit vazhdojnë punimin e ushtrimeve në fletoren e punës, pasi mësuesi udhëzohen hap pas hapi për plotësimin e tyre.

Ushtrimi i dytë: Emërtojnë figurat dhe plotësojnë fjalën me rrokjen që mungon.

BIMË ngjyrë

Ushtrimi i katërt: Nxënësit shkruajnë rrokje dhe fjalë me shkronja dore sipas modelit të dhënë. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e gjashtë**, nxënësit do të bëjnë analizë të fjalës duke e ndarë atë në rrokje e shkronja.

Ushtrimi i shtatë (Diktim): Mësuesja u dikton nxënësve fjalët.

Shembull (sugjerim): nënë, erë, mirë

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime 5 në fletore pune dhe në tekstin mësimor.

Shkruajnë 2 rreshta me grafikun e shkronjës *Ë ë* të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimi _____

Shkronja L

Mësimi 11.

Shkronja L I e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **L I** e shtypit **Tipi i orës:** orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë me anë të dëgjimit, fjalët që e përmbajnë tingullin **L** (në pozicione të ndryshme);
- ndajnë fjalët në rrokje;
- shkruajnë shkronjën **L I** të shtypit sipas modelit;
- punojnë ushtrimet.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjë **L I**, tingull, rrokje, fjalë, lodër, vështro, vendos, lexo, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, CD, projektor/tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **L I**

të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi i parë – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Lodrat”. Më pas bëjnë një koment të shkurtër për lodrat duke u përgjigjur në pyetjet:



- A luani ju me lodra? Cila është lodra juaj e preferuar? Si duhet të silleni kur luani me lodra me shokë/shoqe? Cila ka qenë lodra e fundit që keni fituar dhuratë? Kush ju dhuron më shumë lodra? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalën **LODËR**. Mësues-i/ja bën kujdes që tingulli **L** të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **LODËR** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e tingullit dhe shkronjës **L**. Nxënësit së bashku me mësuesen bëjnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **LO-DËR**.
- Pra, fjala **LODËR** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **L**? (Në fillim)




Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin **L** (lepur, mi, luan, iriq, male, pulë, lejlek etj.) dhe të përcaktojnë pozicionin e tij në to.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **L I** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **L I** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **L** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës ngrihen në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **L I** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 39 dhe shqiptojnë shkronjën **L I** të shtypit që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **L** është bashkëtingëllore. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit "**Labirinti**" nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **L I** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Mësuesi lexon fjalët dhe së bashku me nxënës i ndan ato në rrokje. Më pas nxënësit ngjyrosin aq rathë sa rrokje ka fjala dhe qarkojnë shkronjën **L I**.

P.sh.: LIQEN - ngjyrosin 2 rathë

Ushtrimi i dytë: Nxënësit të pavarur bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Kontrollonhet puna e nxënësve duke dhënë sugjerimet e vlerësimet përkatëse.

Reflektim

Hapi V -Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës.

Ushtrimi i parë: Ndhmojnë luanin të gjejë shkronjat e emrit të tij në labirint.

Ushtrimi i dytë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që duhen.

Shembull: TËRFIL lahuta

Vlerësimi: Vlerësim i nxënësve për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruaj 2 rreshta me shkronjën **L I**.

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja L l e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja L l e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë – sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën L l të dorës;
- shkruajnë shkronjën L l të dorës sipas modelit;
- shkruajë rrokje e fjalë me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor dhe fletore pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, fotografi, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës L l të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, tabak letre etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit shikojnë me kujdes figurat në projektor/tv ose tabelë, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

LUANI ROBOTI TORTA LULJA LIMONI TELEFONI

Mësuesja shpjegon rregullat e lojës. Te fjalët që dëgjoni tingullin L, ngreni dorën lart. Përsëritet loja disa herë. Në çifte nxënësit shkruajnë shkronjat L l. Në momentin kur mësuesja përplas duart, nxënësit formojnë çiftet e shkronjave L l.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën L l të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës L l të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave L l të shtypit nga të dorës. Më

pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë shkronjën në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 40 dhe shqiptojnë shkronjën *L l* të dorës.

Mësues-i/ja lexon ***Luli luan me labirint*** dhe nxënësit dëgjojnë e shikojnë me vëmendje lidhjen e shkronjës **L l** me shkronjat e tjera. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **l** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekstin e nxënësit dhe fletoren e punës (pasi mësuesi udhëzon hap pas hapi për plotësimin e tyre):

Ushtrimi i parë: Plotësojnë në mënyrë individuale me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i dytë: Vizatojnë veglën muzikore që përmban shkronjën L. Vazhdojnë punimin e ushtrimeve në fletoren e punës.

Ushtrimi i tretë: Formojnë, lexojnë dhe shkruajnë me shkronja dore fjalët. mali nëna

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të detyrave .

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore rrokjet.

Mësuesja ndjek nga afër punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Vlerësimi: Vlerësim i nxënësve për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën *L l* . Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja U

Mësimi 12.

Shkronja U u e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **U u** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjat dhe t'i shqiptojë ato sipas metodës: *tingull - shkronjë, shkronjë – tingull*;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjalë.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë shkronjën **U** në një grup shkronjash të dhëna;
- shkruajnë shkronjën **U u** të shtypit sipas modelit;
- ndajnë fjalën në rrokje;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- punojnë ushtrimet në tekstin e nxënësit;
- modelojnë shkronjën **U u** me materiale të ndryshme.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë **U u**, tingull, rrokje, fjalë, urë, qarko, rendit, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **U u** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën e urës në tabelë dhe bëjnë një koment të shkurtër për të.




Përgjigjen me përgjigje të plotë në pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? A ka ura në vendlindjen tuaj? Pse njerëzit i ndërtojnë urat? Me cilin tingull fillon emri urë? Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **URË** dhe mësues-i/ja bën kujdes që tingulli **U** të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **URË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e tingullit dhe shkronjës **U**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **U-RË**.
- Pra, fjala **URË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **U**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që kanë në trup të tyre shkronjën U. Mësuesi i shkruan fjalët në tabelë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **U u** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës .



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **U u** në tabela magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **U** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës ngrihen në tabelë për të shkruar grafikun e saj. *Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës U u me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV- Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 42 dhe shqiptojnë shkronjën **U u** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **U** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Ura e re”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **U u** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Nxënësit emërtojnë figurat dhe qarkojnë shkronjën **U u** .

Ushtrimi i dytë: Duke u bazuar në ilustrim nxënësit rendisin shkronjat dhe krijojnë fjalë.

Shembull: muri ALBUM

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në tekst dhe fletoren e punës.

Ushtrimi i tretë: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Ushtrimi i parë: Identifikojnë shkronjën U u në grupin e shkronjave të dhëna duke e ngjyrosur me ngjyrë të kuqe.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën **U u**.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Shkronja U u e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja U u e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën U u të dorës;
- shkruajnë shkronjën U u të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor dhe fletore pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, etiketa, kompjuter, projektor/tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës U u të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora fillon me këtë aktivitet:

Mësues-i/ja u jep nxënësve në grupe etiketa me shkronjat e mësuara dhe për disa minuta i udhëzon të formojnë fjalë me to.

Fjalët që formojnë nxënësit shkruhen në tabelë dhe lexohen. Shembull : *ura, nëna, Emi, muri, Ana, luani, mali etj.*

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën U u të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave U u të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës U u të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 44 dhe shqiptojnë shkronjën  të dorës. Mësues-i/ja lexon **Unë jam** dhe nxënësit shkruajnë emrin e tyre (Emrin mund ta shkruajnë edhe me shkronja shtypi). Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **u** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësues-i/ja lexon e shpjegon kërkesat):

Ushtrimi i parë: Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokje. Më pas lexojnë rrokjet e formuara. Shembull: mu um un nu

Ushtrimi i katërt: Nxënësit lexojnë dhe shkruajnë me shkrim dore fjalinë e dhënë. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i gjashtë (Diktim): Mësuesja u dikton nxënësve fjalët. Sugjerim: mu, ri, muri.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja K

Mësimi 13.

Shkronja K k e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **K k** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **K** duke e lidhur me shkronjën **K**;
- shkruajnë shkronjën **K k** të shtypit sipas modelit;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- punojnë ushtrimet në tekstin e nxënësit;
- modelojnë shkronjën **K k** me materiale të ndryshme;
- rendisin fjalët dhe krijojnë fjali;

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore etj.

Fjalë kyçe: shkronjë **K k**, tingull, rrokje, fjalë, klasë, qarko, rendit, shkruaj , lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **K k** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën "Klasa jonë". Nxënësit shikojnë në projektor/tv ose tabelë figurën e klasës dhe bëjnë një koment të shkurtër rreth saj: Çfarë shikoni në figurë? Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni fjalën klasë? Si është klasa jonë? Ku ndryshon me klasën që shikoni në figurë? Çfarë mjetesh kemi në klasë? Me cilin tingull fillon emri klasë?

Kujt i fillon emri me këtë tingull të ngrejë dorën?

Le ta shqiptojmë së bashku fjalën **KLASA**. Mësues-i/ja bën kujdes që tingulli **K** të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.


Hapi II

- Shkruan fjalën **KLASA** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e tingullit dhe shkronjës **K**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **KLA-SA**.
- Pra, fjala **KLASA** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **K**? (Në fillim)

Nxënësit tregojnë fjalë tjera që kanë në trup të tyre shkronjën **K**. Mësuesi i shkruan fjalët në tabelë.




Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **K k** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës .



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **K k** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **K k** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **K k** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 45 dhe shqiptojnë shkronjën **K k** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **K** është bashkëtingëllore. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit “**Klasa ime**” nga mësues-i/ja. Vëzhgojnë shkronjën **K k** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë punohet së bashku me mësuesen. Lexohen fjalët e dhëna, ndahen në rrokje dhe qarkohet shkronja **K k**.

Ushtrimi i dytë: Duke u bazuar në ilustrim, nxënësit rendisin fjalët dhe krijojnë fjalinë **Keli ka kek**. Më pas e lexojnë atë.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Ushtrimi i parë: Nxënësit në çifte plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë. Më pas lexojnë fjalët e krijuara së bashku me mësues-in/en.

Shembull: KOMPJUTER kamerë

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 3 rreshta me shkronjën **K k**.

Punojnë ushtrimin e dytë në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja *Kk* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *Kk* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të zbatojë rregullat themelore drejtshkrimore: shkronja e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e njerëzve, qyteteve dhe fshatrave (vendi i vet dhe rrethina), emri i shkollës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Kk* të dorës;
- shkruajnë shkronjën *Kk* të dorës sipas modelit;
- lexojnë e shkruajnë rrokje, fjalë e fjali të thjeshta;
- kthejnë fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- punojnë ushtrimet.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës *Kk* të dorës, tabak letre, hamer, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Nxënësit e ndarë në grupe gjejnë figura kafshësh ose shkruajnë sa më shumë emra kafshësh (gjitarë, peshq, insekte, zvarranikë, amfibë) që kanë në trup shkronjën **K k**. Një anëtar i grupit i shkruan ato në një tabak të bardhë ose i ngjit figurat e kafshëve në tabak.

KALI, KETRI, KROKODILI, KAU, KARKALECI, BRESHKA, KRAPI, KORBI etj

Në fund, një përfaqësues nga secili grup prezanton punën e grupit të vet. Nxënësit së bashku me mësuesin/en numërojnë fjalët e sakta dhe shpallin grupin fitues, të cilit i jep një

shpërblim.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën *Kk* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **K k** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë shkronjën në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës *Kk* të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 47 dhe shqiptojnë shkronjën *Kk* të dorës. Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexon fjalitë: **Keli ka kek. Keku ka mollë, miell dhe arra.** Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **K k** me shkronjat e tjera. Theksohet se fjalia fillon me shkronjë të madhe. Poashtu edhe emrat e njerëzve.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **K k** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesat): **Ushtrimi i dytë:** Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë emrat e vendeve që shohin në figurë.

Shembull: KRAJA KOTORR

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e tretë** nxënësit vështrojnë labirintin. Lexojnë dhe shkruajnë fjalët që gjenden brenda tij. kam, ke, ka, kemi, keni, kanë

Në **ushtrimin e pestë** nxënësit lexojnë fjalitë dhe më pas i shkruajnë me shkronja dore.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën *Kk* të dorës dhe 4 fjalë me shkronjat e mësuara. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja O

Mësimi 14.

Shkronja O o e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **O o** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të përdorë drejt shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **O** duke e lidhur me shkronjën **O**;
- shkruajnë shkronjën **O o** të shtypit sipas modelit;
- krijojnë dhe lexojnë fjalë e fjali të thjeshta, që kanë shkronjën **O** në trup të tyre;
- modelojnë shkronjën **O** me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore etj.

Fjalë kyçe: shkronjë **O o**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, ora, qarko, rendit, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, CD, figura, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës **O o** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën "Ora". Më pas bëjnë një koment të shkurtër për orën duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? Përse u shërben ora? Sa orë në ditë luani? A mësoni ju me orar? Si e organizoni ditën tuaj? Me cilin tingull fillon emri ora? Cilit prej jush i fillon emri me këtë tingull? Cili prej jush e ka këtë tingull brenda emrit të tij? etj. Korrigjohen gabimet që mund të bëjnë nxënësit.


Hapi II

Nxënësit shqiptojmë fjalën **ORË** dhe mësuesi bën kujdes që tingulli **O** të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.


Shkruan fjalën **ORË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e tingullit dhe

shkronjës **O**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **O-RË**.
- Pra, fjala **ORË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **O**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë tjera që kanë në trup të tyre shkronjën O. Mësuesi i shkruan fjalët në tabelë.



Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **O o** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **O o** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **O** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **O o** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 48 dhe shqiptojnë shkronjën **O o** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **O** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Orari”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **O o** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst(pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimin e parë** plotësojnë labirintin.

Në **ushtrimin e dytë** lexojnë fjalët së bashku me mësues-in/en. Ndajnë fjalët në rrokje dhe qarkojnë shkronjën **O o**.

Shembull : ORKESTËR => 3 GOTA => 2 Lexohet dhe komentohet gjëegjëza për orën.

Në **ushtrimin e tretë** bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Reflektim

Hapi V - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit të pavarur bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalë.

Shembull: o + ra => ora O + RA + RI => ORARI

Ushtrimi i tretë: Ushtrohen nxënësit me radhë (zinxhir) në leximin e fjalive të plotësuar me figura në formë teksti. Mësuesi bën kujdes t'u kujtojë nxënësve, që në fund të fjalisë vendoset pikë (.) dhe se emrat e njerëzve shkruhen gjithmonë me shkronjë të madhe.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë tre rreshta me shkronjën **O o**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim in _____

Shkronja O o e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja O o e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë në grupe me detyra të ndryshme.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën O o të dorës;
- shkruajnë shkronjën O o dorës sipas modelit;
- shkruajnë me të diktuar, rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- kthejnë fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore që kanë shkronjën O në trup të tyre;
- punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurative.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës O o të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Nxënësit e ndarë në 4 grupe punojnë detyra të ndryshme.

Gr.1- Shkruajnë shkronja O o dhe e modelojnë me materiale të sjella në klasë. Gr.2- Krijojnë rrokje me shkronjën o.

Gr.3- Shkruajnë fjalë, që në trup të tyre të kenë shkronjën o.

Gr.4- Lexojnë rrokje, fjalë e fjali të thjeshta, që kanë shkronjën o në trup të tyre.

Në fund, një përfaqësues nga secili grup prezenton punën e grupit të vet. Grupet korrigjojnë dhe vlerësojnë punën e njëri - tjetrit.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën O o të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave O o të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë

lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës O o të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 50 dhe shqiptojnë shkronjën O o të dorës.

Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexon fjalinë (ushtrimi i parë): **Ona luan me orar.** Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës O o me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës O o me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësues-i/ja jep udhëzimet për çdo ushtrim):

Ushtrimin i dytë. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit. Flasin për orarin e tyre gjatë ditës (aktivitetet).

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në ushtrimin e parë: Nxënësit në çifte plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i katërt: Nxënësit të pavarur shkruajnë rrokjet sipas modelit.

Ushtrimi i gjashtë (Diktim): Mësuesja u dikton nxënësve Sugjerim: ora, Oli ruan orarin.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën O o të dorës dhe 4 fjalë me shkronjat e mësuara. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja J

Mësimi 15.

Shkronja J j e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja J j e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike – alfabetike, metoda analitike – sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

- identifikojnë me anë të dëgjimit tingullin J dhe pozicionin e tij në fjalë ;
- shkruajnë shkronjën J j të shtypit sipas modelit;
- shkruajnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- lexojnë fjalë e fjali të thjeshta që kanë shkronjën J në trup të tyre;
- modelojnë shkronjën J j me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet e dhëna.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike – alfabetike, metoda analitike – sintetike, demonstrim, bisedë,

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ .

Fjalë kyçe: shkronjë J j, tingull, rrokje, fjalë, fjali, jastëku, qarko, krijo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës J, j të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë figurën e dhënë në projektor dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: Cfarë shikoni në figurë? Për çfarë e përdorim jastëkun? Me cilin tingull fillon emri jastëk? Ku fillon emri me këtë tingull? Mësues-i/ja bën kujdes që tingulli J të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.



Mësues-i/ja mund të vazhdojë diskutimin për të verifikuar pozicionin e tingullit J në mes ose në fund të emrave të nxënësve të tjerë.

Shkruan fjalën JASTËK në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e tingullit dhe shkronjës

J.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **JA-STËK**.
- Pra, fjala **JASTËK** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **J**? (Në fillim)

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes dhe emërtojnë figurat e paraqitura në projektor/tv. Tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **J** në këto fjalë(figura).

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **J j** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **J j** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **J** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës e shkruajnë në tabelë shkronjën **J j**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **J j** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 52 dhe shqiptojnë shkronjën **J j** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **J** është bashkëtingëllore. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **J j** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimi e parë** qarkojnë shkronjën **J j** dhe ngjyrosin aq rathë sa rrokje ka fjala.

Shembull: UJK → U ngjyrosin 2 rathë Jora → dy rathë Në **ushtrimi e dytë** krijojnë rrokje me shkronjën J j.

Shembull: J+A = JA J + E = JE

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Reflektim

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i parë: Lexojnë bashkë me mësuesen fjalinë.

Jora ka jelek jeshil.

Ushtrimi i tretë: Krijojnë fjalë mbi bazën e figurave. Nga çdo figurë marrin shkronjën e parë.

JAKA LOJA UJKU MAJMUNI

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **J j**.

Punojnë ushtrimin e dytë në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Shkronja J j e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja J j dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojë shkronjën J j të dorës;
- shkruajnë shkronjën J j të dorës sipas modelit;
- emërtojnë figurat duke plotësuar fjalëkryqin;
- shkruajnë rrokje me shkronjat e dorës të mësuara duke parë modelin;
- kthejnë fjalë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- lexojnë fjalë e fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore që kanë shkronjën J në trup të tyre;
- punojnë detyrën dhe vlerësojnë punën e njëri – tjetrit në grupe.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës J j të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Në projektor/tv paraqiten foto të ndryshme të fjalëve, që përmbajnë në trup shkronjën J. Nxënësi në grupe i shohin dhe i shkruajnë ato në formë diktimi me shkronja shtypi në një fletë të bardhë A4 ose fletë me vija të gjera dhe të ngushta. Në fund, një përfaqësues nga secili grup del dhe e prezanton punën e grupit të vet para klasës duke i lexuar ato. Nxënësit e grupeve tjera dëgjojnë me vëmendje dhe shikojnë me kujdes, se cili grup ka shkruar më shumë fjalë të sakta. Shpallet grupi fitues.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën J j të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke

e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **J j** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **J j** të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 54 dhe shqiptojnë shkronjën **J j** të dorës.

Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexon fjalinë : **Jora lexon me mamin.** Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **J j** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **J j** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në ushtrimin e katërt nxënësit ushtrohen në leximin zinxhir të fjalive. Vihet theksi te prezantimi i vetes dhe shokëve/shoqeve duke përdorur fjalët me ngjyrë të kuqe: **jam, je, jemi, jeni, janë.**

Nxënësit në grupe para tabelës prezantojnë veten dhe shokët duke përdorur fjalët me ngjyrë të kuqe.

Ushtrimi i pestë: Nxënësit në çifte plotësojnë fjalëkryqin. (lejleku, ora, Jora). Mësuesja përcjell punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit të pavarur shkruajnë rrokjet sipas modelit.

Ushtrimi i shtatë: Shkruajnë fjalinë me shkronja dore.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **J j** të dorës.

Shkruajnë pesë fjalë me shkronja shtypi e dore që kanë në trup shkronjën **J j**.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Përsëritje për shkronjat Ë ë, L l, U u, K k, O o, J j

Mësimi 16.

Përsëritje për shkronjat Ë ë, L l, U u, K k, O o, J j të shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat Ë ë, L l, U u, K k, O o, J j të shtypit

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: bisedë, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt Ë, L, U, K, O, J;

- dallojnë shkronjat e mësuara Ë, L, U, K, O, J dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- formojnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë me shkronja shtypi e dore fjalë;
- lexojnë dhe analizojnë fjalët duke i ndarë në rrokje;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjat Ë, L, U, K, O, J, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, shëno, vendos, lexo, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, grafiku i shkronjave Ë, L, U, K, O, J, tabela plastike, figura, fletë formati, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim Hapi I – lojë

Ora fillon me lojë e asociacionit:

ËNDRRA	LULJA	UJKU	KETRI	ORA	JELEKU
ËMBËLSIRA	LEPURI	URA	KALI	OKTOPODI	JASTËKU
Ë	L	U	K	O	J

SHKRONJAT E MËSUARA NË GRUPIN E DYTË

Hapi II

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes etiketat me të 4 modelet e secilës shkronjë të mësuar dhe në grupe i emërtojnë ato.

Ë e madhe e shtypit, **ë** e vogël e shtypit, **Ë** e madhe e dorës, **ë** e vogël e dorës. Në fund tregojnë se zanore janë: **Ë, U, O** dhe bashkëtingëllore janë: **L, K, J**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 55 dhe punojnë ushtrimet, pasi mësuesi shpjegon ato.

Në **ushtrimin e parë** nxënësit të pavarur shkruajnë fjalët poshtë figurave me shkrim shtypi (**ura, lumi** etj).

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte lexojnë fjalët dhe shënojnë poshtë tyre numrin e rrokjeve.

lejleku → 3 kala → 2

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur shënojnë shkronjën me të cilën fillon fjala dhe shqiptojnë tingullin përkatës.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit në çifte rendisin shkronjat dhe formojnë fjalë (limua, ora, nëna). Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e pestë** nxënësit ushtrohen të lexojnë fjalitë dhe t'i lidhin ato me figurat përkatëse.

Në **ushtrimin e gjashtë** nxënësit të pavarur shkruajnë dy fjalë, që emërtojnë kafshë (ari, lejlek). Më pas i shkruajnë me shkronja dore.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrimet në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Përsëritje për shkronjat *Ë ë L l U u K k O o J j* të dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Përsëritje për shkronjat të dorës

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë fjalën si bashkësi tingujsh (shkronjash) me një kuptim.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë – sintezë, diktim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë;
- analizojnë fjalët duke i ndarë në rrokje e shkronja;
- kthejnë fjalët nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- punojnë në grupe detyra të caktuara.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjat **Ë, L, U, K, O, J**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **Ë ë, L l, U u, K k, O o, J j**, tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake (punë në grupe)

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet të nxënësve në grupe. Klasa ndahet në 6 grupe. Për çdo grup mësuesi ka përgatitur një tabelë me një shkronjë. Brenda një afati të caktuar nxënësit ngjisin figura të ndryshme, ku tingujt : **Ë, L, U, K, O** dhe **J** ndodhen në fillim, në mes ose në fund të fjalës (emrit të figurës).

Shembull

Ë në fillim të fjalës	Ë në mes të fjalës	Ë në fund të fjalës	J në fillim të fjalës	J në mes të fjalës	J në fund të fjalës
ëndrra	nëna	enë	jaka	lejleku	mësoj
...	...	...	...	...	...

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezanton punën e grupit të vet.

Nxënësit shikojnë se cili grup ka ngjitur më shumë figura të sakta. Nxënësit korrigjojnë dhe vlerësojnë punën e njëri – tjetrit. Shpallet grupi fitues.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor


Nxënësit hapin fletoren e punës punojnë ushtrimet, pasi mësuesi i shpjegon ato.

Ushtrimi i parë: Nxënësit të pavarur plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë .


P.sh: **k**umbull **kar**ota

Ushtrimi i dytë: Analizojnë fjalët duke e ndarë në rrokje e shkronja.

Shembull



Ushtrimi i katërt: Nxënësit në çifte zbulojnë fjalët e fshehura (orë, kokë, ujku, ura).



Ushtrimi i gjashtë: Emërtojnë figurat duke shënuar në vendin e duhur : luaj, laj.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi III

Ushtrimi i shtatë: Mësuesja u dikton nxënësve rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në katër format e saj. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Y

Mësimi 17.

Shkronja Y y e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Y y** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të përdorë drejt shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike – sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë me anë të dëgjimit tingullin **Y** dhe pozicionin e tij në fjalë ;
- shkruajnë shkronjën **Y y** të shtypit sipas modelit;
- shkruajnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- lexojnë fjalë e fjali të thjeshta që kanë shkronjën **Y** në trup të tyre;
- modelojnë shkronjën **Y y** me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet e dhëna.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: shkronjë **Y y**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, ylberi, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter , projektor, tv, CD, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Y y** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Shiu dhe ylberi” . Më pas bëjnë një koment të shkurtër mbi figurën e ylberit duke u përgjigjur në pyetjen: Çfarë dini për ylberin?



Nxënësit shqiptojmë së bashku fjalën **YLBER** dhe mësues-i/ja bën kujdes që tingulli **Y** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **YLBER** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e shkronjës **Y**. Ndarja e fjalës në rrokje bëhet duke lëvizur duart majtas – djathtas nga mësues-i/ja dhe nxënësit. Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **YL-BER**.

Pra, fjala **YLBER** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **Y**? (Në fillim)

Nxënësit tregojnë fjalë tjera që kanë në trup të tyre shkronjën **Y**. Mësuesi i shkruan fjalët në tabelë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Y y** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë. Prezanton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Y y** me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Y y** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Y** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 44 dhe shqiptojnë shkronjën **Y y** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Y** është zanore.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Ylberi”** nga mësuesi. Vëzhgojnë shkronjën **Y y** në tekst dhe komentojnë tekstin. *Më pas nëse ka mundësi mësuesi mund të prezantojë në projektor me video ilustruese krijimin e ylberit.*

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Në **ushtrimi e parë** nxënësit të pavarur përshkojnë gjithë ylberin në labirint.

Në **ushtrimi e dytë** nxënësit plotësojnë fjalët me zanoren **y** dhe lexojnë ato bashkë me mësuesin.

Shembull: **SY** **NGJYRA** **pyll** **dylbi**

Ushtrimi i tretë: Në mënyrë të pavarur nxënësit rendisin zanoret e mësuara. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi V – Vazhdojnë punimin e ushtrimeve në tekst dhe fletore pune. Ushtrimi i katërt:

Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Ushtrimi i parë: Lexojnë fjalitë bashkë me mësuesin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Y y**.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Shkronja Yy e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja Yy e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike- alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Yy të dorës;
- shkruajnë shkronjën Yy të dorës sipas modelit;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore që kanë shkronjën Y në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- punojnë ylberin me letra me ngjyra në çift ose në grup.
- punojnë në grupe.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, videoprojektor, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës Yy të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – punë në grupe

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit e ndarë në grupe punojnë detyrat e caktuara. Çdo grupi fiton 2 ose 3 etiketa, që përmbajnë fjalë, të cilat në trupin e tyre kanë shkronjën Y. Një përfaqësues i grupit lexon në heshtje se çfarë shkruan në etiketën e parë dhe mundohet që, përmes gjesteve për një kohë të caktuar, t'u tregojë shokëve të grupit se për çfarë bëhet fjalë. Loja vazhdon me grupet e tjera, derisa të zbulohen të gjitha fjalët. Shpallet fitues grupi që i ka zbuluar shpejt dhe saktë të gjitha fjalët.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën Yy të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çift. Prezanton grafikun e shkronjës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës Yy të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Y y** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **Y y**.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 59 dhe shqiptojnë shkronjën *Yy* të dorës. Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë fjalinë: **Ylberi doli pas malit**. Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **Y** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Y y** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Nxënësit në çifte ose grupe punojnë ylberin me fleta me ngjyra. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit gjejnë fjalët: sy, yll, pyll dhe dy.



Në **ushtrimin e pestë** nxënësit lexojnë fjalitë së bashku me mësuesen. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të detyrave

Ushtrimi i tetë: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën *Yy* të dorës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë. Ushtrime në fletore pune.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja P

Mësimi 18.

Shkronja P p e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **P p** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **P** duke e lidhur me shkronjën **P**;
- shkruajnë shkronjën **P p** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojë rrokje;
- lexojnë fjalë e fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.
- modelojnë shkronjën **P p** me materiale të ndryshme;
- punojnë ushtrimet e dhëna.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjë **P p**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, pema, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor/tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **P p** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë figurën e pemës (projektor, tv ose tabelë) dhe bëjnë një koment të shkurtër:

Çfarë shikoni në figurë?

A keni pemë në oborrin e shtëpisë?

Pse janë të rëndësishme pemët?

Me cilin tingull fillon emri pema?



Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **PEMA** dhe mësuesi tregon kujdes, që tingulli **P** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **PEMA** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës **P**.

Nxënësit së bashku me mësuesin demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **PE-MA**.
- Fjala **PEMA** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **P**? (Në fillim)

Hapi II – loja “stop - përjashto”

Nxënësit vëzhgojnë figurat e paraqitura në projektor/tv ose në tabelë, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

PATË PUPËL ROSË KAPELË PODGORICË PLAVË BORË


Luhet loja **stop - përjashto**. Mësues-i/ja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve që në ato fjalë që dëgjojnë **P** të thonë një apo dy herë **stop**. (PATË – një herë , PUPËL – dy herë), kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **P** të thonë **përjashto** (ROSË, BORË).

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **P p** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës .



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **P p** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **P** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t’u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës P, p me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 60 dhe shqiptojnë shkronjën **P p** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **P** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë tekstin “**Piter Pan**”. Vëzhgojnë shkronjën **P p** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Punohet rubrika **Pyetje**. Vihet theksi te përdorimi i shkronjës së madhe.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato): Në **ushtrimi e parë** nxënësit të pavarur qarkojnë shkronjën **P p** në fjalët e dhëna.

Në **ushtrimin e dytë** nxënësit krijojnë rrokje me shtatë zanore dhe i shkruajnë në petale.

Shembull: PA PI PO PU PE PË PY

Në **ushtrimin e tretë** nxënësit plotësojnë fjalëkryqin me fjalët: lopa, plepi, pema. Lexohet dhe komentohet proverba.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor dhe fletoren e punës.

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë fjalitë bashkë me mësuesin.

Ushtrimi i tretë: Zhvillohet kuici. Aktivizohen sa më shumë nxënës.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **P p**. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë. Punojnë ushtrimin e parë në fletoren e punës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja *Pp* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *Pp* e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive.

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Pp* të dorës;
- shkruajnë shkronjën *Pp* të dorës sipas modelit;
- bashkojnë rrokje e krijojnë fjalë;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin ;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim dore që kanë shkronjën **P** në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurative.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, video projektor, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës *Pp* të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – lojë

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet (lojë): Çdo nxënës mban në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë.

Kontrollohet dhe vlerësohet formimi i rrokjeve apo fjalëve nga nxënësit në çifte.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën $\mathcal{P}_n$ të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **P p** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës $\mathcal{P}_n$ të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 63 dhe shqiptojnë shkronjën $\mathcal{P}_n$ të dorës. Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexon fjalinë: **Pica me proshutë**. Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **P** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **P p** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë. Në **ushtrimin e parë**, nxënësit plotësojnë rreshtat me shkronja dore.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës, pasi mësuesi shpjegon kërkesat.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**. Bashkojnë rrokjet e krijojnë fjalë. Fjalët i shkruajnë me shkronja dore.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi IV

Në **ushtrimin e gjashtë**, nxënësit shkruajnë fjalinë me shkronja dore.

Vlerësim : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën $\mathcal{P}_n$ të dorës.

Shkruajnë pesë fjalë me shkronjat e mësuara me shkronja dore . Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja B

Mësimi 19.

Shkronja B b e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **B b** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptonjë saktë (qartë) tingullin **B** duke e lidhur me shkronjën **B**;
- shkruajnë shkronjën **B b** të shtypit sipas modelit;
- modelojnë shkronjën **B b**;
- lexojnë vetëm rrokje e fjalë dhe me ndihmën e mësuesit fjali;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: shkronjë **B b**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, bleta, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, CD, figura, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës B b të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Bleta dhe lulja – Alfred Kaçinari”. Më pas nxënësit bëjnë një koment në pyetjen: Çfarë dini për bletën?



Nxënësit shqiptojmë fjalën **BLETË** dhe mësues-i/ja bën kujdes, që tingulli **B** të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit.

Hapi II

Mësuesi shkruan fjalë **BLETË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës **B**. Ndarja e fjalës në rrokje bëhet duke lëvizur duart majtas – djathtas, nga nxënësit dhe mësuesi së bashku.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **BLE-TË**.
- Pra, fjala **BLETË** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **B**? (Në fillim)


Nxënësit tregojnë fjalë tjera, që kanë në trup të tyre shkronjën **B**. Mësuesi i shkruan fjalët në tabelë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **B b** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës .



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **B b** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **B** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepe, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **B b**.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës B, b me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 64 dhe i nxit të shqiptojnë shkronjën **B b** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **B** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë tekstin **“Kërcimi i bletëve”**. Vëzhgojnë shkronjën **B b** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpijgon ato):

Në **ushtrimi e parë** nxënësit të pavarur ndihmojnë bletën të shkojë tek mjalti. Vëzhgojnë dhe lexojnë rrokjet: ba, be, bi etj.

Në **ushtrimi e dytë** nxënësit qarkojnë rrokjet: **be, mbë, bo, bu, bë** në fjalët e dhëna dhe përcaktojnë numrin e tingujve.

Në **ushtrimi e tretë** nxënësit në çifte krijojnë fjalë. Më pas i lexojnë ato.



buka → shembull

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në tekst dhe fletore pune. Ushtrimi i katërt:

Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i dytë: Lexojnë dhe ngjyrosin fjalët e shkruara saktë (BABI, BALONA, korbi, brumi).

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë fjalëkryqin: babi, barku, korbi, beli.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **B b**.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Shkronja B b e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja B b e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën B b të dorës;
- shkruajnë shkronjën B b të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim dore që kanë shkronjën B në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës B b e të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim Hapi I - lojë

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit në çifte kanë nga një fletë të bardhë në dorë, në të cilën njëri nxënës shkruan shkronjën **B** të madhe shtypi e tjetri shkronjën **b** të vogël shtypi. Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe në momentin, që mësuesja përplas duart, nxënësit formojnë çiftet e shkronjave **B b**.

Më pas zhvillohet loja e rrokjeve për të krijuar fjalë. Mësues-i/ja ka përgatitur një kub ose kuboid prej plastike me ngjyra të ndryshme, në faqet e të cilit ka shkruar rrokje, që përmbajnë shkronjën **B b**. Nxënësit me rrallë hedhin kubin dhe lexojnë rrokjen që u bie. Më pas tregojnë fjalë me rrokjet e shënuara në kub ose kuboid.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën B b të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave B b të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës B b të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 66 dhe shqiptojnë shkronjën B b të dorës. Mësues-i/ja së bashku me nxënës lexon fjalinë: **Beisa banon përballë nesh**. Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës B b me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës B b me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit krahasojnë shkronjën B b të dorës të madhe dhe të vogël te fjalët: bora dhe Borëbardha.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit në grupe tregojnë përrallën “Borëbardha dhe shtatë xhuxhat” me fjali të thjeshta. Mësuesi mund të paraqesë me video projektor foto, që tregojnë përrallën sipas ecurisë së ngjarjes ose secilit grup mund t'i japë një foto për të krijuar një pjesë të historisë. Të gjitha grupet bashkë duke ndjekur rrjedhën e ngjarjes bazuar në foto tregojnë përrallën e plotë.

Mësuesja përcjell punën e nxënësve dhe ndihmon ato grupe që kanë vështirësi në formulim të fjalive.

Reflektim

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore sipas modelit.

Ushtrimi i tetë (Diktim): Nxënësit shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën B b e të dorës.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja T

Mësimi 20.

Shkronja T t e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **T t** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të përdorë drejt shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **T** duke e lidhur me shkronjën **T**;
- identifikojnë me të dëgjuar pozicionin e tingullit **T** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **T t** të shtypit sipas modelit;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë e fjali të thjeshta;
- modelojnë shkronjën **T t**;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjë **T t**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, treni, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, cd, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës

T t të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Treni i paqes” ose “Tren o tren”. Më pas bëjnë një koment për figurën e trenit duke u përgjigjur në pyetjen: Çfarë dini për trenin?



Nxënësit shqiptojnë fjalën **TREN** dhe mësuesja bën kujdes që tingulli **T** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Mësuesja shkruan fjalën **TREN** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen

e shkronjës (tingullit) **T**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **TREN**.
- Sikur e pamë fjala **TREN** ka 1 rrokje. Ku ndodhet shkronja **T**? (Në fillim)

Nxënësit emërtojnë figurat e paraqitura në projektor, tv ose tabelë dhe tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **T**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **T t** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.




Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **T t** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **T** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës në tabelë shkruajnë shkronjën *T, t*.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **T t** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 67 dhe shqiptojnë shkronjën **T t** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **T** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesen lexojnë tekstin **“Treni i shkronjave”**. Vëzhgojnë shkronjën **T t** në tekst dhe komentojnë tekstin. Vëzhgojnë dhe lexojnë rrokjet : ta, te, ti etj.



Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur lexojnë fjalët dhe qarkojnë rrokjet: **to, AT, ta, të, TI, ti**.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit zbulojnë katër fjalët e fshehura: **TETË, TORTA, TUNEL, TIMON**.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune. Ushtrimi i katërt:

Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i dytë: Plotësojnë fjalinë me shkronjat që mungojnë. Dallojnë shenjën e pikësimit të përdorur në fund të fjalisë.

TOMI KA TEMPERATURË.

Ushtrimi i katërt: Lexojnë tekstin zinxhir së bashku me mësues-en/in dhe komentojnë atë.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **T t**.

Punojnë ushtrimie në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja T t e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja T t e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të dallojë kuptimin e fjalëve të shkruara dhe të fjalive të formuara me figura.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën T t të dorës;
- shkruajnë shkronjën T t të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje, fjalë dhe fjali;
- lexojnë fjalë e fjali të thjeshta me shkrim dore që kanë shkronjën T në trup të tyre;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave.

Metodat dhe teknikat: lojë - enigmë , bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet: luan, bisedon, vëzhgon - analizon, shkruan, lexon, krijon etj.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukim fizik.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës T t të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake (lojë enigmë – vizatim) Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Lojë enigmë – vizatim

Në një kuti janë vendosur një top dhe një tablet. Pas udhëzimit, nxënësit fusin dorën në kuti dhe me anë të prekjes dallojnë se çfarë është brenda. Nxënësit i vizatojnë sendet. Mësuesja mund t'u drejtojë këto pyetje: Për çfarë i përdorim? A mund të mësojmë nga ato? A mund të luajmë me to? A përdorni shpesh ju mjete teknologjike si tablet, kompjuter apo telefon? Çfarë ju thonë prindërit ? etj.

Mësues-i/ja i këshillon nxënësit për kohën që duhet të kalojnë me mjete elektronike, si dhe anët pozitive dhe negative të përdorimit të tyre.

Aktivitet tjetër: zhvillohet në klasë një lojë me nxënës. Nxënësit qëndrojnë në formë rrethi dhe i hedhin topin njëri-tjetrit. Ai që kap topin duhet të thotë një fjalë që përmban shkronjën T.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën *T t* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës *T t* të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **T t** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë shkronjën.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 69 dhe shqiptojnë shkronjën *T t* të dorës. Nxënësit lexojnë dhe plotësojnë fjalitë : **Teuta luan me tablet. Teuta luan me kompjuter.** Poashtu vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **T t** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **T t** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Ushtrimi i dytë: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjën e dorës.

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë dy numra që kanë në përbërjen e tyre shkronjën **t** (tren, tetë). I shkruajnë me shkronja shtypi dhe dore.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Zhvillohet kuici me nxënës në grupe.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit shkruajnë me shkronja dore fjalinë (Toni banon në Traboin). Më pas krijojnë një fjalë duke parë figurën.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën *T t* të dorës dhe pesë fjalë.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja D

Mësimi 21.

Shkronja D d e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **D d** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë shkronjat, fjalët e fjalitë e veçanta;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë me të dëgjuar pozicionin e tingullit D në fjalë;
- shkruajnë shkronjën D d të shtypit sipas modelit;
- modelojnë me materiale të ndryshme shkronjën D d;
- shkruajnë fjalë e fjali;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë e fjali të thjeshta;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjë **D d**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, deti, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, cd, figura, tabelë, shkumës, grafi-ku i shkronjës **D d** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.


Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Mësimi fillon me njërin nga këto aktivitete:

1. Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën "Mos e merr detin inat". Më pas e komentojnë këngën duke u ndihmuar me pyetjet: A ju pëlqeu kënga? A shkoni ju në det? Kur shkoni? Pse? Kush jeton në det? etj.
2. Në projektor ose tv paraqiten pamje, që tregojnë botën ujore e nënujore. Pasi i prezanton ato, mësuesi u thotë nxënësve të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë sikur janë në një udhëtim nënujor, të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. Në kompjuter mund të vendosë një muzikë, që simbolizon tingujt në botën nënujore. Nga përshkrimi që bëjnë


nxënësit mësuesi shkëput fjalët, që kanë në trup shkronjën **D**.



Hapi II

Nxënësit shqiptojnë fjalën **DET** dhe mësuesi bën kujdes që tingulli **D** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Shkruan fjalën **DET** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **D**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstronë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **DET**.
- Po fjala **DETI** sa rrokje ka? Ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **D**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë tingullin **D** në trup të tyre.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimin dhe prezanton shkronjën **D d** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **D d** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **D** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës **D d** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 70 dhe shqiptojnë shkronjën **D d** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **D** është bashkëtingëllore. Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë tekstin "**Dallëndyshja e parë**". Vëzhgojnë shkronjën **D d** në tekst dhe komentojnë tekstin. Më pas vëzhgojnë dhe lexojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur lexojnë fjalët dhe qarkojnë rrokjet: **del, DRI, dë, dar, dër, DA**. Më pas ndajnë fjalët në rrokje dhe rrethojnë sa rrokje ka fjala.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit ndihmojnë devenë të gjejë oazin.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Reflektim

Hapi V – Punë në fletore pune

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i parë: Bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalë sipas figurave.

Shembull: dreri, radio, oktapod, ditar, lodrat, dritare

Ushtrimi i tretë: Shkruajnë fjalët që rimojnë ***bora-dora, dera-era, rosë-dosë***.

Ushtrimi i pestë: Lidhin dhe plotësojnë fjalitë. Lexojnë fjalitë e krijuara.

Shembull: *Diana doli prej detit. Dalina do të bëhet piktore. Pa filmin me rosakun Donald.*

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **D d** dhe pesë fjalë që në trup të tyre kanë shkronjën **D**.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja D d e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja D d e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën **D d** të dorës ;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim dore, që kanë shkronjën **D** në trup të tyre;
- shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkronja shtypi, shkronja dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, TV, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **D d** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Dy nxënës vendosin në tabelë grafikun e shkronjës **D d** dhe nxënësit e tjerë i lexojnë ato:

D e madhe e shtypit **d** e vogël e shtypit.

Nxënësve në çifte ose grupe u jepen etiketa me rrokje dhe fjalë të ngatërruara. Nxënësit duhet t'i rendisin ato për të formuar fjalë dhe fjali me kuptim.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **D d** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **D d** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë shkronjën në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv, grafikun e shkronjës **D d** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 72 dhe shqiptojnë shkronjën D d të dorës. Nxënësit lexojnë së bashku me mësues-in/en fjalitë : ***Dacaj ka tani një shkollë të re.*** ***Dritaret depërtojnë dritën e diellit.*** Poashtu vëzhgojnë lidhjen e shkronjës D d me shkronjat e tjera. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës D d me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Ndjekin gjurmët dhe shkruajnë shkronjën e dorës. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit shkruajnë me shkronja dore fjalët e krijuara tek ushtrimi 1.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë, duke parë modelin.

Në **ushtrimin e tetë**, nxënësit shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie.

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën D d të dorës dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja F

Mësimi 22.

Shkronja F f e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **F f** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë shkronjat, fjalët e fjalitë e veçanta;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë me të dëgjuar pozicionin e tingullit **F** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **F f** të shtypit sipas modelit;
- modelojnë me materiale të ndryshme shkronjën **F f**;
- modelojnë me fjalë kryqe për të krijuar fjalë të reja;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë e fjali;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjë **F f**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, flutura, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, CD, figura, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **F f** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake


Ora fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Flutur ty të dua shumë”. Më pas nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën e fluturës në tv apo tabelë dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: A ju pëlqejnë ju fluturat? Ku i shihni ato? Me cilin tingull fillon emri flutur? etj. Nxënësit shqiptojnë fjalën **FLUTUR** dhe mësuesi bën kujdes, që tingulli **F** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **FLUTURA** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës

(tingullit) **F**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë: **FLU-TU-RA**.
- Sikur e pamë fjala **FLUTURA** ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **F**? (Në fillim)



Nxënësit emërtojnë figurat e paraqitura në projektor ose tv dhe tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **F**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **F f** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **F f** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **F** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepe, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **F f** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin Tekstin mësimor në faqen 73 dhe shqiptojnë shkronjën **F f** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **F** është bashkëtingëllore. Nxënësit lexojnë së bashku me mësues-in/en tekstin "**Fluturat**". Vëzhgojnë shkronjën **F f** në tekst dhe komentojnë tekstin. Më pas nxënësit lexojnë rrokjet: fa, fe, fi etj.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Në **ushtrimi e parë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet: fa, fo, fë, fu, fi në fjalët e dhëna. Lexojnë fjalët.

Në **ushtrimi e dytë**: Vështrojnë dhe lexojnë rrokjet: flu, fla, flo, fru, fle. Lexojnë fjalët.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në tekstin mësimor dhe fletoren e punës.

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i tretë: Zgjidhin fjalëkryqin (delfin, fole, raft, karafil)

Ushtrimi i katërt: Nxënësit në grupe tregojnë historinë sipas figurave dhe më pas shënojnë

nga një fjalë për secilën figurë (festë, ditëlindje, tortë, familje).

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **F f** dhe pesë fjalë, që në trup të tyre kanë shkronjën **F**. Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Ff e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Ff e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Ff të dorës ;
- shkruajnë shkronjën e madhe dhe të vogël të dorës;
- lexojnë fjalë dhe fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore, që kanë shkronjën **F** në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti i nxënësit, fletore pune, figura, tv, projektor, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **F f** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: nxënësit në çifte kanë në dorë fletë të bardha, në të cilat njëri nxënës shkruan shkronjën **F** të madhe shtypi e tjetri shkronjën **f** të vogël shtypi. Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe në momentin që mësuesja përplas duart, nxënësit formojnë çiftet e shkronjave **F f**. Nxënësit mund të prezantojnë vetveten: Unë jam **F** e madhe e shtypit. – Unë jam **f** e vogël e shtypit.

Më pas zhvillohet loja e rrokjeve për të krijuar fjalë. Nxënësit me radhë hedhin kubin/kuboidin dhe lexojnë rrokjen që u bie. Më pas tregojnë fjalë me rrokjet e shënuara në kub ose kuboid.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën *Ff* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **F f** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **F f**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës *Ff* të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 75 dhe shqiptojnë shkronjën *Ff* të dorës. Nxënësit lexojnë fjalinë: **Fatjona feston** dhe vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **F** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **F f** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë. **Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst** (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat): Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit shkruajnë me shkronja dore rrokjet.

Në **ushtrimin e gjashtë**, nxënësit zbulojnë fjalinë e fshehur **Tri fluturat fluturuan** dhe e shkruajnë me shkronja dore.

Mësuesja përcjell punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Reflektim Hapi IV

Ushtrimi i shtatë (Diktim): Nxënësit shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën *Ff* të dorës dhe 2 fjali.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Përsëritje për shkronjat Y y, P p, B b, T t, D d, F f

Mësimi 23.

Përsëritje për shkronjat Y y, P p, B b, T t, D d, F f të shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat Y y, P p, B b, T t, D d, F f të shtypit

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim diskutim, vëzhgo - analizo etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt Y, P, B, T, D, F;
- dallojnë shkronjat e mësuara Y, P, B, T, D, F dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- formojnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë fjalë me shkronja shtypi e dore;
- lexojnë dhe analizojnë fjalët duke i ndarë në rrokje;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjat Y, P, B, T, D, F, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, shëno, vendos, lexo, shkruaj. etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, grafiku i shkronjave Y, P, B, T, D, F, tabela plastike, figura, fletë formati, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Zhvillohet një "Stuhi mendimesh" me shkronjat e grupit të tretë. Ngrihen nxënës të ndryshëm për t'i shkruar në tabelë shkronjat e shtypit dhe të dorës, të vogla e të mëdha. Nxënësit në grupe formojnë rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Gr.1 → formojnë rrokje Gr.2 → formojnë fjalë Gr.3 → formojnë fjali.

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezenton punën e grupit të vet.

rigjojnë dhe vlerësojnë punë e njëri - tjetrit. Nëse është e nevojshme kyçet edhe mësuesi.

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur identifikojnë shkronjat e mësuara në grupin e shkronjave të dhëna dhe i ngjyrosin ato.

Shembull: dylbi fruta

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur vendosin zanoren që duhet **u** dhe **y** (kumbull, yll, kupë etj.)

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit lexojnë dhe ngjyrosin fjalën e shkruar saktë.

Shembull: TABLET, PIKTURË


Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit në çifte ndajnë fjalët në rrokje e shkronja. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë fjalët me rrokjen që duhet (petale, ylberi, fëmijë etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit zbulojnë fjalët e fshehura (PINOKU, BLETA, DORA, FOKA).



Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin

Përsëritje për shkronjat Yy Pp Bb Tt Dd Ff të dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat Yy Pp Bb Tt Dd Ff të dorës

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të dallojë kuptimin e fjalëve të shkruara dhe të fjalive të formuara me figura.

Metodat dhe teknikat: bisedë, shkrimi i lirë, diktim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shkruajnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- krijojnë fjali sipas figurave;
- kthejnë fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurative.

Fjalë kyçe: shkronjat **Y y, P p, B b, T t, D d, F f** shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **Y y, P p, B b, T t, D d, F f**, tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet të nxënësve në grupe. Nxënësit janë ndarë në 6 grupe. Çdo grup fiton foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjat: **Y, P, B, T, D, F**. Çdo grup një shkronjë. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë autodiktimi, në një fletë ose tabak letre me shkronja shtypi dhe dore.

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezanton punën e grupit të vet. Grupet korrigjojnë njëri – tjetrin. Mësuesi lavdëron dhe vlerëson nxënësit për punën e bërë në grupe.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 77 dhe punojnë ushtrimet e dhëna, pasi mësuesi jep udhëzimet e nevojshme.

Ushtrimi i gjashtë: Nxënësit të pavarur shkruajnë me shkronja dore fjalët e dhëna.

Ushtrimi i shtatë: Krijojnë fjali sipas figurave. Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës. **Ushtrimi i katërt:** Shkruajnë me shkronja dore fjalinë.

Reflektim

Hapi III

Ushtrimi i pestë (Diktim): Mësues-i/ja u dikton nxënësve shkronja, rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në katër format e saj. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja V

Mësimi 24.

Shkronja V v e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **V v** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë fjalët në të cilat shkronjat e mësuara ndodhen në fillim, në mes apo në fund të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, marrëdhënie pyetje - përgjigje, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **V** dhe identifikojnë me të dëgjuar pozicionin e tij në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **V v** të shtypit sipas modelit;
- modelojnë me materiale të ndryshme shkronjën **V v**;
- bashkojnë rrokje e krijojnë fjalë me kuptim;
- lexojnë rrjedhshëm fjalët e formuara.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: shkronjë **V v**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, treni, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, tv, projektor, CD, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **V v** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit shikojnë foton e violinës në tv ose tabelë dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shihni në tabelë? Çfarë dini për violinën? Kush di të luajë në violinë? Nëse po, ku e keni mësuar? Me cilin tingull fillon emri violina?




Nxënësit shqiptojnë fjalën **VIOLINË** dhe mësuesi bën kujdes që tingulli **V** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **VIOLINË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **V**. Udhëzon nxënësit që ndarjen e fjalës në rrokje ta bëjmë duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **VI-O-LI-NË**.
- Sikur e pamë fjala **VIOLIONË** ka 4 rrokje. Ku ndodhet shkronja **V**? (Në fillim)




Nxënësit emërtojnë figurat në projektor /tv ose tabelë dhe tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **V**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **V v** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **V v** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **V** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **V v** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 60 dhe shqiptojnë shkronjën **V v** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **V** është bashkëtingëllore. Nxënësit së bashku me mësuesen lexojnë tekstin. Vëzhgojnë shkronjën **V v** në tekst dhe komentojnë tekstin.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimi e parë**, nxënësit të pavarur përgjigjen në pyetjet rreth tekstit duke ngjyrosur rrethin pranë përgjigjes së saktë. Më pas vështrojnë bashkimin e rrokjeve të paraqitura në re.

Në **ushtrimi e dytë**, nxënësit qarkojnë rrokjet në fjalët e dhëna.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë me shigjetë rrokjet dhe krijojnë fjalët: krevat, kova, verë, vijë, valë).

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit duke u bazuar në figura krijojnë grupet e fjalëve sipas modelit.

Shembull: *kova me rërë varka me vela ora e avionit(aeroplanit) violina e Vitorit*

Ushtrimi i tretë: Përshkruajnë me gojë vendlindjen e tyre. Shkruajnë një fjali për vendlindjen.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpi

Shkruajnë 2 rresht me shkronjën **V v** dhe pesë fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja **e dorës**

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja  e dorës

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë-enigmë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën  të dorës;
- shkruajnë shkronjën  të dorës sipas modelit;
- lexojnë rrjedhshëm fjali të thjeshta me shkrim dore, që kanë shkronjën **V** në trup të tyre;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë sipas diktimit të mësime nxënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukim fizik.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, tv, projektor, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës  të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, kuti, vezë etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimimit fillon me këtë aktivitet: Lojë enigmë - vizatim

Në një kuti është një vezë. Nxënësit fusin dorën në kuti dhe me anë të prekjes dallojnë se çfarë është brenda. Nxënësit e vizatojnë sendin. Mësuesja mund t'u drejtojë këto pyetje: Çfarë është brenda në kuti? A ju pëlqejnë vezët? Për çfarë i përdorim? Me cilin tingull fillon fjala vezë? etj.

Aktiviteti tjetër: zhvillohet në klasë një lojë me nxënës. Qëndrojnë nxënësit në formë rrethi dhe i hedhin topin njëri – tjetrit. Ai që kap topin duhet të thotë një fjalë, që përmban shkronjën **V** në trup të saj. Nëse nuk e din, del nga loja.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimimit dhe prezanton shkronjën  të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës  të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **V v** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **V v**.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 81 dhe shqiptojnë shkronjën  të dorës. Nxënësit së bashku me mësues-in lexojnë dhe plotësojnë tekstin me fjalët që mungojnë (vrapi, Valët, së vogël, e madhe). Dallojnë kuptimin e kundërt të fjalëve: e vogël – e madhe. Më pas lexojnë fjalinë **Valmira luan me valët e detit** dhe vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **V v** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **V v** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet në tekst dhe fletore pune (pasi mësuesi jep sqarimet e nevojshme): Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjën e dorës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e tretë**: Shkruajnë dy stinët e vitit: vera, pranvera. Tregojnë cilat janë stinët e tjera.

Ushtrimi i katërt (fletore pune): Shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë.

Reflektim

Hapi IV

Në **ushtrimin e gjashtë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën  të dorës dhe 2 fjali.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja C

Mësimi 25.

Shkronja C c e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **C c** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike-sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **C** duke e lidhur me shkronjën **C**;
- shkruajnë shkronjën **C c** të shtypit sipas modelit;
- qarkojnë rrokjet e përcaktuara në fjalët e dhëna dhe plotësojnë fjalët me rrokjet që duhet;
- manipulojnë me fjalëkryqe për të krijuar fjalë të reja;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë e fjali;
- lexojnë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: shkronjë **C c**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, celulari, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, tv, projektor, cd, radio, figura, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **C c** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi II – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehje këngën për fëmijë "Mësuesja dhe celulari". Më pas e komentojnë atë duke u përgjigjur me përgjigje të plota në pyetjet:

A keni celular? Për çfarë e përdorni? Cilat janë të mirat dhe të këqijat që kemi nga celulari? Me cilin tingull fillon emri celulari? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalën **CELULAR** dhe mësuesi bën kujdes, që tingulli **C** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **CELULAR** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e

shkronjës (tingullit)

C. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **CE-LU-LAR**.
- Sikur e pamë fjala **CELULAR** ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **C**? (Në fillim). Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë tingullin C në trup të tyre.



Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **C c** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **C c** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **C** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës e shkruajnë në tabelë grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës **C c** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 83 dhe shqiptojnë shkronjën **C c** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **C** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesen lexojnë tekstin **“Vizita në lumin Cem”**. Vëzhgojnë shkronjën **C c** në tekst dhe komentojnë tekstin. Më pas përgjigjen në pyetjet rreth tekstit të ushtrimit i parë. Poashtu vështrojnë rrokjet e formuara me shkronjën **c** te retë.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet që përmbajnë shkronjën c.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur lidhin fjalën me figurën.

P.sh: gjeli → ki-ki-ki macja → mjau-mjau → zogu ciu-ciu

Gjatë punës mësuesi u jep sugjerimet përkatëse për çdo ushtrim. Në fund i vlerëson ata.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit të pavarur bashkojnë pikat dhe krijojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit plotësojnë fjalët me rrokjet, që mungojnë.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **C c** dhe pëse fjalë, që në trup të tyre kanë shkronjën **C**.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja   e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: copëza të përziera, bisedë, analizë – sintezë, metoda fonetike – alfabetike, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën   të dorës;
- shkruajnë shkronjën   të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë me të diktuar rrokje e fjalë;
- formojnë dhe lexojnë fjali me shkronjat e mësuara.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkronja shtypi, shkronja dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafi-ku i shkronjës   të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Punë në çifte/grupe

Një nxënës vendos në tabelë shkronjë   dhe nxënësit e tjerë lexojnë:

 e madhe shtypi  e vogël shtypi

Nxënësve në çifte ose grupe u ndan etiketa me rrokje dhe fjalë të ngatërruara. I udhëzon t'i renditin ato për të formuar fjalë dhe fjali me kuptim.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën   të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e

shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **C c** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë, që ta shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës **C c** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 85 dhe shqiptojnë shkronjën  **c** të dorës. Lexojnë së bashku me mësuesen fjalitë me shkronja dore. Nxënësit vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **c** me shkronjat e tjera, tek fjalët: cirkut, tullumbace, cjapin.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **C c** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Ushtrimi i dytë: Plotësojnë rreshtat me shkronjën e dorës.

Ushtrimi i tretë: Punojnë në grupe prej letre një cirk.

Reflektim

Hapi I - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë, duke parë modelin.

Ushtrimi i pestë (Diktim): Shkruajnë me të diktuar rrokje dhe fjalë.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **C c** dhe 5 fjalë, që në trup të tyre kanë shkronjën **C**.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Ç

Mësimi 26.

Shkronja Ç ç e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Ç ç e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, DLTA etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin Ç duke e lidhur me shkronjën Ç;
- shkruajnë shkronjën Ç ç të shtypit sipas modelit;
- krijojnë grupe fjalësh mbi bazën e figura duke parë modelin;
- formojnë fjali mbi bazën e figurave, që përmbajnë shkronjën Ç;
- lexojnë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë Ç ç, tingull, rrokje, fjalë, fjali, çerdhe, përrallë, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, cd, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës Ç ç të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake


Nxënësit vëzhgojnë me kujdes foto të ndryshme të çerdheve (projektor, tv ose tabelë) dhe bëjnë një koment të shkurtër duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? A keni parë ndonjëherë çerdhe? Ku i ndërtojnë zogjtë çerdhet? Pse i ndërtojnë? Me cilin tingull fillon emri çerdhe? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalën ÇERDHE dhe mësuesja bën kujdes që tingulli Ç të shqiptohet sa më saktë nga nxënësit. Shkruan fjalë ÇERDHE në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) Ç.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart

majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **ÇE-RDHE** .
- Fjala **ÇERDHE** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **Ç**? (Në fillim)



Mund të zhvillohet edhe ky aktivitet: punë në çifte. Njëri nxënës thotë një rrokje, që përmban shkronjën **Ç** , tjetri gjen dhe thotë një fjalë që e përmban atë rrokje.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Ç ç** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës . **Ç ç**

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Ç ç** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Ç** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepe, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **Ç ç**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Ç ç** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 87 dhe shqiptojnë shkronjën **Ç ç** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Ç** është bashkëtingëllore.


Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë tekstin **“Çerdhja”**. Vëzhgojnë shkronjën **ç** në tekst dhe komentojnë tekstin. Mësuesi shpjegon fjalët më të vështira për t'u kuptuar nga nxënësit.

Punohet **ushtrimi i parë** - pyetje rreth tekstit. Gjithashtu nxënësit bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokjet.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat i shpjegon ato):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet në fjalët e dhëna.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte gjejnë fjalët: BIÇIKLETË, ÇANTË, ÇAJ, ÇATI.



Dallojnë në mënyrë intuitive fjalët me kuptim të njëjtë: çoban – bari.

Gjatë punës mësuesi mund t'u japë nxënësve sugjerime përkatëse për çdo ushtrim.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Ushtrimi i dytë (fletore pune): Krijojnë grupet e fjalëve mbi bazën e figurave me ndihmën e mësuesit.

Shembull: *çokollatë me arra reçel boronice biçikletë e kuqe telat e çiftelisë*

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Ç ç** dhe 5 fjalë.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Ç ç e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Ç ç e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë – sintezë, metoda fonetike – alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojë shkronjën Ç ç të dorës;
- shkruajnë shkronjën Ç ç të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore, vjershë etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës Ç ç të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I - Aktivitet 1 dhe 2

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit në çifte kanë në dorë fletë format, ku do të shkruajnë njëri shkronjën Ç të madhe shtypi e tjetri shkronjën ç të vogël shtypi. Ata lëvizin nëpër klasë dhe në momentin, që mësuesja përplas duart, nxënësit formojnë çiftet e shkronjave Ç ç.

Më pas zhvillon lojën e rrokjeve për të krijuar fjalë. Mësues-i/ja ka përgatitur një kub ose kuboid prej plastike me ngjyra të ndryshme, në faqet e të cilit ka shkruar rrokje, që përbajnë shkronjën Ç ç. Nxënësit me radhë hedhin kubin dhe lexojnë rrokjen që u bie. Më pas tregojnë fjalë me rrokjet e shënuara në kub ose kuboid.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën Ç ç të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave Ç ç të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre

plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës Ç ç të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 89 dhe shqiptojnë shkronjën Ç ç të dorës. Më pas së bashku me mësuesin lexojnë fjalinë **Çimi ha çdo ditë çokollatë**. Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës Ç ç me shkronjat e tjera dhe komentojnë fjalinë.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës Ç ç të dorës me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë. Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit krijojnë një fjali me njërin prej grupeve të formuara në ushtrimin e dytë.

Shembull: Babai ka biçikletë të kuqe.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e katërt**, plotësojnë fjalitë me fjalët: çatitë, foleja, çelin. Ushtrimi plotësohet me ndihmën e mësues-it/es.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit ngjyrosin me të verdhë fjalët që tregojnë objekte (çokollata, maçok, çati, çorape, çanta), kurse me ngjyrë blu fjalët, që tregojnë veprime (çel, çaloj).

Në **ushtrimin e gjashtë**, nxënësit plotësojnë rreshtat me rrokje.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën Ç ç dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrimet në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja G

Mësimi 27.

Shkronja G g e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **G g** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **G** duke e lidhur me shkronjën **G**;
- shkruajnë shkronjën **G g** të shtypit sipas modelit;
- qarkojnë dhe plotësojnë rrokjet në fjalët e dhëna;
- bashkojnë rrokjet, krijojnë fjalë dhe analizojnë fjalë;
- lexojnë fjalë e fjali, që kanë shkronjën **G** në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- lexojnë rrokje, fjalë, fjali të thjeshta.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurative.

Fjalë kyçe: shkronjë **G g**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, gështenja, qarko, formo, shkruaj, lexo, lidh etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **G g** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim Hapi I



Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre dhe mësuesja plotëson skemën në tabelë. Më pas nxënësit vëzhgojnë foton e gështenjës dhe bëjnë një koment të shkurtër për të duke u ndihmuar me pyetje: A iu pëlqejnë ju gështenjat? Cili vend në Mal të Zi është i njohur për gështenja? A keni qenë ndonjëherë në Festën e gështenjave në Krajë? Me cilin tingull fillon emri gështenja? etj.

Hapi II

Nxënësit shqiptojnë fjalën **GËSHTENJË** dhe mësuesja tregon kujdes që tingulli **G** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **GËSHTENJË** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e shkronjës (tingullit) **G**.

Demonstrohet ndarja e fjalës në rrokje nga nxënësit dhe mësuesja duke lëvizur duart majtas

– djathtas.

– Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **GË-SHTE-NJË**

– Fjala **GËSHTENJË** ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **G**? (Në fillim)

Në projektor, tv ose tabelë janë të paraqitura disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

LOB GËRSHËRË QERSHI GOZHDË SHEGË ZOG KUNGULL

Luhet loja **stop - përjashto**. Mësuesja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjojnë **G** të thonë **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **G** të thonë **përjashto**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **G g** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **G g** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **G** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës në tabelë shkruajnë shkronjën **G g**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t’u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **G g** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 90 dhe shqiptojnë shkronjën **G g** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **G** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë tekstin **“Gështenjat e Krajës”**. Vëzhgojnë shkronjën **G g** në tekst dhe komentojnë tekstin. Punohet **ushtrimi i parë**, rubrika **Pyetje rreth tekstit**. Nxënësit bashkojnë shkronjat dhe formojnë rrokjet.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që në trup kanë shkronjë **g**.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit lidhin fjalën me figurën.

Shembull: ka-ka-ka → pula

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit.

Ushtrimi i dytë: Bashkojnë me shigjetë rrokjet dhe krijojnë fjalët.

Shembull: goma, garë, lugë, gotë, guri, degë

Ushtrimi i katërt: Plotësojnë fjalitë e tekstit me ndihmën e mësuesit me fjalët e dhëna.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **G g** dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja *Gg* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *Gg* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën **G g** të dorës;
- shkruajnë shkronjën **G g** të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- lexojnë rrokje, fjalë e fjali të thjeshta;
- punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukim fizik, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore, gjëegjëzë, proverbë etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, tv, projektor, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës të dorës **G g**, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, kuti, vezë etj.

Evokim Hapi I

Mësimi fillon me këtë aktivitet: lojë me nxënës. Qëndrojnë nxënësit në formë rrethi dhe i hedhin topin njëri – tjetrit. Ai që kap topin duhet të thotë një fjalë, që përmban shkronjën **G** në trup të saj. Nëse nuk e din, del nga loja.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **G g** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor, tv grafikun e shkronjës **G g** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **G g** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë shkronjën **G g**.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 92 dhe shqiptojnë shkronjën **G g** të dorës. Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë proverbën dhe e komentojnë atë të ushtrimit i parë. Krahasojnë dy format e shkrimit të proverbit.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **G g** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë. Lexohet dhe komentohet gjëegjëza (gërshërët).

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna (pasi mësuesja lexon dhe shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Plotësojnë rreshtat me shkronjat e dorës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e tretë**: Bashkojnë pikat dhe formojnë kafshën (gorilla). Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë duke parë modelin. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV

Në **ushtrimin e tetë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **G g** të dorës dhe 2 fjali.

Punojnë ushtrimet në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Q

Mësimi 28.

Shkronja Q q e shtypit

Njësia e mësimi : Shkronja **Q q** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara.

Metodat dhe teknikat: lojë, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Q** duke e lidhur me shkronjën **Q**;
- shkruajnë shkronjën **Q q** të shtypit sipas modelit;
- qarkojnë rrokjet që kanë në trup shkronjën **Q**;
- plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara ;
- punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë **Q q**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, qukapiku, vjershë, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, cd, magnetofon, kompjuter, tv, projektor, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Q q** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake


Nxënësit dëgjojnë, këndojnë, komentojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Qukapiku-Ueda Gruda”.

Hapi II

Nxënësit shqiptojë fjalën **QUKAPIKU** dhe mësuesi tregon kujdes, që tingulli **Q** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **QUKAPIKU** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e shkronjës (tingullit) **Q**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas - djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **QU-KA-PI-KU**.
- Fjala **QUKAPIKU** ka 4 rrokje. Ku ndodhet shkronja **Q**? (Në fillim)



Në projektor, tv ose tabelë paraqiten disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

QENI

ROBOTI

QYTETI

QËNDIS

PUPËL

QAFA

Luhet loja **stop - përjashto**. Mësues-i/ja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjoni **Q**


thoni **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjoni **Q** thoni **përjashto**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Q q** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Q q** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Q** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës në tabelë shkruajnë shkronjën **Q q**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **Q q***

me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 94 dhe shqiptojnë shkronjën **Q q** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Q** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Qukapiku”**. Punojnë ushtrimin e parë – pyetje rreth tekstit.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat i shpjegon ato): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokjet (qa, qo, qe, qu etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte qarkojnë në fjalë rrokjet, që kanë në trup shkronjën **q**.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore pune Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte vendosin zanoret që duhet **q** ose **ç**.

Shembull: çelës qafë çorape qershi

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit plotësojnë fjalitë e dhëna në tekst me ndihmën e më-

sueses, me fjalët: *pemën, qukapiku, qukin, pyje*.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën Q q dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrimin e parë në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Q q dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Q q e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë – sintezë, metoda fonetike – alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Q q të dorës;
- shkruajnë shkronjën Q q të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, TV, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës Q q të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet (lojë): Çdo nxënës mban në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë.

Shembull: QE, QY, PA, QE, NI, TET QEPA QYTET QENI

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën Q q të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës Q q të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave Q q të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 96 dhe shqiptojnë shkronjën Q q të dorës, që ndodhet në krye të faqes. Më pas nxënësit lexojnë fjalinë **Qukapiku quk me sqep pemën**. Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës Q q me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës Q q me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur plotësojnë rreshtat me shkronja dore.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit krijojnë një qukapik.

Reflektim

Hapi IV – Punim i ushtrimeve në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**. Shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë.

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë e fjali.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën Q q të dorës. Shkruajnë tri fjali me shkronja dore. Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Shkronja Gj

Mësimi 29.

Shkronja Gj gj e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Gj gj** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike – alfabetike, metoda analitike – sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Gj** dhe identifikojnë me të dëgjuar pozicionin e tingullit **Gj** në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **Gj gj** të shtypit sipas modelit;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë e fjali të thjeshta.
- lexojnë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronja **Gj gj**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, gjethe, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës

Gj gj të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I - Lojë enigmë – vizatim

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Lojë enigmë – vizatim.

Në një kuti mësuesja ka vendosur një gjethe. Nxënësit fusin dorën në kuti dhe me anë të prekjes dallojnë se çfarë është brenda. Nxënësit vizatojnë sendin. Mësuesja mund t'u drejtojë këto pyetje: Çfarë është brenda në kuti? Çfarë ngjyre mund të jetë? A i japin bukuri pemës? Pse janë të rëndësishme gjethet? Me cilin tingull fillon emri gjethe? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalë **gj**ethe dhe mësuesja bën kujdes, që tingulli **gj** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Hapi II

Shkruan fjalën **gjethe** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **gj**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje

duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **gje**-the.
- Sikur e pamë fjala **gjethe** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **gj**? (Në fillim)


Nxënësit emërtojnë fotografitë e paraqitura projektor/tv ose tabelë dhe tregojnë pozicionin në të cilin ndodhet tingulli **gj**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Gj gj** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar hap pas hapi në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Gj gj** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Gj gj** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Gj gj** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 97 dhe shqiptojnë shkronjën **Gj gj** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Gj** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë tekstin "**Gjethet e vjeshtës**". Vëzhgojnë shkronjën **Gj gj** në tekst dhe komentojnë tekstin. Punohet **ushtrimi i parë** rubrika **Pyetje**.


Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokjet. Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **gj**.

Lexohet dhe komentohet gjëegjëza për shkronjat.

Reflektim

Hapi V – Vazhdohet punimi i ushtrimeve në tekst dhe fletore pune.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit të pavarur bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.



Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte gjejnë fjalët: argjend, gjuri, gjirafa, qingji.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit të ndihmuar nga mësues-i/ja plotësojnë fjalitë me fjalët që mungojnë.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Gj gj**.

Punojnë ushtrimet në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Gj gj e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja Gj gj e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë – sintezë, metoda fonetike – alfabetike, lexim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë dhe identifikojnë shkronjën Gj gj të dorës;
- shkruajnë shkronjën Gj gj të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukim fizik, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti i nxënësit, fletore pune, figura, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafi-ku i shkronjës Gj gj të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, kuti, vezë etj.

Evokim

Hapi I – Punë në grupe

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet të nxënësve në grupe. Klasa ndahet në 4 grupe. Nxënësve në grupe u jepet nga një tabelë me shkronjën **Gj**. Brenda një afati të caktuar nxënësit ngjisin figura të ndryshme ose shkruajnë fjalë, ku tingulli (shkronja) **Gj** ndodhen në fillim, në mes ose në fund të fjalës (emrit të figurës).

Shembull

Gj/gj në fillim të fjalë	gj në mes të fjalës	gj në fund të fjalës
Gjoni	sfun g jer	qin g j
...	...	...

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezenton punën e grupit të vet.

Mësues-i/ja bën kujdes të shikojë se cili grup ka ngjitur më shumë figura ose ka shkruar më shumë fjalë të sakta. Ai/ajo lavdëron, korrigjon dhe vlerëson nxënësit për punën e bërë në grupe.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Gj gj** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Gj gj** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Gj gj** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 99 dhe shqiptojnë shkronjën Gj gj të dorës. Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë fjalinë **Unë e mësoj mirë gjuhën shqipe**. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Gj gj** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Plotësojnë rreshtat me shkronjat e dorës. Nxënësit në **ushtrimin e tretë**, krijojnë kafshën duke lidhur numrat dhe e emërtojnë atë. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë duke parë modelin.

Reflektim

Hapi IV- Diktim

Në **ushtrimin e shtatë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën Gj gj të dorës dhe dy fjali.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim

Përsëritje për shkronjat V v, C c, Ç ç, G g, Q q, Gj gj

Mësimi 30.

Përsëritje për shkronjat V v, C c, Ç ç, G g, Q q, Gj gj të shtypit

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat V v, C c, Ç ç, G g, Q q, Gj gj të shtypit

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim diskutim, vëzhgo - analizo etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt V, C, Ç, G, Q, Gj;
- dallojnë shkronjat e mësuara V, C, Ç, G, Q, Gj dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- dallojnë shkronjat e shtypit nga të dorës;
- lexojnë dhe analizojnë fjalë duke i ndarë në rrokje e shkronja;
- krijojnë fjalë, grupe fjalësh dhe fjali duke parë figurat;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, diktim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet : luan, bisedon, vëzhgon-analizon, shkruan, lexon, analizon etj.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: shkronjat V, C, Ç, G, Q, Gj, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, shëno, vendos, lexo, shkruaj, diktim etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, grafiku i shkronjave V, C, Ç, G, Q, Gj, tabela plastike, figura, fletë formati, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim Hapi I - lojë

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet në formë loje, për të përsëritur shkronjat e grupit të katërt.

Nxënësit ndahen në gjashtë grupe të barabarta dhe ulen në karrige, të renditur njëri pas tjetrit. Mësues-i/ja qëndron para tyre dhe i fton gjashtë nxënësit e fundit të vijnë tek ai/ajo.

Atyre ua jep në dorë nga një etiketë me një shkronjë. Shkronjën e shënuar në etiketë nxënësit duhet ta shënojnë me gisht në shpinën e shokut/shoqes, që kanë para. Kështu vazhdohet deri sa shkronja të arrijë te nxënësi i parë, i cili duhet ta shënojë atë në tabelë. Mësuesja tregohet e kujdesshme dhe verifikon nëse të gjitha grupet e nxënësve kanë shkruar shkronjat, që ajo u ka dhënë në fillim. Vlerëson nxënësit.

Në tabelë nxënësit shikojnë etiketat me të 4 modelet e secilës shkronjë të mësuar (grupi i katërt i shkronjave) dhe në grupe i emërtojnë ato.

V e madhe e shtypit, **v** e vogël e shtypit, **V** e madhe e dorës, **v** e vogël e dorës.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 100 dhe punojnë ushtrime e dhëna, pasi mësuesja shpjegon kërkesat.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur ngjyrosin shkronjat e mësuara në grupin e shkronjave të dhëna.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte shkruajnë emrat e figurave me shkrim shtypi.

P.sh: celular qilim guackë

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur lexojnë dhe ngjyrosin fjalën e shkruar saktë.

Në **ushtrimin e katërt** analizojnë fjalët QUKAPIKU dhe PASQYRA.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit bashkojnë figurat dhe krijojnë grupet e fjalëve. Më pas krijojnë fjali me njërin prej grupeve dhe e lexojnë atë (**ushtrimi i gjashtë**).

P.sh: çelës dere, vagon treni, guackë deti, gjëmbi i trëndafilut Gjeta guacka deti.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit krijojnë fjalinë sipas figurës duke përdorur fjalën, që tregon veprim

vrapon. Fjalinë e shkruajnë me shkronja shtypi dhe dore.

Në **ushtrimin e tetë**, nxënësit në çifte emërtojnë objektet e dhëna duke ndiqur gjurmët.

P.sh: macja, kërmilli, ventilatori, pema, Vera, qypi, aparati, lulja, kapela etj

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrimin 1 në fletore pune.

Shkruajnë 10 fjalë dhe 3 fjali me shkronja shtypi. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Përsëritje për shkronjat *U u Ç ç G g Q q Gj gj* të dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat *U u Ç ç G g Q q Gj gj* të dorës

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të dallojë kuptimin e fjalëve të shkruara dhe të fjalive të formuara me figura;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të dallojë shkronjat, fjalët e fjalitë e veçanta.

Metodat dhe teknikat: bisedë, shkrimi i lirë, diktim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- krijojnë fjalë dhe fjali;
- kthejnë fjalët nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues).
- lexojnë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë - sintezë, diktim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup

Aktivitetet: bisedon, vëzhgon-analizon, shkruan, lexon etj.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjat **V, C, Ç, G, Q, Gj**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **V v, C c, Ç ç, G g, Q q, Gj gj**, tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Etiketa me rrokje e fjalë ngjiten në tabelë në mënyrë të çrregullt dhe nxënësit formojnë fjalë e fjali me to.

qe	ça	va	Petriti	ti	guacka	va	
gje	Bratila qu	ka	të bukur nta	go	ta	ni	ko
vi	qieti rka	li	pi	ku	m ka	fustan	

Nxënësit korrigjojnë dhe vlerësojnë punën e njëri – tjetrit të mbikqyrur nga mësuesi.

Realizim kuptimi


Hapi II – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin fletoren e punës dhe punojnë ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit të pavarur plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë.

P.sh: **gjirafa** **vagoni**

Ushtrimi i tretë: Nxënësit në çifte gjejnë fjalët: celulari, çerdhe, gështenja, qukapiku, gjuri.



Ushtrimi i pestë: Nxënësit shkruajnë fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Reflektim

Hapi III – Diktim (Ushtrimi i pestë) Vlerësohet diktimi i bërë nga nxënësit.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune.

Shkruajnë 5 fjalë dhe pesë fjali me shkronja dore. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja LI

Mësimi 31.

Shkronja LI II e shtypit

Njësia e mësimi: Shkronja LI II e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës.

Metodat dhe teknikat: lojë, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, pyetja sjell pyetjen etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin LI dhe identifikojnë atë në fjalë;
- shkruajnë shkronjën LI II të shtypit sipas modelit;
- bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokje;
- qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën II;
- lexojnë rrokje, fjalë, fjali të thjeshta;
- punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: shkronjë LI II, tingull, rrokje, fjalë, fjali, llambë, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, cd, magnetofon, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës LI II të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim


Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit shikojnë me kujdes në projektor, tv ose në tabelë foton e llambës dhe bëjnë një koment të shkurtër për të duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? Çfarë është llamba? Pse është e rëndësishme? Po në të kaluarën çfarë kanë përdorur në vend të llambës? Me cili tingull fillon emri llambë? etj.

Nxënësit shqiptojnë fjalën llambë dhe mësuesja tregon kujdes, që tingulli II të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë llambë në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e shkronjës (tingullit) II.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **lla-mbë**
- Fjala **llambë** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja II? (Në fillim)



Hapi II – loja **stop** - përjashto

Në videoprojektor, tv ose në tabelë janë vendosur disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

llambë ulliri dhëmbi kukull pëllumbi çanta


Luhet loja **stop** - **përjashto**. Mësues-i/ja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjoni **ll**

thoni **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjoni **ll** thoni **përjashto**.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **ll** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **ll** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **ll** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj. Bëhet dallimi i grafikës së shkronjës **ll** me **ll**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **ll** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 103 dhe shqiptojnë shkronjën **ll** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **ll** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Llupësi i famshëm i akullloreve”**.

Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bashkojnë shkronjat dhe krijojnë rrokjet (lla, llo, lle, llu etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte qarkojnë në fjalë rrokjet, që kanë në trup shkronjën **ll**. Shembull: lla, mill, llo, llo ...

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekstin mësimor dhe fletoren e punës.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte analizojnë fjalën **papagalli**. Zgjidhin dhe ngjyrosin përgjigjen e duhur poshtë skemës.

Shembull: ngjyra-ngjyra i gjelbër portokall

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **LI II** dhe pesë fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Ll ll e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja Ll ll e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë-asociacioni, bisedë, analizë-sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, demonstrim, diktim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Ll ll të dorës;
- shkruajnë shkronjën Ll ll të dorës sipas modelit;
- shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin;
- lexojnë rrjedhshëm fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore, që kanë shkronjën LI në trup të tyre;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, tv, kompjuter, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës LI II të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim Hapi I

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: lojën e asociacionit.

E NXEHTË	AKULL	E ËMBËL
DETI	KOHA	E KAFTË
PUSHIMET	BORA	E SHKRIRË
VERË	I/E FTOHTË	ÇOKOLLATA

AKULLORJA

Aktiviteti 2: Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup analizon një fjalë dhe krijon një fjalë.

Gr.1 akullore

Gr.2 kukull

Gr.3 ulliri

Gr.4 pëllumbi

Shembull: akullore = a + ku + llo + re Ne na pëlqejnë akulloret.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën Ll ll të dorës,

të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës LI II të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave LI II të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 103 dhe shqiptojnë shkronjën Ll ll të dorës. Nxënësit së bashku me mësues-in lexojnë dhe komentojnë tekstin **"Papagalli"**. Më pas e dëgjojnë këngën "Papagalli llafazan"- Marsella Bregu dhe Themir Mile.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës LI II me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit të pavarur vazhdojnë punimin e ushtrimeve (pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e parë**: përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Plotësojnë rreshtat me shkronjat e dorës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e tretë**: Shkruajnë emrin e fshatit Katërkollë.

Vihet theksi te përdorimi i shkronjës së madhe.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i katërt: Shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë.

Reflektim Hapi IV

Në **ushtrimin e gjashtë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën Ll ll të dorës dhe 2 fjali.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Rr

Mësimi 32.

Shkronja Rr rr e shtypit

Njësia e mësimi : Shkronja **Rr rr** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim-leximin fillestar.
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet :

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Rr** duke e lidhur me shkronjën **Rr**;
- shkruajnë shkronjën **Rr rr** të shtypit sipas modelit;
- krijojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë **Rr rr**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, tekst, rrënjë, qarko, formo, shkruaj, lexo, tregim etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, cd, magnetofon, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Rr rr** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Në projektor nxënësit shikojnë video ilustruese me bimë të njohura. Më pas bëjnë një koment duke u ndihmuar me pyetje: Çfarë shikoni në fotografi? Çfarë mund të dallojmë (shohim) te një bimë? A e dini çfarë kanë të përbashkët bimët? A janë të njëjta pjesët e një bime? Përse përdoren pjesët e bimëve? etj.


Paraqet ilustrimin “Pjesët e një bime” dhe shpjegon sikur njeriu që ka pjesët e trupit edhe bima ka pjesët e saj (rrënjët, kërcelli-trungu, gjethja, lulja dhe fryti-fara).

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **rrënjë** dhe mësuesi tregon kujdes që tingulli **rr** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalën **rrënjë** në tabelë dhe kryen procesin

e analizës për shpëputjen e shkronjës (tingullit) **rr**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **rrë-një**
- Fjala **rrënjë** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **rr**? (Në fillim)



Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që kanë në trup shkronjën **rr**.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Rr rr** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës .



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Rr rr** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Rr rr** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj. Bëhet dallimi i grafikës së shkronjës **R r** dhe **Rr rr**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Rr rr** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 107 dhe shqiptojnë shkronjën **Rr rr** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Rr** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë **“Rrënjët tona”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **rr**.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë shkronjën **rr** me të gjitha zanoret dhe krijojnë rrokjet (rra, rri, rre etj.).

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekst dhe fletore punë

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte ngjyrosin me ngjyrë të njëjtë fjalët, që formojnë një fjalë.

Shembull: Respekto fjalën të rriturit. Ndiq rregullat e qarkullimit.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Rr rr** dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____

Shkronja Rr rr e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Rr rr e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë – sintezë, metoda fonetike – alfabetike, lexim i drejtuar, diskutim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën **Rr rr** të dorës në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **Rr rr** të dorës sipas modelit;
- shkruajnë në mënyrë të pavarur rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- punojnë detyrat në tekst dhe fletore pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukatë muzikore.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore. etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor, cd, magnetofon, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **Rr rr** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4, kuti, vezë etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe improvizojnë këngën për fëmijë "Rrokoko".

Hapi II

Aktiviteti 2: Nxënësit ndahet në 3 ose 4 grupe dhe çdo grup ka një tabelë me shkronjën **Rr**. Brenda një afati të caktuar nxënësit ngjisin figura të ndryshme ose shkruajnë fjalë, ku tingulli (shkronja) **Rr/rr** ndodhet në fillim, në mes ose në fund të fjalës (emrit të figurës).

Shembull

Rr/rr në fillim të fjalës	rr në mes të fjalës	rr në fund të fjalës
rrota ...	furrë ...	kandërr ...

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezanton punën e grupit të vet.

Mësues-i/ja bën kujdes të shikojë se cili grup ka ngjitur më shumë figura ose ka shkruar më shumë fjalë të sakta. Nxënësit korrigjojnë dhe vlerësojnë punën e njëri – tjetrit. Nxënësit në çifte shkruajnë shkronjat **Rr rr**.

Realizim kuptimi

Hapi III

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Rr rr** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Rr rr** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Rr rr** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 109 dhe shqiptojnë shkronjën **Rr rr** të dorës. Më pas së bashku me mësues-in/en lexojnë fjalinë **Rrezarti mëson në klasën e dytë**. Vërejnë fjalët që rimojnë dhe shtojnë fjalë të tjera: **shtëpia – uria – kutia- çatia-qershia etj**. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Rr rr** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimet (pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat): Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Plotësojnë rreshtat me shkronjat e dorës.

Nxënësit në **ushtrimin e tretë** dallojnë fjalët, që tregojnë objekte (emërtojnë) nga ato që tregojnë veprime duke i ngjyrosur me ngjyrë të verdhë dhe blu.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit në **ushtrimin e tretë** shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë duke parë modelin.

Reflektim

Hapi V

Në **ushtrimin e pestë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Rr rr** të dorës dhe dy fjali.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Nj

Mësimi 33.

Shkronja Nj nj e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Nj nj** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë e fjali të thjeshta në përshtatje me shkrim- leximin fillestar ;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike-sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Nj** duke e lidhur me shkronjën **Nj**;
- shkruajnë shkronjën **Nj nj** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- krijojnë grupe fjalësh mbi bazën e figurave;
- lexojnë fjali e tekste me ndihmën e mësuesit;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë **Nj nj**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, njeri, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Nj nj** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.


Evokim

Hapi I – Stuhi mendimi

Nxënësit shikojnë figurën e njeriut në tabelë, tv ose projektor dhe përgjigjen me përgjigje të plotë në pyetjen: Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni fjalën njeri? Nxënësit shprehin mendimet e tyre.

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **njeri** dhe mësues-i/ja tregon kujdes që tingulli **nj** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalën **njeri** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës **nj**.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.



- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **nje-ri**
- Fjala njeri ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **nj**? (Në fillim)

Hapi II

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes në projektor/tv ose në tabelë figurat, që kanë poshtë fjalët përkatëse.

njëshi foshnja gjyshi shqiponja binjakët ullinj flamuj lumenj


Luhet loja **stop - përjashto**. Mësues-i/ja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjojnë **nj** të thonë **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **nj** të thonë **përjashto**. Nxënësit tregojnë edhe pozicionin e tingullit **nj** në këto fjalë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Nj nj** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Nj nj** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Nj** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Nj nj** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 110 dhe shqiptojnë shkronjën **Nj nj** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Nj** është bashkëtingëllore. Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin “**Njeriu prej bore**”. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur përgjigjen në pyetjet rreth tekstit. Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **nj** në fjalët e dhëna (nje, një, njo etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte krijojnë rrokje me shkronjën **nj** dhe shtatë zanore.

Shembull: nja njo nje etj.

Në **ushtrimin e katërt**, vështrojnë e krahasojnë figurat dhe në mënyrë intuitive dallojnë dy format e numrit të emrit. Pasurojnë fjalorin me fjalë të reja.


Shembull: (një) qiri – (disa) qirinj sy i zi – sy të zinj Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të ndihmuar nga mësuesi gjejnë fjalët: gështenja, njollë, një, shkronja.



Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit krijojnë grupet e fjalëve mbi bazën e figurave.

Shembull: tridhjetë e gjashtë shkronja qirinj me aromë ullinj Ulqini dy binjake
një njeri

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Nj nj**.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja *Nj nj* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njsia e mësimit: Shkronja *Nj nj* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë-sintezë, metoda fonetike-alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Nj nj* të dorës në fjalë;
- shkruajnë shkronjën *Nj nj* të dorës sipas modelit ;
- shkruajnë në mënyrë të pavarur rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues) ;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore që kanë shkronjën **nj** në trup të tyre me ndihmën e mësuesit;
- punojnë detyrat në tekst dhe fletore pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore pune, figura, cd, kompjuter, magnetofon, projektor/tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës *Nj nj* të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimit fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë këngën për fëmijë “Njëshi dhe zero”.

Hapi II

Aktivitet 2: Çdo nxënësi i jepet në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë, që kanë në përbërje shkronjë **nj**.

Kontrollohet dhe vlerësohet formimi i rrokjeve apo fjalëve nga nxënësit në çifte.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën *Nj nj* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke

e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave Nj nj të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës Nj nj të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor dhe fletore pune.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 112 dhe shqiptojnë shkronjën **Nj nj** të dorës. Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë fjalitë **Njëshi është numri i parë që kam mësuar. Numri një formon numrat e tjerë.** Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **Nj nj** të dorës me shkronjat e tjera. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Nj nj** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**. Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësues-i/ja.

Reflektim

Hapi V

Në **ushtrimin e gjashtë (Diktim)** nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalë e fjali me shkronja dore.

Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën *Nj nj* të dorës.

Punojnë ushtrime (pjesa e dytë) . Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja S

Mësimi 34.

Shkronja S s e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **S s** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike-alfabetike, metoda analitike-sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **S** duke e lidhur me shkronjën **S**;
- shkruajnë shkronjën **S s** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- krijojnë grupe fjalësh mbi bazën e figurave;
- lexojnë fjali e tekste me ndihmën e mësuesit;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjë **S s**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, syri, qarko, formo, shkruaj, lexo, lidh etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor/tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **S s** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Stuhi mendimesh


Nxënësit vëzhgojnë me kujdes fotografinë e syrit në tabelë, projektor ose tv dhe bëjnë një koment për të duke u ndihmuar nga pyetjet: Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni këtë fjalë? Çfarë është syri? Pse është i rëndësishëm? Si duhet të kujdesemi për të? Çfarë mund të na e dëmtojë? A dini ndonjë emër burimi që lidhet me fjalën sy? etj.

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **SYRI** dhe mësuesja tregon kujdes që tingulli **S** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalën **SYRI** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e shkronjës (tingullit) **S**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **SY-RI** .

- Fjala **SYRI** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **S**? (Në fillim)



Nxënësit në projektor/tv shikojnë figurat, që kanë poshtë fjalët përkatëse dhe përcaktojnë pozicionin e tingullit (shkronjës) **S** në to.


SPORTISTI SEMAFORI SAPUNI SIRTAR SIRENA

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **S s** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **S s** në tabelat e tyre magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **S** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar atë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **S s** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 114 dhe shqiptojnë shkronjën **S s** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **S** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Syri i Skafkaçit”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës. Punohet ushtrimi i parë, rubrika **Pyetje rreth tekstit**.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që në trup kanë shkronjën **s** (sy, se etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte bashkojnë shkronjën **s** me zanore dhe krijojnë rrokje.


Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit. Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i parë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë: sa, fus, sfun, sa, si, su.

Shembull: sapuni, fustan, sfungjer etj

Ushtrimi i dytë: Gjejnë fjalët: fustani, semafori, saksi dhe pesë.



Vlerësimi : Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **S s** dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja **e dorës**

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja  e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës.
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali.
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë-sintezë, metoda fonetike-alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, demonstrim, diktim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën **S s** të dorës;
- shkruajnë shkronjën **S s** të dorës sipas modelit;
- lexojnë rrjedhshëm fjali të thjeshta me shkrim shtypi e dore, që kanë shkronjën **s** në trup të tyre;
- krijojnë rrokje, fjalë dhe fjali me shkronja lëvizore;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurative.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, projektor/tv, kompjuter, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **S s** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehi këngën “Semafori”.

Aktiviteti 2: Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup krijon rrokje, fjalë dhe fjali

me shkronja lëvizore.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **S s** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **S s** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **S s** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë atë në tabelë.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 116 dhe shqiptojnë shkronjën  të dorës. Më pas lexojnë fjalinë **Semafori ka tri ngjyra**. Dallojnë fjalët që rimojnë: **ngjyra – fytyra – natyra**. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **S s** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit të pavarur punojnë ushtrimet (pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat): Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**: Plotësojnë rreshtat me shkronjat e dorës. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**: Shkruajnë me shkronja dore rrokjet e fjalët sipas modelit.

Në **ushtrimin e gjashtë (Diktim)**: Shkruajnë me të diktuar rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën  të dorës dhe dy fjali.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës dhe në tekstin mësimor. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja H

Mësimi 35.

Shkronja H h e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja **H h** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **H** dhe e identifikojnë atë në fjalë;
- shkruajnë shkronjën **H h** të shtypit sipas modelit;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, edukim fizik

Fjalë kyçe: shkronjë **H h**, tingull, rrokje, fjalë, hartë, vështro, vendos, lexo, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor/tv , tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **H h** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike , fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake


Nxënësit shikojnë në tv, projektor ose në tabelë disa lloje hënash dhe përgjigjen me përgjigje të plotë në pyetjet: Çfarë shikoni në tabelë?

Hapi II

Nxënësit së bashku të shqiptojnë fjalën **hënë** dhe mësuesja bën kujdes që tingulli **h** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Shkruan fjalën **hënë** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **h** . Demonstron ndarja e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku : **hë-në**.
- Pra, fjala **hënë** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **h**? (Në fillim)




Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë, në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin **h** (hëna, helikopteri, lahuta, pëllumbi, harabeli, krimbi, hekuri etj.) dhe të përcaktojnë pozicionin e tij në to. Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë shkronjën **h** në trup të tyre.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **H** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **H h** në tabela magnetike ose fletë të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **H** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës në tabelë e shkruajnë atë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **H h** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 117 dhe shqiptojnë shkronjën **H h** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **H** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Hapadollapa”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Ushtrimi i dytë: Krijojnë rrokje duke bashkuar shkronjën **h** me të gjitha zanoret.

Ushtrimi i tretë: Qarkojnë rrokjet që përmbajnë shkronjën **h**. Shkruajnë ditën e parë të javës (e hënë).

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit. Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe krijojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës.

Ushtrimi i dytë: Në çifte analizojnë fjalën helikopteri.

Ushtrimi i tretë: Zgjidhin fjalëkryqin.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruaj dy rreshta me shkronjën **H h** dhe pesë fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin

Shkronja H h e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja H h e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të lexojnë në mënyrë të pavarur.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë – sintezë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën H h të dorës;
- shkruajnë shkronjën H h të dorës sipas modelit;
- lexojnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, etiketa, kompjuter, videoprojektor, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës H h të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit në çifte shkruajnë shkronjën H h në tullumbace. Lëvizin nëpër klasë dhe në momentin, që mësuesja përplas duart, ata formojnë çiftet e shkronjave H h.

Nxënësit në grupe analizojnë nga një fjalë dhe krijojnë nga një fjali.

Gr.1 hoteli Gr.2 hëna Gr.3 lahuta Gr.4 harabeli Shembull: lahuta = la + hu + ta Drini i bie lahutës.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën H h të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e

shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **H h** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës shkruajnë në tabelë shkronjën **H h**.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **H h***

të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 119 dhe shqiptojnë shkronjën *ℋ ℋ* të dorës. Më pas së bashku me mësuesin lexojnë fjalinë **Vajza i bie harmonikës**. Shkruajnë fjalët, që rimojnë me fjalën harmonikë: harmonikë – llastikë - mekanikë. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **H h** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Ngjyrosin me ngjyrë të verdhë fjalët që tregojnë objekte (halla, hekur, helmeta, hunda) e me ngjyrë blu ato që tregojnë veprime (ha, hipi, hoqa, nuhat).

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqes ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i gjashtë : Nxënësit lexojnë fjalitë. Lidhin ato me figurën e duhur.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrim në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin_____

Shkronja Sh

Mësimi 36.

Shkronja Sh sh e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Sh sh** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të dallojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Sh** duke e lidhur me shkronjën **Sh**;
- shkruajnë shkronjën **Sh sh** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- krijojnë grupe fjalësh mbi bazën e figurave;
- lexojnë fjali e tekste me dhe pa ndihmën e mësuesit;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: shkronja **Sh sh**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, shega, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkurtesë, grafikuri i shkronjës Sh, sh të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike -, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehje këngën “Fruta dhe perime”. Më pas mësuesi shkruan në tabelë fjalën fruta dhe u kërkon nxënësve, që fillimisht të thonë emrat e frutave nga kënga dhe pastaj të tregojnë edhe për frutat e tjera që njohin.




FRUTAT

Flitet për rëndësinë e frutave dhe ndalet biseda konkretisht te shega-si frytë shumë i shëndetshëm.

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **shegë** dhe mësuesi tregon kujdes që tingulli **sh** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalën **shegë** në tabelë dhe kryen procesin

e analizës për shkëputjen e shkronjës **sh**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.



- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **she**-gë.
- Fjala **shegë** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **sh**? (Në fillim)

Nxënësit vëzhgojnë në projektor/tv ose tabelë disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse. shqiponja sapuni shtëpia shtrati stop shamia pesha fusha
Luhet loja **stop - përjashto**. Mësues-i/ja lexon fjalët dhe u thotë nxënësve, që në ato fjalë që dëgjojnë **sh** të thonë **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **sh** të thonë **përjashto**. Nxënësit tregojnë edhe pozicionin e tingullit **sh** në këto fjalë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Sh sh** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Sh sh** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Sh sh** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Sh sh***

me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 121 dhe shqiptojnë shkronjën **Sh sh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Sh** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin "**Qyteti i lashtë i Shasit**". Vëzhgojnë shkronjën **Sh sh** në tekst.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato).

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte krijojnë rrokje me shkronjën **sh** dhe shtatë zanore.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **sh** në fjalët e dhëna (shqi, shku, she, sho, shi, etj)

Nxënësit që kanë vështirë ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V- Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit lexojnë fjalët. Shënojnë me X çfarë nuk i përket rreshtit. Shembull: Në rreshtin e parë i vendosin X fjalës **shok**

Në rreshtin e dytë i vendosin X fjalës **shishe**

Në rreshtin e tretë i vendosin X fjalës **shall**

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalët (shtëpi, shkurre, kopësht, shkollë, kashtë).

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Sh sh** dhe 10 fjalë. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja *Sh sh* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Shkronja *Sh sh* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të lexojnë në mënyrë të pavarur.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Sh sh* të dorës;
- shkruajnë shkronjën *Sh sh* të dorës sipas modelit;
- krijojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, cd, kompjuter, magnetofon, tv, projektor, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Sh sh** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim Hapi I - lojë

Ora e mësimit fillon me këtë aktivitet: Çdo nxënësi ka në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë, që kanë në përbërje shkronjë **sh**. Mund të lexohen rrokjet dhe fjalët e krijuara nga nxënësit.

Kontrollohet dhe vlerësohet formimi i rrokjeve apo fjalëve nga nxënësit në çifte.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Sh** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Sh sh** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Sh sh** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 123 dhe shqiptojnë shkronjën **Sh sh** të dorës. Nxënësit lexojnë tekstin "**Shtëpia e kastorit**" dhe e komenton atë. Më pas e vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **sh** të dorës me shkronjat e tjera tek grupi i fjalëve **Shtëpia e kastorit**. Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Sh sh** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bisedojnë së bashku me mësuesin për disa liqene në Mal të Zi.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**. Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit shkruajnë fjalinë e dhënë me shkronja dore.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Sh sh** të dorës dhe 2 fjali. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Përsëritje për shkronjat LI ll, Rr rr, Nj nj, S s, H h, Sh sh

Mësimi 37.

Përsëritje për shkronjat LI ll, Rr rr, Nj nj, S s, H h, Sh sh të shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat LI ll, Rr rr, Nj nj, S s, H h, Sh sh të shtypit

Tipi i orës: Orë për përfundim të njohurive

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim diskutim, vëzhgo - analizo etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt LI, Rr, Nj, S, H, Sh;
- dallojnë shkronjat e mësuara LI, Rr, Nj, S, H, Sh dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- dallojnë shkronjat e shtypit nga të dorës;
- lexojnë dhe analizojë fjalë duke i ndarë në rrokje e shkronja;
- krijojnë fjalë, grupe fjalësh dhe fjali duke parë figurat;
- lexojnë fjali të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Metodat dhe teknikat: bisedë, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim, diskutim, vëzhgo - analizo, ditari dypjesësh etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet : bisedon, vëzhgon-analizon, shkruan, lexon, krahason, komenton etj.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë, kulturë muxikore

Fjalë kyçe: shkronjat LI, Rr, Nj, S, H, Sh, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, shëno, vendos, lexo, shkruaj. etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave LI, Rr, Nj, S, H, Sh, tabela plastike, figura, fletë formati, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë me vëmendje këngën për fëmijë

“ Rring e xhing A B C” dhe në çifte shënojnë në fletë shkronjat e mësuara deri tani. Fletët ngjiten në tabelë dhe së bashku me nxënës diskutohet, se cili çift ka shënuar më shumë dhe saktë shkronja të mësuara. Mund të shpallet çifti apo çiftet fituese.

Aktivitet 2: Nxënësit në grupe formojnë rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Gr.1 → formojnë rrokje Gr.2 → formojnë fjalë Gr.3 → formojnë fjali

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezenton punën e grupit të vet.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 124 dhe punojnë e ushtrimet e dhëna.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur identifikojnë shkronjat e mësuara në grupin e shkronjave të dhëna dhe i ngjyrosin ato.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte shkruajnë fjalën poshtë figurës me shkronja shtypi.

Shembull: rrënjë semafor

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur ndajnë fjalët në rrokje e shkronja.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit përcaktojnë pozicionin e tingujve L, H, Nj në fjalët e dhëna në çdo rresht, duke shënuar X në katrorin e duhur. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit shënojnë poshtë figurave fjalët përkatëse.

Shembull: zogu ciu – ciu → qengji → be-be-be etj.

Në **ushtrimin e gjashtë**, nxënësit bisedojnë për situatat e mëposhtme.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në dy format e saj. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizim _____

Përsëritje për shkronjat Ll ll Rr rr Nj nj S s H h Sh sh të dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat Ll ll Rr rr Nj nj S s H h Sh sh të dorës

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të dallojë kuptimin e fjalëve të shkruara dhe të fjalëve të formuara me figura;
- të dallojë shkronjat, fjalët e fjalitë e veçanta;

Metodat dhe teknikat: bisedë, vëzhgo - analizo, shkrimi i lirë, diktim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shkruajnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- punojnë ushtrimet në tekst dhe fletë pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: përsëritje për shkronjat **LI ll, Rr rr, Nj nj, S s, H h, Sh sh**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: fletore pune, grafiku i shkronjave **LI ll, Rr rr, Nj nj, S s, H h, Sh sh** tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet të nxënësve në grupe. Nxënësit ndahen në 6 grupe. Nxënësve u jepen foto të ndryshme të fjalëve që përmbajnë në trup shkronjat: **LI, Rr, Nj, S, H, Sh**. Çdo grupi një shkronjë. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato në formë autodiktimi në një fletë ose tabak letre me shkronja shtypi dhe dore.

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezanton punën e grupit të vet. Grupet korrigjojnë njëri – tjetrin. Mësuesja lavdëron dhe vlerëson nxënësit për punën e bërë në grupe.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë në fletore pune

Nxënësit hapin fletoren e punës dhe punojnë ushtrimet e dhëna, pasi mësuesja shpjegon kërkesat.

Ushtrimi i parë: Nxënësit në grupe krijojnë rrokje me shkronjat e mësuara.

Shembull: grupi i parë → krijojnë rrokje me bashkëtingëlloren **ll** dhe zanoret.

Ushtrimi i dytë: Krijojnë fjalë me shkronjat e dhëna (LAHUTË, shqiponjë, RROTË).


Ushtrimi i tretë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që duhet.

Shembull: portokall, rripi, shkronja etj.

Ushtrimi i katërt: Ngjyrosin vetëm fjalët që tregojnë figurat (harabel, akullore, shega, roba,

helikopter).

Ushtrimi i pestë: Gjejnë në çifte fjalët e kërkuara.



Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi III – Diktim

Ushtrimi i tetë (Diktim): Mësuesja u dikton nxënësve rrokje, fjalë dhe fjali me shkronjat e mësuara.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në format e saj.

Punojnë ushtrimet në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Th

Mësimi 38.

Shkronja Th th e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Th th** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Th** duke e lidhur me shkronjën **Th**;
- shkruajnë shkronjën **Th th** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje) fjalë, fjali e tekste të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjë **Th th**, tingull, rrokje, fjalë, thesar, vështro, vendos, lexo, shkruaj, përrallë etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **Th th** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Stuhi mendimi



Nxënësit shprehin mendimin e tyre dhe mësuesi plotëson skemën.

Nxënësit së bashku shqiptojnë fjalën **thesar** dhe mësuesi bën kujdes që tingulli **th** të shqiptohet saktë nga nxënësit.


Hapi II

Shkruan fjalën **thesar** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e shkronjës (tingullit) **th**. Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje

duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku : **the**-sar

-Fjala **thesar** ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **th**? (Në fillim)



Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë, në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin **th** (thuprat, top, gjethe, thikë, termometër, tharëse, thes, thanë, thërime etj.) dhe të përcaktojnë pozicionin e tij në to. Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë shkronjën **th** në trup të tyre

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën Th të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Th th** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Th** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Ngrihen 2 – 3 nxënës në tabelë për ta shkruar atë. *Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **Th th***

me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 127 dhe shqiptojnë shkronjën **Th th**, që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Th** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Thesari i vërtetë”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Ushtrimi i dytë: Krijojnë rrokje duke bashkuar shkronjën **th** me të gjitha zanoret (tha, thi, tho etj.).

Ushtrimi i tretë: Qarkojnë rrokjet që përmbajnë shkronjën **th** (the, thi, thu, the, tha , thu). Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi V – Vazhdim i punimit të ushtrimeve në tekstin mësimor dhe fletoren e punës nga nxënësit. Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe krijojnë shkronjat.

Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës.

Ushtrimi i parë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë.

Ushtrimi i dytë: Vendosin shkronjat në vendin e duhur dhe krijojnë fjalët: THITH, THUR, THUPËR.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Th th** dhe 5 fjalë.

Punojnë ushtrimet 3, 4 dhe 5 në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Th th e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *Th th* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të lexojë në mënyrë të pavarur.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Th th* të dorës;
- shkruajnë shkronjën *Th th* të dorës sipas modelit;
- krijojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë në mënyrë të pavarur fjalë e fjali;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, tekst etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, etiketa, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafi-ku i shkronjës **Th th** të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit në çifte shkruajnë shkronjën **Th th** në tullumbace. Lëvizin nëpër klasë dhe në momentin, që mësuesja përplas duart, ata formojnë çiftet e shkronjave **Th th**.

Nxënësit në grupe analizojnë nga një fjalë dhe krijojnë nga një fjali.

Gr.1 thesari

Gr.2 thesi

Gr.3 thërime

Gr.4 djathë

Shembull: thesari = the + sa + ri Ne gjetëm një thesar.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën *Th th* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Th th** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës Th th të dorës me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 129 dhe shqiptojnë shkronjën *Th th* të dorës. Më pas nxënësit lexojnë fjalën **Thuthuqi mban gishtin në gojë** dhe vërejnë lidhjen e shkronjës **th** me shkronjat e tjera. Krahasojnë fjalitë e shkruara me shkronja shtypi dhe dore. Gjithashtu, mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **Th th** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Gjejnë thesarin bashkë me piratët. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Lidhin veprimin me objektin.

Shembull: thej gotën thur shportë

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i gjashtë: Shkruajnë me shkronja dore rrokje e fjalë duke parë modelin.

Ushtrimi i shtatë: Shkruajnë fjalën me shkronja dore.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Th th** dhe tri fjali. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Dh

Mësimi 39.

Shkronja Dh dh e shtypit

Njësia e mësimi: Shkronja **Dh dh** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimi fillestar.

Metodat dhe teknikat: dëgjim i vëmendshëm, lojë, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Dh** duke e lidhur me shkronjën **Dh**;
- shkruajnë shkronjën **Dh dh** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje) fjalë, fjali e tekste të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronjë **Dh dh**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, dhëmbi, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, cd, magnetofon, kompjuter, projektor, tv figura, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës **Dh dh** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim


Hapi I – Stuhi mendimi

Nxënësit shprehin mendimin e tyre lirshëm dhe mësuesja plotëson skemën.

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **dhëmbi** dhe mësuesi tregon kujdes që tingulli **dh** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **dhëmbi** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **dh**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **dhëmbi**
- Fjala dhëmbi ka 2 rrokje. Ku ndodhet shkronja **dh**? (Në fillim)



Nxënësit në projektor, tv ose në tabelë shikojnë figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse. dhurata dhëlpër pemë dhjetor qershor kërpudhë hudhër
Luhet loja **stop - përjashto**. Një nxënës lexon fjalët dhe u thotë shokëve/shoqeve, që në ato fjalë që dëgjoni **dh** thoni **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjoni **dh** thoni **përjashto**.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën **Dh** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Dh dh** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Dh** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **Dh dh** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 131 dhe shqiptojnë shkronjën **Dh dh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Dh** është bashkëtingëllore. Bëhet dallimi në shqiptim në mes shkronjave **dh** dhe **ll**. Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Zana e Dhëmbëve”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës. Lexohet teksti zinxhir nga disa nxënës, që kanë aftësi të dalluara në lexim.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato): Në **ushtrimin e parë**, nxënësit punojnë pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bashkojnë shkronjën **dh** me të gjitha zanoret dhe krijojnë rrokjet (dha, dhi, dho, dhu etj.).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte qarkojnë në fjalë rrokjet, që kanë në trup shkronjën **dh**.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.


Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit bashkojnë rrokjet duke krijuar fjalët sipas figurave.

Shembull: dhurata bredhi kërpudhë

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit gjejnë fjalët: dhëlpër, dhuratë, dardhë, çerdhe.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.



Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Dh dh** dhe pesë fjalë.

Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Dh dh e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Dh dh e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh;
- të përdorë drejt shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë -sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Dh dh të dorës;
- shkruajnë shkronjën Dh dh të dorës sipas modelit;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- argumentojnë përdorimin e shenjave të pikësimit në fjali;
- krijojnë fjali duke i renditur fjalët si duhet;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues).

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore, shenja pikësimi, këshilla etj **Mjetet e mësimi:** teksti mësimor, fletore pune, figura, cd, kompjuter, magnetofon, projektor, tv, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës Dh dh të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimit fillon me këtë aktivitet: Nxënësit shikojnë dhe dëgjojnë me vëmendje dentistin e fëmijëve në një video në projektor ose tv.

Nëse ka mundësi mësuesi mund të ftojë një dentist në klasë ose të bëjë një vizitë me nxënës në klinikë dentare për fëmijë.

Aktivitet 2: Nxënësit shkruajnë shkronjën **Dh dh** në tullumbace. Në momentin, që mësuesja përplas duart, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe formojnë çiftet e shkronjave **Dh dh**.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën *Dh dh* të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Dh dh** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës mësuesja mund t'i aktivizojë që ta shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **Dh, dh** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 133 dhe shqiptojnë shkronjën **Dh dh** të dorës. Nxënësit lexojnë fjalitë me shkronja shtypi. Dallojnë shenjat e pikësimit të përdorura në fund të këtyre fjalive. Më pas lexojnë fjalinë me shkronja dore dhe vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **dh** me shkronjat e tjera.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Dh dh** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Vazhdohet punimi i detyrave të tjera (pasi mësues-i/ja sqaron kërkesat): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në labirint ndihmojnë mama dhinë të shkojë tek kecat.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e tretë**. Shkruajnë me shkronja dore fjalët e krijuara. Në **ushtrimin e gjashtë**, shkruajnë me shkronja dore rrokje dhe fjalë.

Mësuesja përcjellë punën e nxënësve dhe ndihmon ata që kanë vështirësi.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën *Dh dh* të dorës.

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja X

Mësimi 40.

Shkronja X x e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **X x** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **X** duke e lidhur me shkronjën **X**;
- shkruajnë shkronjën **X x** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje) fjalë, fjali e tekste të thjeshta me shkronjat e mësuara;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: shkronjë **X x** tingull, rrokje, fjalë, xixëllonjë, vështro, vendos, lexo, shkruaj etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, tv, projektor , tabelë, shkurtes, grafiku i shkronjës **X x** të shtypit, mjete vizatimi, tabela plastike , fletë format etj.

Evokim


Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë "Xixëllonja".

Nxënësit së bashku shqiptojnë fjalën **xixëllonja** dhe mësues-i/ja bën kujdes që tingulli **X** të shqiptohet saktë nga nxënësit.

Shkruan fjalën **xixëllonja** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shkëputjen e shkronjës (tingullit) **X** . Demonstron ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku : **xi-xë-llo-nja**
- Fjala **xixëllonja** ka katër rrokje. Ku ndodhet shkronja **x**? (Në fillim dhe në mes)




Mësuesja thotë disa fjalë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë në cilat prej tyre dëgjojnë tingullin **x** (nxitoj , lexoj, xixëllonjë, kali, velenxa , dhurata etj.) dhe të përcaktojnë pozicionin e tij në to. Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë shkronjën **X** në trup të tyre.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **X** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në grupe e çifte e shqiptojnë atë.

Prezanton grafikun e shkronjës.



Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë disa herë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **X x** në tabela magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **X** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **X x***

me anë të një videoje ilustruese.

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 135 dhe shqiptojnë shkronjën **X x** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **X** është bashkëtingëllore.

Nxënësit lexojnë zinxhirin e tekstit **A e dini se?** Më pas e komentojnë atë.

Nxënësit punojnë ushtrimet e tjera të dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Ushtrimi i parë: Nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Ushtrimi i dytë: Krijojnë rrokje duke bashkuar shkronjën **X** me të gjitha zanoret.

Ushtrimi i tretë: Qarkojnë rrokjet që përmbajnë shkronjën **X**.

Reflektim


Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit. Ushtrimi i katërt: Bashkojnë pikat dhe krijojnë shkronjat.

Vazhdohet punimi i ushtrimeve në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë.

Shembull: xixa, nxënës, xixëllonja, lexoj, bërxiollë, velenxë

Në **ushtrimin e dytë:** Zgjidhin fjalëkryqin (1. bërxiollë, 2. nxënës, 3. lexoj, 4. xixa)



Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruaj dy rreshta me shkronjën **X x** dhe pesë fjalë.

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja $\mathcal{X}$ $\propto$ **e dorës**

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja $\mathcal{X}$ $\propto$ e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë – sintezë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën $\mathcal{X}$ $\propto$ të dorës;
- shkruajnë shkronjën **X x** të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore duke parë modelin;
- kthejnë fjalën nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, vjershë, strofa, rima etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, etiketa, kompjuter, tv, projektor, tabelë, shumës, grafiku i shkronjës **X x** të dorës, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I - Ora fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit në çifte shkruajnë shkronjën **X x** në tullumbace. Lëvizin nëpër klasë dhe në momentin, që mësuesja përplas duart, ata formojnë çiftet e shkronjave **X x**.

Nxënësit në grupe analizojnë nga një fjalë dhe krijojnë nga një fjali. Gr.1 xixëllonjë Gr.2 lexoj

Gr.3 velenxa Gr.4 nxënësi Shembull: nxë-në-si Nxënësi shkoi në shkollë.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **X** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **X x** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **X x** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 137 dhe shqiptojnë shkronjën **X x** të dorës. Më pas lexojnë fjalinë **Ylli në qiell xixëllon xixa – xixa**. Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **x** me shkronjat e tjera. Demontrohet ajo nga mësuesi dhe nxënësit në tabelë për të formuar rrokje e fjalë. Shkruajnë fjalët, që rimojnë me fjalën xixëllonjë.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dytë**. Plotësojnë me shkronja dore rreshtat sipas modelit.

Ushtrimi i tretë: Ngjyrosin me ngjyrë të verdhë fjalët që tregojnë objekte (xixa, velenxë) e me ngjyrë blu ato që tregojnë veprime (lexoj, nxeh, nxitoj, nxjerr).

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Ushtrimi i pestë: Shkruajnë me shkronja dore rrokjet dhe fjalët duke parë modelin.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit. Ushtrimi i gjashtë: Lidhin fjalinë me figurën.

Ushtrimi i shtatë: Shkruajnë me shkronja dore dy nga fjalitë e ushtrimit të gjashtë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **X x** të dorës.

Punojnë ushtrime në tekstin mësimor. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Xh

Mësimi 41.

Shkronja Xh xh e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Xh xh** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Xh** duke e lidhur me shkronjën **Xh**;

shkruajnë shkronjën **Xh xh** të shtypit sipas modelit;

formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;

lexojnë në mënyrë të pavarur;

punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronja **Xh xh**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, xhubleta, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor/tv, cd, magnetofon, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Xh xh** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Para tabelës dalin dy vajza (2 nxënëse) të veshura në xhubleta. Mësues-i/ja për të nxitur bisedën mund t'u drejtojë nxënësve pyetjet: Si janë veshur shoqet tuaja? A e dini si e ka emrin kjo veshje? Çfarë simbolizon xhubleta? A keni parë veshje të tilla në festivale apo televizion? etj. Mund të dëgjohet edhe ndonjë këngë kushtuar xhubletës.

Në pamundësi të sjelljes së xhubletës në klasë, mësues-i/ja mund t'u tregojë nxënësve xhubletën përmes fotove ose videove të pasqyruara me projektor.


Hapi II

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **xhubleta** dhe mësuesi tregon kujdes, që tingulli **xh** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **xhubleta** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërndarjen e shkronjës **xh**.

Nxënësit së bashku me mësuesen demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **xhu**-ble-ta

Fjala **xhubleta** ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **xh**? (Në fillim)




Nxënësit shikojnë në projektor, tv ose në tabelë disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse. xhaxhi oxhak gjirafa panxhar gjethe valixhja xhaketa xhami
Luhet loja **stop - përjashto**. Një nxënës lexon fjalët dhe u thotë shokëve/shoqeve, që në ato fjalë që dëgjojnë **xh** të thonë **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **xh** të thonë **përjashto**. Nxënësit tregojnë edhe pozicionin e tingullit **xh** në këto fjalë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Xh xh** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë.



Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë hap pas hapi disa herë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Xh, xh** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Xh xh** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Mund të ngrihen nxënës në tabelë për të shkruar grafikun e saj.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Xh xh***

me anë të një videoje ilustruese.

Hapi IV - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 138 dhe shqiptojnë shkronjën **Xh xh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Xh** është bashkëtingëllore.


Nxënësit së bashku me mësuesin lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Xhubleta”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës. Lexohet teksti zinxhir nga disa nxënës, që kanë aftësi të dalluara në lexim.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit në çifte krijojnë rrokje me shkronjën **xh** dhe shtatë zanore.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **xh** në fjalët e dhëna.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat. Nxënësit që kanë vështirë ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.



Reflektim

Hapi V - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në ushtrimin e dytë, nxënësit bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalët (xhinse, xhamadan, xhuxhi, xhaketa). Në ushtrimin e katërt, nxënësit në çifte gjejnë fjalët: gonxhe, filxhan, panxhar, xhami (qelqi).

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Xh xh** dhe dhjetë fjalë.

Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja *Xh xh* e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja *Xh xh* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën *Xh xh* të dorës;
- shkruajnë shkronjën **Xh xh** të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore duke parë modelin;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimitdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë.

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore, tregim etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, kompjuter, projektor/tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës **Xh xh** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Çdo nxënës mban në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë, që kanë në përbërje shkronjë **xh**. Mund të lexohen rrokjet dhe fjalët e krijuara nga nxënësit.

Kontrollohet dhe vlerësohet formimi i rrokjeve apo fjalëve nga nxënësit në çifte.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njih nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën *Xh xh* dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Xh xh** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e

tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë atë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Xh xh** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 140 dhe shqiptojnë shkronjën **Xh xh** të dorës. Më pas lexojnë fjalinë **Xhami lejon të hyjë drita, porna mbron nga shiu dhe era**. Ata vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **xh** të dorës me shkronjat e tjera tek fjalia e lexuar.

Mësuesi demonstroi lidhjen e shkronjës **Xh xh** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi shpjegon kërkesat):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit bashkojnë pikat dhe krijojnë personazhin. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e pestë**. Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore sipas modelit. Mësuesja përcjell punën e nxënësve dhe i ndihmon ata që kanë vështirësi.

Relektim

Hapi IV

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit shkruajnë me të diktuar shkronja, rrokje dhe fjalë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën  të dorës dhe 2 fjali.

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shkronja Z

Mësimi 42.

Shkronja Z z e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Z z** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: vëzhgo - analizo, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Z** duke e lidhur me shkronjën **Z**;
- shkruajnë shkronjën **Z z** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronja **Z z**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, zambaku, qarko, formo, shkruaj, lexo, tregim etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor/tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Z z** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim


Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit shikojnë në projektor/tv ose tabelë foto të ndryshme të luleve dhe i emërtojnë ato. Përshkruajnë karakteristikat e zambakut.

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën **zambaku** dhe mësuesi tregon kujdes që tingulli **z** të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë **zambaku** në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpërbërjen e shkronjës **z**.

Nxënësit së bashku me mësuesin demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **za**-mba-ku
- Fjala **zambaku** ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **z**? (Në fillim)



Hapi II

Nxënësit vendosen në formë rrethi dhe i hedhin topin njëri – tjetrit. Nxënësi, që ka topin në dorë duhet të thotë një fjalë që ka në trup tingullin **Z**. Nëse që nuk e di përjashtohet nga loja. Mund të përcaktohet edhe pozicioni i tingullit në fjalët, që thonë nxënësit.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Z z** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë. Prezanton grafikun e shkronjës .

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Z z** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Z z** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.) . Disa nxënës në tabelë e shkruajnë atë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t’u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Z z** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 141 dhe shqiptojnë shkronjën **Z z** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Z** është bashkëtingëllore.

Nxënësit së bashku me mësues-in/en lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Zambakët e liqenit të Shkodrës”** . Shpjegohen fjalët më pak të njohura. Lexohet teksti zinxhir nga disa nxënës, që kanë aftësi të dalluara në lexim.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte krijojnë rrokje me shkronjën **z** dhe shtatë zanore.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **z** në fjalët e dhëna (ze, zo, za, zo, ze, zor)

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat.

Gjatë punës mësuesi mund t’u japë nxënësve sugjerimet përkatëse për çdo ushtrim. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë fjalëkryqin me fjalët: zero, bizele, zebra, zjarr. Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit në çifte pranë secilës figurë shkruajnë fjalën që lidhet me të.

Shembull : mbërthej – zbërthej mbath – zbath

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë dy rreshta me shkronjën **Z z** dhe dhjetë fjalë. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin

Shkronja Z z e dorës

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja Z z e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike- alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve :

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Z z të dorës;
- shkruajnë shkronjën Z z të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore duke parë modelin;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesë, grafiku i shkronjës Z z të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit në çifte në tullumbace shkruajnë shkronjat Z z dhe lëvizin nëpër klasë. Në çastin kur mësuesi përplas duart, ata bashkohen dhe formojnë çiftet e shkronjave Z z.

Nxënësit në grupe analizojnë nga një fjalë dhe krijojnë nga një fjali.

Gr.1 televizor Gr. 2 zemërmirë Gr.3 vazo Gr. 4 doreza

Shembull: te-le-vi-zor Babai bleu një televizor të ri.

Kontrollohet dhe vlerësohet puna e bërë nga nxënësit në grupe.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimi dhe prezanton shkronjën Z z të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezanton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi në mes shkronjave Z z të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e

tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa nxënës e shkruajnë atë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezentojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Z z** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 143 dhe shqiptojnë shkronjën **Z z** të dorës.

Më pas lexojnë fjalinë **Kjo është Zana zemërarta**. Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **Z z** të dorës me shkronjat e tjera tek fjalia e lexuar.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Z z** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit vazhdojnë punimin e detyrave (pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat): Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat.

Në **ushtrimin e tretë**, krijojnë në grupe zambakun e ujit.

Reflektim

Hapi IV - Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e katërt**. Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore duke parë modelin.

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalë dhe fjali.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Z z** të dorës dhe 2 fjali.

Punojnë ushtrimenë fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizimin _____

Shkronja Zh

Mësimi 43.

Shkronja Zh zh e shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Shkronja **Zh zh** e shtypit

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali;
- të lexojë me shpejtësinë e duhur fjalë, fjali dhe tekste të përshtatura lexim-shkrimit fillestar.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, metoda fonetike - alfabetike, metoda analitike - sintetike, demonstrim, bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Aktivitetet e nxënësve:

- shqiptojnë saktë (qartë) tingullin **Zh** duke e lidhur me shkronjën **Zh**;
- shkruajnë shkronjën **Zh zh** të shtypit sipas modelit;
- formojnë dhe lexojnë rrokje, fjalë e fjali;
- dallojnë në mënyrë intuitive fjalët me kuptim të kundërt;
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë detyrat në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ.

Fjalë kyçe: shkronja **Zh zh**, tingull, rrokje, fjalë, fjali, qarko, formo, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, kompjuter, projektor, tv, figura, tabelë, shkumës, grafiku i shkronjës **Zh, zh** të shtypit, tabela e alfabetit, mjete vizatimi, tabela plastike, fletë format etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit shikojnë në tabelë ose tv fotografinë e zhytësit dhe bëjnë një koment të shkurtër për të. Mësuesja plotëson skemën me pergjigjet e nxënësve.



zhytësi

Nxënësit shqiptojnë së bashku fjalën zhytësi dhe mësuesi tregon kujdes që tingulli zh të shqiptohet saktë nga nxënësit. Më pas e shkruan fjalë zhytësi në tabelë dhe kryen procesin e analizës për shpëputjen e shkronjës zh.

Nxënësit së bashku me mësuesin demonstrojnë ndarjen e fjalës në rrokje duke lëvizur duart majtas – djathtas.

- Sa rrokje ka kjo fjalë? Provojmë ta ndajmë së bashku: **zhy**-të-si

– Fjala zhytësi ka 3 rrokje. Ku ndodhet shkronja **zh**? (Në fillim)

Hapi II

Nxënësit shikojnë në projektor, tv ose tabelë disa figura, që kanë poshtë fjalët përkatëse. zhapiku ariu plazhi gozhda zhavorri shtëpia pizhame
Luhet loja **stop - përjashto**. Një nxënës lexon fjalët dhe u thotë nxënësve të tjerë, që në ato fjalë që dëgjojnë **zh** të thonë **stop**, kurse në fjalët që nuk dëgjojnë **zh** të thonë **përjashto**. Nxënësit tregojnë edhe pozicionin e tingullit **zh** në këto fjalë.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimin dhe prezanton shkronjën **Zh zh** të shtypit, të madhe dhe të vogël. Mësuesi dhe nxënësit në çifte e shqiptojnë atë. Prezanton grafikun e shkronjës .

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës duke e shkruar në tabelë hap pas hapi. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe në çifte shkruajnë shkronjën **Zh zh** në tabelat e tyre magnetike ose fleta të bardha A4. Në grupe nxënësit modelojnë shkronja **Zh zh** duke përdorur materiale të ndryshme (rruaza, plastelinë, shkrepëse, oriz, makarona, fije etj.). Disa nxënës e shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t'u prezantojë nxënësve me projektor ose tv grafikun e shkronjës **Zh zh** me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 145 dhe shqiptojnë shkronjën **Zh zh** që ndodhet në krye të faqes. Theksohet se shkronja **Zh** është bashkëtingëllore.

Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekstin **“Vizita në Zhablak”**. Shpjegohen fjalët më pak të njohura për nxënës. Lexohet teksti zinxhir nga disa nxënës, që kanë aftësi të dalluara në lexim.

Nxënësit punojnë ushtrimet e dhëna në tekst (pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe shpjegon ato):

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur përgjigjen në pyetjet rreth tekstit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte krijojnë rrokje me shkronjën **zh** dhe shtatë zanore.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur qarkojnë rrokjet, që përmbajnë shkronjën **zh** në fjalët e dhëna (zha, zha, zhy, zhgë etj.).

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit

Në ushtrimin e katërt, nxënësit bashkojnë pikat dhe formojnë shkronjat e shtypit. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në ushtrimin e parë, nxënësit plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë. Shembull: zhapiku, abazhur, gozhdë, zhongler etj.

Në ushtrimin e katërt, nxënësit në çifte lidhin fjalën me figurën. Vihet theksi te shkrimi ifjalëve me kuptim të kundërt: vesh – zhvesh, shkul – ngul etj.

Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit gjejnë fjalët: GOZHDE, ZHURME, ZHAPIK, PLAZHI.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.



Punojnë ushtrime në fletoren e punës. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimit: Shkronja *Zh zh* e dorës

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë dhe të shqiptojë tingujt në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të lexojë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje);
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar.

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, analizë - sintezë, metoda fonetike - alfabetike, lexim i drejtuar, lexim zinxhir etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve :

- shqiptojnë saktë dhe identifikojnë shkronjën Zh zh të dorës;
- shkruajnë shkronjën Zh zh të dorës sipas modelit;
- shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore duke parë modelin;
- shkruajnë sipas diktimit të mësimdhënësit (diktim për të ushtruar, diktim kontrollues);
- lexojnë në mënyrë të pavarur;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shogëri, art figurativ

Fjalë kyçe: tingull - shkronjë, rrokje, fjalë, fjali, shkrim shtypi, shkrim dore, vjershë etj

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, figura, kompjuter, projektor, tv, tabelë, shkurtesa, grafiku i shkronjës **Zh zh** të dorës, tabak letre, mjete vizatimi, tabelë alfabeti, fleta A4 etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimit fillon me këtë aktivitet: Dy nxënës para tabelës u tregojnë shokëve/shoqeve etiketa me shkronjën **Zh zh**. Nxënësit i lexojnë ato dhe tregojnë pozicionin e tingullit **Zh** në fjalë.

Aktiviteti 2: Çdo nxënësi i jepet në dorë një etiketë me shkronjë apo rrokje me ngjyra të ndryshme. Kur mësuesi përplas duart, nxënësit që kanë në dorë etiketat me ngjyrë të njëjtë formojnë çifte dhe krijojnë rrokje ose fjalë, që kanë në përbërje shkronjën **zh**. Mund të lexohen rrokjet dhe fjalët e krijuara nga nxënësit. Nxënësit kontrollojnë dhe vlerësojnë punën e njëri – tjetrit.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja njeh nxënësit me temën e mësimit dhe prezanton shkronjën **Zh** të dorës, të madhe dhe të vogël. Shqiptohet nga mësuesi dhe nxënësit në çifte. Prezenton grafikun e shkronjës.

Analizon elementet përbërëse dhe shpjegon mënyrën e lëvizjes së dorës hap pas hapi duke e shkruar në tabelë disa herë. Bëhet dallimi mes shkronjave **Zh zh** të shtypit nga të dorës. Më pas nxënësit e ushtrojnë lëvizjen e dorës në ajër 2 herë dhe e shkruajnë atë në tabelat e tyre plastike ose fletë të bardha A4. Disa e shkruajnë në tabelë.

*Brenda mundësive mësues-i/ja mund t’u prezantojë nxënësve me projektor/tv grafikun e shkronjës **Zh zh** të dorës me anë të një videoje ilustruese.*

Hapi III - Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 147 dhe shqiptojnë shkronjën **Zh zh** të dorës. Nxënësit lexojnë fjalinë **Plazhi i Ulqinit pret shumë mysafirë**. Vëzhgojnë lidhjen e shkronjës **zh** të dorës me shkronjat e tjera tek fjalia e lexuar.

Mësues-i/ja demonstroi lidhjen e shkronjës **Zh zh** me shkronjat e tjera për të formuar rrokje e fjalë.

Nxënësit punojnë ushtrimet (pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesat):

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit plotësojnë me shkronja dore rreshtat.

Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit krijojnë fjali me fjalët e formuara tek ushtrimi i dytë.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e shtatë**. Shkruajnë rrokje e fjalë me shkronja dore.

Në **ushtrimin e tetë**, nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalë e fjali.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë 2 rreshta me shkronjën **Zh zh** të dorës dhe 2 fjali. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Përsëritje për shkronjat Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh

Mësimi 44.

Përsëritje për shkronjat Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh të shtypit

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Përsëritje për shkronjat **Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh** të shtypit

Tipi i orës: Orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të shqiptojë saktë (qartë) tingujt zanorë dhe bashkëtingëllore të gjuhës shqipe;
- të dallojë shkronjat e shtypit dhe ato të dorës;
- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të shtypit;
- të gjejë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mes shkronjave të dorës;
- të shkruajë shkronjat e shtypit dhe të dorës;
- të dallojë dhe krahasojë shprehjet: tingull (shkronjë), fjalë, fjali;
- të lexojë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje);
- të njohë fjalën si bashkësi tingujsh (shkronjash) me një kuptim;
- të njohë fjalinë si mendim të përbërë prej fjalësh
- të bashkojë tingujt dhe shkronjat në fjalë, e fjalët në fjali.

Metodat dhe teknikat: bisedë, metoda fonetike - alfabetike, analizë - sintezë, lexim, diskutim, vëzhgo - analizo, ditari dypjesësh etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë (qartë) tingujt **Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh**;
- dallojnë shkronjat e mësuara **Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh** dhe përcaktojnë pozicionin e tyre në fjalë;
- dallojnë shkronjat e shtypit nga të dorës;
- lexojnë dhe analizojë fjalë duke i ndarë në rrokje e shkronja;
- krijojnë fjalë, grupe fjalësh dhe fjali duke parë figurat;
- lexojnë të pavarur;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- dallojnë në mënyrë intuitive fjalët që tregojnë objekte nga ato që tregojnë veprime;
- punojnë ushtrimet në tekst.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, matematikë, kulturë muxikore

Fjalë kyçe: shkronjat **Th, Dh, X, Xh, Z, Zh**, shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, shëno, vendos, lexo, shkruaj. etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, grafiku i shkronjave **Th, Dh, X, Xh, Z, Zh**, tabela plastike, figura, fletë formati, kompjuter, etiketa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Kënga e abetares”.

Aktivitet 2: Nxënësit të ndarë në 6 grupe shkruajnë 4 format e shkronjave të grupit të gjashtë. Çdo grup ka përgjegjësi të shkruajë katër format për një shkronjë.

Shembull: Zh i madh shtypi, zh i vogël shtypi, Zh i madh dore, zh i vogël dore.

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezanton punën e grupit të vet. Mësues-i/ja lavdëron, korrigjon dhe vlerëson nxënësit për punën e bërë në grupe.

Bëhet përsëritja e alfabetit nga të gjithë nxënësit. Dallohen 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore.


Realizim kuptimi

Hapi II – Punë në tekstin mësimor

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 148 dhe punojnë ushtrimet e dhëna, pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesat.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit të pavarur shkruajnë emrin poshtë figurës me shkronja shtypi. Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte analizojnë fjalët: televizor, pizhame.

Shembull:




Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit të pavarur dallojnë me ngjyra fjalët që tregojnë objekte nga ato që tregojnë veprime.

Objekte: tenxhere, xixa, thana, çerdhe etj.

Veprime: lexoj, nxjerr, nxeh etj.

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit gjejnë fjalët: zemër, xhaketa, thana, zhapiku.



Në **ushtrimin e pestë**, nxënësit krijojnë fjali mbi bazën e ilustrimeve. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e shtatë**, nxënësit bisedojnë për situatat e paraqitura. Krijojnë histori mbi bazën e figurave. Lidhin ato me pervojën e vet.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në dy format e saj.

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizim _____

Përsëritje për shkronjat *Th th Dh dh X x Xh xh Z z Zh zh* **të dorës**

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi : Përsëritje për shkronjat *Th th Dh dh X x Xh xh Z z Zh zh* të dorës

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë shkronjat e shtypit nga shkronjat e dorës;
- të zbatojë teknikën e të shkruarit fillestar;
- të dallojë kuptimin e fjalëve të shkruara dhe të fjalive të formuara me figura;
- të dallojë shkronjat, fjalët e fjalitë e veçanta;
- të lexojë saktë, qartë dhe me intonacionin e duhur (me zë dhe në heshtje).

Metodat dhe teknikat: bisedë, vëzhgo - analizo , diktim, fonetike- alfabetike, analizë - sintezë, lexim etj.

Format e punës: individuale, në çift, në grup, frontale

Aktivitetet e nxënësve:

- shkruajnë alfabetin e gjuhës shqipe;
- shkruajnë rrokje, fjalë e fjali me shkronjat e mësuara;
- krijojnë fjali duke i renditur fjalët;
- kthejnë fjalinë nga shkrim shtypi në shkrim dore;
- punojnë ushtrimet në tekst dhe fletë pune.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ

Fjalë kyçe: shkronjat **Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh** shkronja shtypi, shkronja dore, shkronja të mëdha, shkronja të vogla, qarko, formo, lidh, plotëso, shkruaj, lexo etj.

Mjetet e mësimi: fletore pune, grafiku i shkronjave **Th th, Dh dh, X x, Xh xh, Z z, Zh zh**, tabak letre, figura, fletë formati, etiketa, tabelë alfabeti, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet të nxënësve në grupe. Nxënësit ndahen në 6 grupe. Mësuesja u jep foto të ndryshme të fjalëve, që përmbajnë në trup shkronjat: **Th, Dh, X, Xh, Z, Zh** . Çdo grupi një shkronjë. Nxënësit i shohin dhe i shkruajnë ato, në formë autodiktimi në një fletë ose tabak letre me shkronja shtypi dhe dore.

Në fund të aktivitetit, një përfaqësues i grupit del para klasës dhe prezenton punën e grupit të vet. Grupet korrigjojnë njëri – tjetrin. Mësuesi lavdëron dhe vlerëson nxënësit për punën e bërë në grupe.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë në fletore pune

Nxënësit hapin fletoren e punës dhe punojnë ushtrimet e dhëna sipas udhëzimit të mësuesit.

Ushtrimi i parë: Nxënësit në grupe krijojnë rrokje me shkronjat e mësuara.

Ushtrimi i dytë: Plotësojnë alfabetin me shkronjat që mungojnë.

Ushtrimi i tretë: Plotësojnë fjalët me rrokjet që duhet (velenxa, kërpudhë, grethi etj.)

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Reflektim

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Ushtrimi i katërt: Bashkojnë rrokjet dhe krijojnë fjalët (kërpudhë, xhubleta, doreza).

Ushtrimi i tetë (Diktim) : Nxënësit shkruajnë me të diktuar fjalë dhe fjali me të gjitha shkronjat.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Shkruajnë nga një rresht për secilën shkronjë në format e saj. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin_____

Historia e alfabetit tonë

Mësimi 45.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Historia e alfabetit tonë

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të perceptojë tekstet joletrare/shkencore–popullarizuese të lexuara dhe të ekranizuara;
- të kuptojë dhe përdorë nocionin tekst;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst.

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, diskutim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- lexojnë tekstin joletrar me zë dhe kuptojnë atë;
- përgjigjen në pyetjet lidhur me të dhënat më kryesore të tekstit të lexuar;
- korrigjojnë fjalitë ku është përdorur gabimisht shkronja e madhe të emrat e njerëzve dhe në fillim të fjalisë;
- kthejnë fjalitë nga shkrim shtypi në shkrim dore.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri

Fjalë kyçe: historia e alfabetit, shkronja latine, shkronja e madhe

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, kompjuter, projektor, tv, foto, tabelë, shkumës, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit në tabelë, projektor ose në tv vëzhgojnë tabelën e alfabetit të gjuhës shqipe dhe përsërisin shkronjat në grupe. Më pas përgjigjen me përgjigje të plota në pyetjet: Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe? Cilat janë zanoret? Cilat janë bashkëtingëlloret? A e dini sesi është formuar alfabeti? etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri / Punë në tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Historia e alfabetit tonë** ”.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në fq.153 dhe përcjellin me vëmendje leximin e tekstit “Historia e alfabetit tonë” nga mësuesi. Gjatë leximit tregohet edhe për fjalët e panjohura, të cilat nxënësit i nënvizojnë.

Shpjegohet kuptimi i fjalëve të panjohura.

Shembull:

miratoj → e pranoj një gjë si të vendosur përfundimisht, shpreh pëlqim të plotë për diçka. Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit.

Hapi III

Punohet rubrika **Pyetje**. Nxënësit përgjigjen gojarisht në pyetjet rreth tekstit. Mësues-i/ja tregon kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen qartë (saktë) dhe me fjali të plota. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës. Punohet ushtrimi - kuici me nxënës të ndarë në grupe.

Tek ushtrimi, nxënësit vështrojnë me kujdes shkrimin e emrave të njerëzve. Korrigjojnë emrat e shkruar gabim.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve nga nxënësit

Punohet ushtrimi, mbas udhëzimit të mësueses. Mësuesja shkruan 4 shkronja në letra të ndryshme dhe ndan klasën në 4 grupe. Secili grup tërheq nga një shkronjë. Ka 3 minuta kohë që të shkruajnë 3 fjalë me shkronjë të madhe.

Punohet ushtrimi. Nxënësit shkruajnë me shkronja dore tekstin e dhënë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Akuariumi

Mësimi 46.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Akuariumi

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të perceptojë tekstet joletrare/shkencore–popullarizuese të lexuara dhe të ekranizuara;
- të kuptojë dhe përdorë nocionin tekst;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të shfaqë përvojat e veta për të njëjtën temë.

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, diskutim, demonstrim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- lexojnë tekstin joletrar me zë dhe e kuptojnë atë;
- përgjigjen në pyetjet lidhur me të dhënat më kryesore të tekstit të lexuar;
- shfaqin përvojat e veta për të njëjtën temë;
- krijojnë fjali dhe vendosin shenjat e pikësimit sipas llojit të fjalisë;
- krijojnë një akuarium.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore.

Fjalë kyçe: akuarium, peshq

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, kompjuter, projektor, tv, foto, tabelë, shkumës, mjete vizatimi, mjete për akuarium etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit shikojnë në projektor ose tv foto të ndryshme peshqish dhe tregojnë për vendbanimet e tyre natyrore. Më pas tregojnë çfarë dinë tjetër për peshqit duke u ndihmuar me pyetjet: Ku tjetër mund të jetojnë peshqit? A mund t'i mbanjmë peshqit në shtëpi? Si? etj.

Nxënësit zgjerojnë njohuritë e tyre për akuariumet duke shikuar dhe komentuar së bashku me mësuesen videot për akuariumet e vogla dhe të mëdha të pasqyruara në projektor ose tv. Videot shoqërohen me muzikë simbolike për akuariume.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri / Punë në tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Akuariumet”**.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në fq.155 dhe përcjellin me vëmendje leximin e tekstit “Akuariumet” nga mësuesi. Gjatë leximit tregohet edhe për fjalët e panjohura (fjalët e reja, që nuk ua dinë kuptimin), të cilat nxënësit i nënvizojnë.

Shpjegohet kuptimi i fjalëve të reja. Shembull:

evolucion → zhvillim shkallë - shkallë dhe i ngadaltë i diçkaje nga një gjendje në një tjetër. Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit.

Hapi III

Punohet rubrika **Pyetje**. Nxënësit përgjigjen gojarisht në pyetjet rreth tekstit. Mësues-i/ja tregon kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen qartë (saktë) dhe me fjali të plotë. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit krijojnë fjali sipas figurave.

Reflektim

Hapi IV – Vazhdohet punimi i ushtrimeve nga nxënësit.

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte vendosin shenjat e pikësimit në vendin e duhur.

Shembull: Unë kam akuarium në shtëpi.

A keni ju akuarium?

Në **ushtrimin e katërt**, nxënësit së bashku me mësuesen krijojnë një akuarium.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Punojnë ushtrime në fletore pune. Jepen shpjegime për detyrën e shtëpisë.

Vrejtjet e mësuesit për realizimin _____

Numrat

Mësimi 47.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Numrat

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të perceptojë tekstet joletrare/shkencore–popullarizuese të lexuara dhe të ekranizuara;
- të kuptojë dhe përdorë nocionin tekst;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të shfaqë përvojat e veta për të njëjtën temë.

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, diskutim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift

Aktivitetet e nxënësve :

- lexojnë tekstin joletrar me zë dhe kuptojnë atë;
- përgjigjen në pyetjet lidhur me të dhënat më kryesore të tekstit të lexuar;
- shfaqin përvojat e veta për të njëjtën temë;

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: numrat, numrat romakë, numrat arabë etj.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, kompjuter, foto, tabelë, shkurtesa, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe shoqërojnë me lëvizje e shprehje këngën për fëmijë “Numrat”. Më pas e komentojnë atë duke u ndihmuar me pyetjet: Kujt i kushtohet kjo këngë? Pse na duhen numrat? Cilët numra përdorim ne? Si e mendoni botën pa numra? etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri / Punë në tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Numrat** ”.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në fq.156 dhe përcjellin me vëmendje leximin e tekstit “Numrat” nga mësuesja. Gjatë leximit tregohet edhe për fjalët e panjohura (fjalët e reja, që nuk ua dinë kuptimin), të cilat nxënësit i nënvizojnë. Shpjegohet kuptimi i fjalëve të reja.

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit.

Hapi III

Punohet rubrika **Pyetje**. Nxënësit përgjigjen gojshëm në pyetjet rreth tekstit. Mësues-i/ja tregon kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehin qartë (saktë) dhe me fjali të plota. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtimin e parë**, nxënësit vështrojnë shembujt e dhënë dhe i plotësojnë ata me ndihmën e mësuesit.

Shembull: një qytet – disa qytete një zog – disa zogj

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte kthejnë fjalët me të zeza në numrin shumës.

Shembull: Kishte kapur një **flutur**.

Kishte kapur disa **flutura**.

I ra në kokë një **pikë** shiu.

I ranë në kokë disa **pika** shiu.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Detyrë shtëpie

Gjeni kuriozitete për numrat. Jepen shpjegimet për detyrën e shtëpisë.

Vërejtjet e mësuesit për realizim _____

Veshjet popullore

Mësimi 48.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Njësia e mësimi: Veshjet popullore

Tipi i orës: Orë për përvetësim të njohurive

Arritjet e të nxënësit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të perceptojë tekstet joletrare/shkencore–popullarizuese të lexuara dhe të ekranizuara;
- të kuptojë dhe përdorë nocionin tekst;
- të dallojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të shprehë mendimin e vet për tekstin;
- të shfaqë përvojat e veta për të njëjtën temë;

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, lexim zinxhir, diskutim etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Aktivitetet e nxënësve :

- lexojnë tekstin joletrar me zë dhe kuptojnë atë;
- përgjigjen në pyetjet lidhur me të dhënat më kryesore të tekstit të lexuar;
- shfaqin përvojat e veta për të njëjtën temë.

Korelacion: natyrë dhe shoqëri, art figurativ, kulturë muzikore

Fjalë kyçe: veshje popullore.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor , fletore pune, kompjuter, tv, projektor, foto të ndryshme, tabelë, shkumës, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Ora e mësimi fillon me këtë aktivitet: Nxënësit në tv, tabelë ose projektor vëzhgojnë me vëmendje foto të ndryshme të veshjeve popullore shqiptare në Mal të Zi dhe i komentojnë ato me mësuesen.

Nxënësit zgjerojnë njohuritë e tyre për veshjet popullore shqiptare në Mal të Zi duke shikuar dhe komentuar së bashku me mësuesen edhe video nga festivalet.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri / Punë në tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Veshjet popullore** ”.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në fq.157 dhe përcjellin me vëmendje leximin e tekstit “ Veshjet popullore” nga mësuesja. Gjatë leximit tregohet edhe për fjalët e panjohura (fjalët e reja, që nuk ua dinë kuptimin), të cilat nxënësit i nënvizojnë.

Shpjegohet kuptimi i fjalëve të reja. Shembull:

traditë → pasuri shpirtërore, zakone etj. të formuara historikisht dhe të trashëguara brez pas brezi. trashëgimi → gjithçka e mirë e krijuar dhe ruajtur brez pas brezi.

Lexohet teksti zinxhir nga nxënësit.

Hapi III

Punohet rubrika **Pyetje**. Nxënësit përgjigjen gojarisht në pyetjet rreth tekstit. Mësues-i/ja

tregon kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehin qartë (saktë) dhe me fjali të plotë. Vazhdohet punimi i detyrave në fletoren e punës.

Në **ushtrimin e parë**, nxënësit përshkruajnë me fjalë që tregojnë cilësi veshjet e mëposhtme (e kuqe, e bardhë etj.).

Reflektim

Hapi IV – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Në **ushtrimin e dytë**, nxënësit në çifte vështrojnë figurat dhe lidhin ato me fjalët që tregojnë cilësi (i uritur, i lodhur, i gëzuar, i mërzhitur).

Në **ushtrimin e tretë**, nxënësit formojnë nga një fjali për secilën prej tyre. Shembull: Agroni ishte shumë i gëzuar.

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.


Vërejtjet e mësuesit për realizimin _____

Shënim: Orë tjetër për këtë temë:

1. Vizitë në muzeun më të afërt.

Krijim i një teksti me gojë për veprimtarinë e bërë.

MODELE TESTESH NGA GJUHA SHQIPE

TEST VLERËSUES NGA GJUHA SHQIPE		
	Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____	
1.	Plotëso fjalën me rrokjen që mungon.  __ kina  a ____ ja  pesh__	3
2.	Lidh rrokjet për të formuar fjalë. kla lla le tu ra mo sa flu pu ri	4
3.	Ndaj fjalën në rrokje dhe shkronja. 	6
4.	Shkruaj fjalën poshtë figurës.  _____  _____  _____	6
5.	Rendit si duhet fjalët për të formuar fjalinë. rërë luan lrisa në	2
6.	Shkruaj me shkrim dore fjalitë. Ariani u la në lumë. _____ Jona luan në ujë. _____	4
7.	Lexo dhe plotëso fjalitë. a) Nora lan _____. b) Ariani mori _____.  	2

Vlerësimi

Arritur pjesërisht	Arritur kryesisht	Arritur në tërësi
(10 - 13)	(14 – 22)	(23 – 27)

Nënshkrimi i mësuesit

Nënshkrimi i prindit

TEST VLERËSUES NGA GJUHA SHQIPE		
Emri dhe mbiemri _____ Klasa: _____		
1.	Sa rrokje ka fjala?     panda insekti nëna majmuni	2
2.	Plotëso fjalët me rrokjet që duhet: dy, de, fi ,mbë, be, ra .       ____lbi kë ____ koli____ ____lfin bu____ ____keta	3
3.	Lidh fjalët me figurat dhe shkruaj ato me shkronja dore.  Antoni _____  kupa _____  delfini _____  fruta _____	4
4.	Bashko sipas modelit dhe krijo grupet e fjalëve.  +  _____  +  _____	4
5.	Shkruaj saktë fjalitë. Dorina violinë luan me _____ punon kompjuter në Jetmiri. _____	4
6.	Qarko fjalët e shkruara saktë. dardhë tullumbace xhirafë ogjak Ulqin Tomë modhë	3
7.	Shkruaj fjalinë me shkronja dore. Arta këndon bukur. _____	2
8.	Qarko shenjën e pikësimit të vendosur saktë. a) Pranvera banon në Krajë. b) Pranvera banon në Krajë? c) A banon Valmiri në Dacaj. d) A banon Valmiri në Dacaj?	2

9.	Vendos në vendin e duhur fjalët : kam, ke, ka,kemi, keni, kanë. Unë _____lahutë. Ne _____piano. Ti _____ çifteli. Ju _____ violinë. Ai _____fyell. Ata _____kitarë.	3
10.	Plotëso fjalinë me fjalën e duhur. Genti dhe Zana _____me tren në Tivar. (nis, u nisën) Gjystina _____nga loja. (hyri, doli)	2

Vlerësimi

Arritur pjesërisht	Arritur kryesisht	Arritur në tërësi
(12 -14)	(15 – 24)	(25 – 29)

Nënshkrimi i mësuesit

Nënshkrimi i prindit

MODELE DETYRASH KONTROLI

	DETYRA E PARË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____	
1.	Vëzhgo figurën dhe plotëso fjalën me shkronjën që mungon.     ar_____mi An _____ o__a	2
2.	Lidh rrokjet për të formuar fjalë. ma ra E ra Mi mi e ma	4
3.	Ndaj fjalën në rrokje dhe shkronja. mami 	4

4.	Shkruaj fjalët me shkronja dore. Ana _____ emri _____ Miri _____ era _____	8
5.	Ndaj fjalët duke krijuar një fjali. Shkruaje fjalinë e krijuar.  Animemamin. _____	3

Vlerësimi

Arritur pjesërisht	Arritur kryesisht	Arritur në tërësi
(8 – 13)	(14 – 17)	(18 – 21)

Nënshkrimi i mësuesit

Nënshkrimi i prindit

DETYRA E DYTË E KONTROLLIT NGA GJUHA SHQIPE		
Emri dhe mbiemri: _____ Klasa: _____		
1.	Vëzhgo figurën dhe plotëso fjalën me rrokjen që mungon.  u j _____  _____ l i  u _____	3
2.	Qarko sa rrokje ka fjala. lulja 1 2 3 jeleku 1 2 3 mali 1 2 3 orari 1 2 3	4
3.	Rendit shkronjat sipas rendit të duhur.  U A L N  a r o  a i j n a 	6
4.	Lexo dhe plotëso fjalitë. Kola kalëron me _____. Noni luan me _____.	4
5.	Ndaj fjalët duke krijuar një fjali. Shkruaje fjalinë e krijuar. Joraula. _____	3
6.	Shkruaj fjalinë me shkronja dore. Lonora e Rina luajnë në rërë. _____	8

Vlerësimi

Arritur pjesërisht	Arritur kryesisht	Arritur në tërësi
(10 - 15)	(16 – 23)	(24 – 28)

Nënshkrimi i mësuesit

Nënshkrimi i prindit

MODELE DIKTIMESH PAS ÇDO GRUPI SHKRONJASH TË MËSUARA

DIKTIMI I PARË

ma er an im la Ra
ara era ari ena mami emri
Ana me Emin.
Miri me mua.
Rea me Ninën.

DIKTIMI I DYTË

unë ora kala mali lulja lepurit lejleku jeleku
Kola mori ariun.
Jona kalëron me kalë.
Iliri luan me Olën.

DIKTIMI I TRETË

sy bletë dritarja radio flutura Pinoku Bora Teuta
Babai bleu bukë.
Diana ka lodra të bukura.
Fatmiri, Besniku e Pjetri luajnë me top.
Ylberi doli pas malit.

DIKTIMI I KATËRT

qafa qengji cjapi biçikletë vagoni sfungjeri
Gjyshja qëndis çorape.
Vera, Genti e Qemali luajnë në piano.
Lumi Cem ka ujë të pastër.
Çanta e Borës ra në tokë.

DIKTIMI I PESTË

Ku është lahuta e Rrokut?
Shpresa njeh shkronjat.
Sara e Hëna hëngrën akullore.
Njëshi është numër.
Llambat ndriçojnë qytetin.

DIKTIMI I GJASHTË

Xhaxhai zuri shumë peshq.
Çfarë tha xhamaprerësi?
Zana i theu thuprat e vogla.
Dentisti e këshilloi Dhuratën për dhëmbët e prishur.
Xixëllonja xixëllon natën.
Sa i shpejtë është zhapiku!

Burime dhe literatura

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2002.
3. Beci, Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Shkup, 2004.
4. Beci, B., "Probleme të mësimi të gjuhës amtare në shkollë". Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, Landskrona, Suedi, 2007.
5. Bushati, Jozef & Dibra, Gëzim & Priku, Mimoza, "Problematic of learning for reading and writing in pre-school and first grade of pre-university education, through multimedia" [Problematika të të mësuarit të lexim - shkrimit në parashkollor dhe klasën e parë të arsimit parauniversitar, përmes multimedias], *Education for the knowledge society*, 1st Albania International Conference on Education (AICE), Tirana, 7-8 december, Proceeding pg. 102-114.
6. Chomsky, N., "Chapter 2 On the Nature, Use, and Acquisition of Language", in *Handbook of Child Language Acquisition*, Leiden, The Netherlands: Brill, 1998. https://doi.org/10.1163/9789004653023_005
7. Clark EV. *First Language Acquisition*. Cambridge University Press, 2009.
8. Gjokutaj, M. & Dode, E., *Didaktika e gjuhës shqipe* (kurrikula I-VI), Shtëpia Botuese "Shkronjë pas Shkronje", Tiranë, 2013.
9. Memushaj, R. *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2010.
10. Osmani, Sh. & Kazazi, Nj., *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Tiranë, 2000.
11. Programi i lëndës mësimore "Gjuhë shqipe dhe Letërsi" (Për klasët I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollës fillore), Enti i Shkollimit në Mali të Zi, Podgoricë, 2017.
12. Richard, Jack C. & Theodore S. Rodgers, *Approaches and Methods in Language Teaching*, Beijing: Foreign Language Teaching and Research Press, 2000.

